

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

UBT News

Media & Events

---

12-18-2017

### UBT News - Nentor 2017

University for Business and Technology


Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper>

---

#### Recommended Citation

University for Business and Technology, "UBT News - Nentor 2017" (2017). *UBT News*. 1.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/newspaper/1>

This Book is brought to you for free and open access by the Media & Events at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in UBT News by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



**Rektori Hajrizi dhe përfaqësuesit e NATO-s takojnë presidentin Thaçi, kryeparlamentarin Veseli dhe kryeministrin Haradinaj**

Faqe 3



**UBT hapi Qendrën e Inovacionit Social "Colibri"**

Faqe 6

**UBT thellon bashkëpunimin me universitetet amerikane**

Faqe 7

**Rektori Hajrizi, drejtues i ekipit të Kosovës në FIRST Global Challenge**

Faqe 9

**Rezultate kulminante të studentëve të UBT-së**

Faqe 10 - 19

**Instituti i Medias dhe UBT mbledhin shumë ekspertë për të diskutuar për sigurinë e gazetarëve në Kosovë**

Faqe 20

**Akademitë verore të UBT-së**

Faqe 32-37



**UBT organizon konferencën më të madhe ndërkombëtare në rajon**

(faqe 4-5)



**Jamie Shae i NATO-s nderohet nga UBT me Çmimin "Excellence Leadership Award"**

(faqe 3)



Editorial

**Prof.dr. Edmond Hajrizi**

# Për UBT-në flasin mjaft vetëm sukseset e studentëve

“Ish-studenti i UBT-së, krijon magazinën e parë online në formë ankandi për Kosovë”, “Dikur student i UBT-së, tash student i Universitetit Teknik të Vjenës”, “Saranda Demolli pjesë e stafit të UBT-së”, “Hera Luma menaxhere e projektit “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”, “Kreshnik Zariqi i UBT-së, përfiton nga YouTube”, “Studentja e UBT-së, Endrita Peqani e angazhuar në Zyrën për Informim në Lipjan”, Anisa Rada e UBT-së, trajnere në projektin “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”, “Studenti i UBT-së, pjesë e kompanisë së njohur “Kosbit”, partner i “AT&T”, Mbi 200 studentë të UBT-së, pjesë e universitetëve me te njohura në Evropë”, “Studenti i UBT-së ndërton projektin “Solar Tracker” (Ndjekësi Solar)”, “Punimi shkencor i studentit të UBT-së, u zgjodh ndër më të mirët në konferencën “Teknologjia që punëson”, “Mbi 20 studentë të UBT-së, pjesë e kompanisë “JusPost”, “Studentët e UBT-së, lehtësisht të qasshëm në tregun e punës”, “Studentët e Arkitekturës në UBT, pjesë e rëndësishme e projektit për shëtitoren në Fushë Kosovë”, “Studentët e UBT-së, pjesë e rëndësishme e festivalit ndërkombëtar “Do-kuFest”, “Gentiana Xhemali e UBT-së, e punësuar në Komunën e Prishtinës”, “Esat Xani i vetmi në Kosovë i diplomuar në nivelin master për Sisteme të Informacionit”, “Qëndrim Begisholli pranohet në Universitetin Politeknik të Milanos”, “Studenti i UBT-së, Liridon Parduzi përfaqësoi Kosovën në “Berlin Start-up Camp”, “Studentët kosovarë takohen me kryeministrin e Portugalisë”, “Studentet e UBT-së, fituese të konkursit “ASA Awards”...

Këta janë vetëm disa nga titujt e lajmeve për suksesin e studentëve të UBT-së, lajme këto të kohës së fundit. Të tjera lajme për sukseset e këtyre studentëve keni lexuar në numrat e kaluar të kësaj gazete, të revistës “Alumni”, në ueb-faqen e UBT-së dhe në rrjetet sociale.

Përgjatë 16 viteve të punës, UBT e ka pasur dhe e ka gjithmonë në fokus studentin. Dhe atë, jo vetëm duke sjellë profesorët më të mirë nga e gjithë bota, për të ligjruar në për të ndarë me studentët tanë përvojat më të mira e dijet kulminante. Jo vetëm duke përzgjedhur profesionistët më të mirë nga vendi e rajoni. Jo vetëm duke e zhvilluar mësimin sipas modeleve amerikane

e evropiane. Jo vetëm duke e bazuar këtë në planprogramet profesionale, sipas zhvillimeve më të fundit në të gjitha fushat. Jo vetëm duke krijuar laboratorë e hapësira pune praktike...

Por, duke arritur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet më të rëndësishme botërore në fushën akademike, të shkencës e të hulumtimit. Duke u mundësuar studentëve të UBT-së që të ndjekin studimet, në të gjitha nivelet, nëpër këto institucione. Një ose dy semestra në studimet themelore, po kështu edhe në studimet baçelor. Dhe, më e rëndësishmja, duke u hapur rrugë, përmes këtyre marrëveshjeve, që të kryejnë studimet e doktoratës dhe të kthehen e të bëhen pjesë e institucionit tonë. Të kontribuojnë për studentët e rinj dhe për vendin.

Punësimi i studentëve tanë, tashmë është një temë që as nuk diskutohet. Nëse je diplomuar në UBT, kjo do të thotë se që në start je një hap para të tjerëve. Këtë ua mundëson dija dhe përvoja që kanë marrë në UBT.

Janë me dhjetëra kompani, në të cilat shumica e të punësuarve janë studentë ose ish-studentë të UBT-së, ndërsa pothuaj është e pamundur të gesh një kompani serioze në të cilën nuk ka ndonjë student të UBT-së.

Nëse ke diplomuar në UBT, ti ke një shenjë dalluese nga të tjerët – ti je i dedikuar për të qenë i pari dhe më i miri ndër të tjerët.

UBT, është e qartë tashmë, investon në studentin. Motiv dhe qëllim kryesor ka ngritjen e tij profesionale. Dhe, për dallim nga të tjerët, nuk ndalet së kujdesuri për të pasi diplomimit. UBT i konsideron pjesë të familjes së vet të gjithë të diplomuarit, i përcjell ata në vazhdimësi dhe është në kontakt të përhershëm me ta, duke u krijuar gjithnjë mundësi të reja.

Ndaj, kujdesi dhe respekti është i dyanshëm: UBT studentin e ka të vetmin në fokus – studentët e UBT-së, kudo ku arrijnë në karrierë, e theksojnë fuqishëm institucionin ku ata u nisën në rrugën e suksesit të garantuar. Dhe maksima, me të cilën pajtohem dhe mburremi bashkë është: Një herë UBT, gjithherë UBT.

**16 YEARS**  
**LEADERSHIP and INNOVATION**

Education | Research | Training | Consulting

2001/2017

## IMPRESUM

**UBT News** – gazetë e studentëve

**Botues:** Edmond Hajrizi

**Numrin e përgatitën:** Jehona Kapllani, Anisa Rada, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

**Adresa:** www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

**Përgatitje grafike:** Trimor Racaj

Zëvendësndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Sfidat në Ardhje të Sigurisë në shtabin e NATO-s, vizitoi UBT-në

## Jamie Shae nderohet nga UBT me Çmimin “Excellence Leadership Award”

Suksesi me i madh për mua nuk është pavarësimi, por momenti kur pavarësimi të arrihet në tërësi, me integrimin e plotë të Kosovës në institucionet dhe ky është një proces i pandalshëm për Kosovën.

Kosova ka potencial të madh, por ky potencial është i pashfrytëzueshëm nëse nuk e zhvillonin tutje, sepse e ardhmja është edhe në duart tuaja.

Këtë mesazh dhe porosi e ka dhënë Zëvendësndihmës Sekretari i Përgjithshëm për Sfidat në Ardhje të Sigurisë në shtabin e NATO-s, njëherësh ish-zëdhënës i NATO-së gjatë bombardimeve të vitit 1999, në Kosovë, dr Jamie Shae, me rastin e mbajtjes së konferencës: “E ardhmja euroatlantike e Kosovës”, të organizuar nga UBT, me ç’rast edhe nga rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, iu nda Çmimi “Excellence Leadership Award”, çmim me të cilin UBT nderon personalitetet më të njohura vendore e ndërkombëtare për kontributin e tyre në sfera të ndryshme të jetës.

Me rastin e nderimit me këtë çmim, dr Shae tha se ndjehet i nderuar që është shpërblyer për kontributin e dhënë, ndonëse sipas tij, e ka bërë atë që do ta bënte çdo njeri me ndërgjegje po të ishte në vendin e tij.

Me organizimin e kësaj konference, UBT ka krijuar edhe zyrtarisht ka themeluar Forumin Euroatlantik, qëllimi kryesor i të cilit do të jetë promovimi i procesit të integritit euroatlantik të Kosovës, si dhe për të krijimi i një urë lidhëse midis botës akademike dhe politik-bërësve



në Kosovë.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se UBT ka privilegjin t’i mbështesë dhe të ofrojë platformë për zhvillimin e punës së studiuesve të rinj, dhe sipas tij, ky forum do ta afrojë Kosovën më afër lidhjeve trans-atlantike, sidomos në fushën e teknologjisë.

“Procesi i integritit euro-atlantik është në qendër të sulmeve nga vala e fundit e popullzimit dhe përkrahjes për grupe politike të ekstremit të djathtë në Bashkimin Evropian, teksa vendet e Ballkanit Perëndimor kanë një përgjegjësi të veçantë, si shtetet që më së shumti po përfitojnë nga ky proces, që të prodhojnë më shumë lajmë të mira, duke përmbushur detyrat e shtëpisë, në mënyrë që qytetarët e shteteve anëtare të BE-së të jenë dëshmitarë të fuqisë transformativë të procesit të integritit”, vlerësoi Hajrizi.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj tha se Kosova ka një rrugë të gjatë para vetes, për anëtarësim në mekanizmat ndërkombëtarë, përfshirë edhe NATO-n, nën arsyetimin se, këto procese po ngadalësohen për shkak të vështirësive që po shfaqen në politikën e

brendshme e të jashtme.

“Edhe po të merrej vendimi sot vendimi që FSK të shndërrohej në Forca të Armatosura të Kosovës, do të duheshin 10 vite që të kemi një ushtri të plotë dhe duhen bërë përpjekje që me kolegët tanë serbë të kemi një dialog të mirëfilltë dhe t’ua shpjegojmë domosdoshmërinë e krijimit të FAK-ut, sepse nuk duhet që vota e tyre në parlament të shndërrohej në një veto të dyfishtë të Serbisë ndaj Kosovës”, potencoi Hoxhaj.

Në konferencë morën pjesë edhe përfaqësuesit e Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, Giorgio Batistti, dr Brooke A. Smith-Windsor dhe Giuseppe Marobito, të cilët rrëfyan historikun, arsyet, rëndësinë dhe funksionit e NATO-s, që nga themelimi e deri më sot.

Në fund, studentët e UBT-së prezantuan esetë e tyre kritike mbi rolin e NATO-s në botë, si dhe ndanë një dhuratë të përgatitur nga vetë ata, për njeriun që cilësohet si njëri ndër ndikuesit më të mëdhenj në çlirimin e Kosovës, dr Jamie Shae.



## Rektori Hajrizi dhe përfaqësuesit e NATO-s takojnë presidentin Thaçi, kryeparlamentarin Veseli dhe kryeministrin Haradinaj



Rektori Hajrizi dhe përfaqësuesit e NATO-s takojnë presidentin Thaçi, kryeparlamentarin Veseli dhe kryeministrin Haradinaj



Rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka shoqëruar delegacionin e Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, të udhëhequr nga Dr Jamie Shea, në takimet me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës.

Ata janë pritur nga presidenti Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, me të cilët kanë bashkëbiseduar rreth zhvillimeve të fundit në Kosovë.

Zëvendës-Ndihmësi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jamie Shea, është shprehur i kënaqur me përparimet në Kosovë dhe ka shprehur besimin se vendi është në rrugën e drejtë për t’u anëtarësuar në NATO. Jaime Shea qëndroi në Kosovë me ftesë të UBT-së.

Konferenca e gjashtë Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion

# UBT organizon konferencën më të madhe ndërkombëtare në rajon



Në Durrës i ka zhvilluar punimet, për të gjashtin vit më radhë, Konferenca Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion, e organizuar nga UBT.

Si asnjëherë më parë, kjo konferencë mbledhi mbi 300 punime shkencore, të punuara me shumë profesionalizëm nga më shumë 500 pjesëmarrës.

Ajo që e bëri të veçantë dhe akoma më të pasur këtë konferencë ishte prania e mbi 100 profesorëve e ekspertëve ndërkombëtarë, numër ky që po shënon rritje nga viti në vit, e që është një tregues i qartë mbi nivelin e lartë organizativ dhe hulumtues të UBT-së. Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, SHBA, Austria, Gjermania, Britania e Madhe, Danimarka, Irlanda, Italia, Kroacia, Çekia, Norvegjia, Finlanda, Bullgaria, Polonia, Hungaria, Greqia etj., janë disa nga shtetet që u përfaqësuan me punime shkencore në këtë konferencë, që mbledhi disa nga mendjet më të ndritura nga akademja, shkencat e industria.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se për UBT-në dhe Kosovën është shumë e rëndësishme që të mbahen konferencat e tilla shkencore, ku mblidhen njerëzit më kompetentë të fushave, për të na bërë të vetdijshëm mbi inovacionet e fundit në botë dhe ndryshimet nëpër të cilat po kalon njerëzimi.

“Në ditët e sotme është shumë e rëndësishme që të jemi në të njëjtin hap me trendet botërore të zhvillimit dhe të jemi indikatorë dhe zhvillues të inovacioneve edhe në vendin tonë”, theksoi Hajrizi.

Qëllimi kryesor i kësaj konference ishte që të bëjë të mundur shkëmbimin e njohurive dhe shkathtë-

sive në mes hulumtuesve, profesorëve, studentëve të doktoraturës dhe ekspertëve të ndryshëm nga industria. Andaj, për këtë qëllim, konferenca shtriu aktivitetin e vet në 15 fusha të ndryshme, që u mbajtën njëkohësisht, përfshirë fushat: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Sistemet e Informacionit dhe Siguri, Menaxhim i Mekatronikës dhe Robotikës, Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieria Ndërtimit dhe Mjedisit me Infrastrukturë, Energji Efiçente, Juridik, Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, Gazetari, Media dhe Komunikim, Shkenca të Ushqimit, Shkenca Mjekësore, Kimi dhe Farmaci, Dizajn i Integruar, si dhe Shkenca e Psikologjisë; Edukim dhe Zhvillim.

UBT, përmes organizimit të konferencave shkencore, po jep kontribut të vazhdueshëm për zhvillimin e shkencës dhe të hulumtimit, duke u mundësuar profesorëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme, të prezantojnë rezultatet e punës së tyre shkencore, me ndikim në proceset akademike, por edhe me interes për publikun dhe ndjekjen e trendëve të fundit të zhvillimit në të gjitha fushat.

Eskpertë ndërkombëtarë dhe nga Republika e Kosovës dhanë kontributin e tyre në të gjitha sesionet e kësaj konference.

Ndër të tjerë, pjesë e konferencës ishin:

**Në SHKI:** Admirim Aliti, Ana SAVIC, Andrea ALBERICI, Arben BAUSHI, Arianit MARAJ, Armir

KUÇI, Artan SALIHU, Bajram QUKA, Bertan KARAHODA, Besnik QEHAJA, Bilall I. SHAINI, Blerton ABAZI, Boris ARSOV, Edmond HAJRIZI, Edmond Jajaga, Eldion SHEAPI, Emira HALIMI, Erza GASHI, Exhevit YMERI, Felix BREITENECKER, Festim HALILI, Galia MARINOVA, George Telonis, Goran BJELOBABA, Hana STEFANOVIĆ, Kozeta Sevrani, Krenare PIREVANUCI, Litvane SPAHIJA, Mirije SALIHI, Muharrem SHEFKIU, Murthy Rallapalli, Nikolas POPPER, Olsi XHOXHI, Orgest ZAKA, Orjola JAUPI, Peter P. GROUMPOS, Ramiz HOXHA, Rilinda ISEINI, Tanzer ABAZI, Tea TAVANXHIU, Valdrin HAXHIU, Vasko TRAJKOVSKI, Verda MISIMI, Vergim SHERIFI, Xhafer KRASNIQI, Zhilbert TAFA.

**Në MBE:** Fatima Bouchikhi, Zine Barka, Łukasz Ambroziak, Taşkın Dirsehan, Remzije Rakipi, Shenaj Hadzimustafa, Nehat Dobratiqi, Fisnik Muça, Armend Muja, Zamira Sinaj, Fioralba Vela, Rezarta Brokaj, Fioralba Vela, Zamira Sinaj, Sejdi Xhemaili, Kaltrina Bujaku, Jonida Xhema, Teuta Dervishi, Mirora Limani, Plamen Iliev, Jonida Lesha, Ramadan Limani, Almarin Frakulli, Njomza Beqiri, Diamanta Skenderi, Besnik Skenderi, Diandra Nela, Ermal Lubishtani.

**Në Shkencat Politike:** Islam Lauka, Alfred Marleku, Ngadhnjim Brovina, Adlum Ramadani, Armend Mehmeti, Redi Papa, Valon Krasniqi, Artan Tahiri, Valon Krasniqi, Armend Muja, Belul Beqaj,





Astrit Hasani, Ridvan Peshkopia, Ramadan Ilazi, Ilir Zylfiu, Flora Kadriu, Veton Zejnnullahi.

**Në Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor:** Ágnes BORSOS, Ajhan Bajmaku, Ákos HUTTER, András Greg, Anett Gál-Mózes, Ani Tola, Armand Vokshi, Arnisa Kryeziu, Arsim Murseli, Bachmann Balint, Balázs Kokas, Bálint Bachmann, Bence Gál, Besian Sinani, Binak Beqaj, Blerta Vula Rizvanolli, Eduina ZEKAJ, Elvida Pallaska, Erzsébet Szeréna Zoltán, Faton Spahiu, Ferhat Bejtullahu, Florian Nepravishita, Françeska DELIA, Gabor VERES, Gabriella Medvegy, Gabriella MEDVEGY, Ildikó SIKE, Istvan TARNOKI, János Gyergyák, László Perényi, Ledita Mezini, Lulzim Beqiraj, Marjan Ivezaj, Mimoza Sylejmani, Oketa Hoxha, Péter PAÁRI, Ramë Hamzaj, Rineta Jashari, Safete Veliu-Rexhepi, Tamás KONDOR, Ulas Akin, Vlora Aliu, Èang Tie, Ylber Limani, Zana Prelvukaj, Zejnnulla Rexhepi, Zekë Islamaj, Zsófia Jakab, Zhao Dapeng.

**Në Media dhe Komunikim:** Gjylje Rexha, Adnan Merovci, Belul Beqaj, Ferid Selimi, Ariana Bytyqi Fazliu, Astrit Hasani, Ismet Hajdari, Liljana Siljanovska, Musa Sabedini, Safet Zejnnullahu, Shkodran Gajraku, Vjollca Sheqiri, Afet Bela, Tatjana Burzanović, Vehbi Miftari, Kaltrina Ajeti, Anisa Rada.

**Në SHKI:** Felix BREITENECKER, Edmond HAJRIZI, Lazar ADJIGOGOV, Dejan STAMENOV, Edmond JAJAGA, Kushtrim DRAGUSHA, Hasan HAXHAJ, Arsim KOSUMI, Kujtim GASHI, Atdhe BUJA, Fatos IDRIZI, Ukë Sejfiqaj, Osman OSMANI, Jasmina JOVANOVSKA, Ivana BOZHINOVA, Katerina ZDRAVKOVA, Armend SALIHU, Azir JUSUFI, Fatlinda SALIHU, Rexhep REXHEPI, Ramiz HOXHA, Betim GASHI,

**Në Juridik:** Shkumbin Asllani, Noela Ruco, Bekim Kadriu, Ylber Sela, Elitsa Kumanova, Zornitsa Yordanova, Elina Marinova, Doroteya Dimova-Severinova, Ivelin Velchev, Mukhitdinova Firyuza Abdurashidovna, Shqiprim Pula, Jorida Xhafaj, Almarin Frakulli, Egzon L. Qovanaj, Arber Rrustaj, Maria Radeva, Erveina Gosalci, Artan Tahiri, Ramiz Fazliu, Artan Murati, Erjona Bezatlliu, Agni Aliu, Dardan Vuniqi, Era Mujaj, Shefki Shtërbani, Leonita Lajçi, Shkelzen Sopjani, Qashif Bakiu, Flora Kadriu.

**Në Arsim dhe Zhvillim:** Alisa Sadiku, Alma Stana, Alma V. Lama, Andreas Körner, Anita Mirijamdotter, Anna Maria Kosova, Antonino Scarelli, Anxhela Ferhataj, Ariel Ora, Denis Celcima, Dukagjin Hyseini, Fatbardha Qehaja, Fatima Bouchikhi, Felix Breitenacker, Feride Lohaj, Florim V. Ajdini, Gökçen Avar, Halil Bashota, Hilmi Vardari, Johannes Tanzler, Jozef Bushati, Karoly Nagy, Kreshnike Haliti,

Laura Naka, Mary M. Somerville, Mirsad Suhodolli, Paolo Martena, Pranvera Kraja, Robert Kosova, Roland Sahatcija, Ruth Leskovar, Saliha Ilican, Selami Klaiqi, Stefanie Èinkler, Valentina Sinaj, Veton Zejnnullahu, Ylber Limani, Zine Barka.

**Në Sistemet e Informacionit:** Naim Preniqi, Bler-ton Abazi, Romina Agaçi, Ardian Hyseni, Eljona Proko, Alketa Hyso, Dezdemonja Gjylapi, Lars Magnusson, Jusuf Qarkaxhija, Renelada Kushe, Arben Baushi, Orgest Zaka, Olsi Xhoxhi, Albnora Hoti, Ardian Hyseni.

**Në Shkencat Mjekësore, Kimike dhe Farmaceutike:** Agim Prokshaj, Agon Hoti, Agon Shala, Agron Hoxha, Aida Rexhepi, Anduenë Haxhiu, Arben Haziri, Arben Mehmeti, Arbnore Qaili, Ardiana Veseli, Arianit Jakupi, Armir Sejdiu, Azem Hysa, Besnik Elshani, Blerta Reçica, Brunilda Myftari, Burim Kiseri, Çagatay Dayan, Dafina Krasniqi, Demush Bajraktari, Dorentina Bexheti, Dr. Miklos Vecsernyes, Eda Mehmeti, Elton Bahtiri, Elton Myftari, Emirjon Haxhiu, Enxhi Andrea, Fadil Kryeziu, Fadil Sherifi, Fatmir Faiku, Feim Mazreku, Fitore Zenelaj, Fjolla Boshnjaku, Florentina Elshani, Florentina Raci, Gafur Shtino, Hamide Ibrahim, Ibrahim Mehmeti, Isa Haxhiu, Jehona Ahmedi, Joana Hankollari, Ledjan Malaj, Lumturije Asllani, Lutfi Zylbeari, Majlinda Daci, Marsida Duli, Marsida Klemo, Mergime Loxha, Merita Barani Sveqila, Merita Dauti, Nasir Be-

hxheti, Nevila Xhindi, Petrit Biberaj, Qamil Dika, Rexhep Gjyliqi, Rexhep Kasumaj, Rezarta Kalaja, Rinor Haxhiu, Rudina Berani, Rudina Zhupa, Salih Krasniqi, Sejran Abdushi, Sevdije Govori, Sihana Ahmeti Lika, Shpend Abdushi, Shpend Dragusha, Valon Ejupi, Violeta Kryeziu, Vjosa Hamiti Krasniqi, Xhedet Çuni, Xhenila Duli, Xhevat Pllana, Zaim Gashi, Zana Agani.

**Në Arkitekturë:** Afrim Sylja, Ajhan Bajmaku, Anjeza ALAJ, Armend Mujaj, Baxhuku Visa, Bedrettin Menemencioğlu, Besa Jagxhiu, Besar Abdi, Besian Sianani, BIER Thomas A, Binak Beqaj, Bruno Dal Lago, Caroline Jaeger-Klein, Çekiçi Visar, Davut Okcu, Dervishi Ildir, DILO Teuta, Driton R. Kryeziu, Ersilio Tushaj, F. H. Selmani, Fatjon Saliu, Ferhat Bejtullahu, Fisnik Kadiu, Florim Istrefi, Francesco Foti, Hazir Çadraku, Hysen Ahmeti, Idaver Huseini, Ilir Abdullahu, Ilir Dalipi, Isak Idrizi, Islam FEJZA, Izet IBRAHIMI, Juljan VELESHNJA, Kadir Güçlüer, Koca Odisea, Kreshnik Merxhani, Kubilay Akçaözöglü, Lirjetë Avdiu-Vejsa, Lisa Jusufi, Marjan Ivezaj, Mevlan Qafleshi, Mimoza Sylejmani, Miranda RASHANI, Misin Misini, Muhamet Ahmeti, Naim Krasniqi, Nexhmi KRASNIQI, Niko Lako, Ninez Kosumi, Osman Günaydin, Papa Dhimitri, Paul Galligan, Petrit Ahmeti, QOKU Elsa, QORLLARI Anxhelina, Sabrie Spahiu, Semiha Akçaözöglü, Severin Karl, Skender Kosumi, Sokol Xhafa, Sylejman Bejta, Shemsi Mustafa, Tatsuya NUMAO, Valentin Queck, Valmira Bozgo, Vehbi Duraku, Visar Krelani, Vlerë KRASNIQI, Xhemshir Mulliqi, Zekirija Idrizi, Zenun Elezaj.

**Në Mekatronikë dhe Energji Efiçiente:** Peter Kpacek, Valmir Hoxha, Fatmir Azemi, Edmond Hajrizi, Bekim Maloku, Johannes Tanzler, Felix Breitenacker, Andreas Körner, Venera Krasniqi, Nevena Ackovska, Katerina Zdravkova, Ines Bula, Ekavi Antoniou, Eleni S. Vergini, Peter P. Groumpos, Lazaros Aygeris, Kozeta Sevrani, Romina Muka, Vehebi Sofiu, Atifete Zuna, Pranvera Dobruna, Naim BAF-TIU, Raif Bytyci, Marko GREBOVIĆ, Radmila Sindić GREBOVIĆ, Sami Gashi, Ymerr Bajmaku, Besa Veseli, Petrit Drini, Imer Zenku, Afrim Osmani, Saliha Ilican, Gonca Ilgu Buyuk, Yasemin Caglar, Mujdat Caglar, Shkumbin Shala, Osman Fetoshi, Arbnore Bytyqi, Mentor Shala, Rushan Ceka, Astrit Shala, Pajtim Bytyqi, Afrim Sylja, Ruzhdi Matoshi, Faton Maloku, Luan Daija, Xhelal Këpuska, Rexhep Nushi.



Në Kampusin Inovativ, në Lipjan

# UBT hapi Qendrën e Inovacionit Social “Colibri”

**Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj e vlerësoi lart hapjen e Colibri-t, teksa tregoi që, me qëllim të përkrahjes së ideve inovative dhe pas bashkëbisedimit me shumë të rinj kosovarë, është vendosur që të bëhet themelimi i një ministrie që do të merret veçanërisht me identifikimin dhe përkrahjen e novatorëve të rinj**

Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, është bërë hapja e Qendrës së Inovacionit Social, “Colibri”, që është themeluar si rezultat i bashkëpunimit mes UNICEF-it dhe UBT-së, aktivitet ky që u shënuar me hapjen e Javës së Inovacionit, gjatë të cilës do të mbahen aktivitete të shumta, kryesisht të karakterit social.

Colibri do të jetë qendra e parë e karakterit të tillë në Kosovë, që do të merret me identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve sociale të shoqërisë kosovare, dhe në këtë mes, UBT do të ofrojë vazhdimisht kontribut dhe mbështetje për novatorët e rinj dhe idetë inovative, që të zhvillohen nën ombrellën e kësaj qendre.

Me rastin e hapjes së Colibri-t, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se hapja e kësaj qendre është iniciativë unike dhe e rëndësishme për Kosovën, por edhe në aspektin global, sepse sipas tij, është në funksion të zgjidhjes së problemeve sociale.

“Colibri, si një ndërlidhje mes organizatave ndërkombëtare dhe akademisë, paraqet një koncept modern dhe unik, në atë mënyrë që të gjenerohen zgjidhje inovative, të bëhen transformime të bazuara në inovacion, për çështjet dhe problemet sociale që dëshirojmë t’ju qasemi dhe t’i zgjidhim në Kosovë dhe në regjion”, theksoi ai.

Hajrizi shprehu gatishmërinë e UBT-së, duke përfshirë edhe stafin akademik dhe studentët, për të ofruar ide për zgjidhjen e problemeve më të mëdha dhe më aktuale të shoqërisë, përfshirë ato në shëndetësi, në zhvillim ekonomik dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës.

“Kjo qendër nuk do të jetë një destinacion, por do të jetë një rrugëtim dhe synimi ynë është që të mbërrijmë sa më larg sepse nuk mjafton që të përfshihen vetëm elemente të kreativitetit dhe të ideve të reja, këto janë raste që kërkojnë një përmbajtje të thellë të dijes, hulumtimeve shkencore, akademike, testime të ndryshme dhe ndërlidhjes së dijeve”, vlerësoi Hajrizi.



Shefi i UNICEF-it në Kosovë, Brandao Co, duke e vënë në pah faktin se, Kosova e ka popullsinë më të re në Evropë, tha se ende ekziston hapësira për ofrimin e ndihmës dhe për përgatitjen e të rinjve për treg të punës.

“Përmes kësaj qendre, qëllimi ynë është që t’ua japim të rinjve mundësinë për të shfaqur potencialin e tyre të plotë si novatorë sociale, sipërmarrës dhe agjentë të ndryshimeve sociale”, potencoi Co, teksa shtoi se ndjehet gjithmonë i lumtur kur ndodhet përreth njerëzve të rinj, duke qenë se, sipas tij, janë përplot energji, kapacitet dhe potencial.

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj e vlerësoi lart hapjen e Colibri-t, teksa tregoi që, me qëllim të përkrahjes së ideve inovative dhe pas bashkëbisedimit me shumë të rinj kosovarë, është vendosur që të bëhet

themelimi i një ministrie që do të merret veçanërisht me identifikimin dhe përkrahjen e novatorëve të rinj.

“Roli i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është që t’ju hapë rrugë të gjithë njerëzve që kanë ide, por edhe të ofrojë përkrahje për ndërmarrësit që janë në proces të realizimit dhe pastaj të gjitha këto inovacione do të vihen në fokus të zhvillimit ekonomik dhe në fokus të efekteve ekonomike”, theksoi Beqaj.

Në fund, para pjesëmarrësve, studentët e UBT-së prezantuan punimet dhe projektet e tyre inovative, të cilat u shndërruan në produkte konkrete në laboratorët e sofistikuar të UBT-së, si dhe në fund, u vizituan objektet dhe hapësirat brenda kampusit të UBT-së, në Lipjan, përfshirë laboratorët, inkubatorët, bibliotekën, leximore dhe sallat e ligjëratave.

## Përmbylli punimet punëtorja “StartUP”, përzgjidhen fituesit

“Simple Life”, “Priza Project” dhe “CEDX”, janë projektet fituese të punëtorisë treditore “StartUP”, që u mbajt në kuadër të Javës së Inovacionit në UBT, organizuar nga Qendra për Inovacione Sociale “Colibri”.

“Simple Life” është projekt i cili parasheh ndërtimin e një shkopi digjital për të verbrit, duke ua lehtësuar kështu jetën mbi 6000 kosovarëve që aktualisht janë të verbër, por po ashtu, do të synohet që të arrihet edhe deri tek tregu i jashtëm i shitjes.

Ideatorët e projektit “Priza Project” synojnë që të krijojnë një prizë shumëfunktionale, që do ta lehtësojë jetën e njerëzve në këtë epokë të digjitalizimit dhe shpikjeve teknologjike. Ndërsa, projekti “CEDX” ka për qëllim që të bëjë themelimin e qendrës për trajnime në fushën e

teknologjisë dhe do të momentalisht do të shtrihet vetëm në Pejë, sepse një qendër e tillë i ka munguar këtij qyteti. Vlen të theksohet që të gjitha projektet fituese do të mbështeten financiarisht për shndërrimin e projekteve të tyre në produkte konkrete dhe të gatshme për shfrytëzim, teksa edhe projektet tjera do të kenë mbështetje për zhvillim të mëtejshëm nga qendra “Colibri”.

Kjo punëtori kishte për qëllim që të zgjojë kreativitetin e këtyre të rinjve dhe i njëjti të shfrytëzohet e shndërron në projekte konkrete, që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe jo vetëm, pasi disa nga këto produkte që do të dalin nga kjo punëtori, synojnë edhe tregun e jashtëm.



## UNICEF dhe UBT nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e qendrës së përbashkët të inovacionit

UNICEF dhe UBT kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të themelimit të Qendrës Ndërkombëtare të Inovacionit Social (International Social Innovation Center), e cila si synim kryesor do të ketë ngritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e ideve inovative nga të rinjtë, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të komunitetit.

ISIC ka për qëllim që të krijojë vlera të përbashkëta, duke bashkuar njohuritë dhe kapacitetet në krijimin e një procesi për zgjidhjen e problemeve sociale duke e rritur shkallën e inovacionit mes akademisë

, industrisë, organizatave shoqërore civile, sektorit të biznesit, dhe komunitetit.

Krahas kësaj, kjo qendër do të ofrojë hapësirë dhe qasje të avancuar në zhvillimin e njohurive të të rinjve dhe përdorimin e tyre për jetë dhe punë, pastaj do të ndihmojë e ndikojë në zhvillimin e mendimit kreativ, inovacionit social dhe ndërmarrësinë për studentët dhe të diplomuarit e UBT-së dhe ata të institucioneve tjera akademike në Kosovë dhe Ballkan.

## Përfaqësuesit e UBT-së, pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar nga BE, në kuadër të projektit “BESTSDI”

Një delegacion i UBT-së, i përbërë nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi dhe nga stafi i profesorëve, morën pjesë në punëtorinë “Zhvillimi i Arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor për Trajnim të Qëndrueshëm Profesional për Infrastrukturën e të Dhënave Hapësinore”, që u mbajt në Mal të Zi, në kuadër të projektit “BESTSDI”, të financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi kryesor i këtij projekti është adaptimi i kurrikulave aktuale, si dhe krijimi e kurrikulave të reja për infrastrukturën e të dhënave hapësinore., teksa për të diskutuar për këtë çështje, në këtë takim morën pjesë të gjitha vendet e Ballkanit Perën-

dimor, duke përfshirë edhe partnerë nga Bashkimi Evropian.

Aktualisht, në UBT janë duke u bërë përgatitjet për themelimin e një qendre të tillë, që njëherësh do të jetë e para dhe e vetmja e këtij karakteri në Kosovë.

Qendra do të pajiset një laborator me pajisje harduerike, softuerike dhe me teknologjitë më të fundit në fushën e të dhënave hapësinore, që do të ndihmojë në mbledhjen, procesimin dhe analizimin e të dhënave në fusha të ndryshme, përfshirë Sistemet e Informacionit, Planifikimin Hapësinor, Ndërtimtarinë, Ekonominë, Gjeodezinë, Statistikat etj.

Rektori Hajrizi në vizitë zyrtare në SHBA

## UBT thëllon bashkëpunimin me universitetet amerikane

Rektori i UBT-së, Prof.Dr. Edmond Hajrizi ka qëndruar në Nju Jork. Ai në kuadër të agjendës për vendosjen e partneritetit akademik me universitete dhe institucione amerikane ka takuar udhëheqësit e shumë fakulteteve atje.

Rektori Hajrizi, gjatë qëndrimit në Nju Jork, ka zhvilluar takime të ndara me krerët e fakulteteve të St. Johns University, respektivisht udhëheqësit e katedrës juridike, biznesit dhe atij të komunikimit masiv. Universiteti St. Johns, është përzgjedhur së fundi (2017) si një ndër kolegjet më të mira Kombëtarë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Qëllimi i vizitës, sipas rektorit Hajrizi, ishte konsolidimi i bisedimeve në fushat e përbashkëta prioritare, që do të finalizohet së shpejti përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit.

Duke u bazuar në përshkrimet analitike të arsimit në Kosovë, z.Hajrizi në bashkëbisedim me krerët e këtij institucioni, ka ofruar një gamë të gjerë të mundësive të shkëmbimit ndërinstitucional.

Me theks të veçantë, biseda është zhvilluar rreth politikave programore, rritjes

së performancës dhe përmirësimit të kurrikulave akademike, shkëmbimit të stafit dhe studentëve gjithnjë në kuptim të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, ngritjes së strukturave dhe nivelit të kërkimit shkencor, në përputhje me standardet e aplikuara amerikane.

Qëllimi i vizitës në Nju Jork kishte të bënte gjithashtu, edhe me një pikë tjetër strategjike për UBT-në me institucione amerikane, respektivisht ngritjes dhe forcimit të Qendrës Euro-Atlantike, si dhe implementimi i një sërë projektesh të përbashkëta, të cilat do të iniciohen me konsolidimin e qendrës.

Rektori Hajrizi ka zhvilluar gjithashtu një vizitë në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku është njohur nga afër me programet e saja socio-ekonomike dhe zhvillimore, me ç'rast ka vizituar edhe zyrën e Radio-Televizionit 21 ku u prit nga korrespondenti Halil Mula, si i vetmi medium/gazetar nga Kosova me akreditim në Kombe të Bashkuara.

Rektori Hajrizi u shpreh i nderuar edhe nga pritja e rezervuar në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës nga diplomatët dhe ambasadorja Teuta



Sahatqija, e cila vlerësoi lart kontributin e UBT-së në promovimin e arsimit të Kosovës në planin ndërkombëtar. Ajo iu referua një sërë storieve të suksesit që UBT ka arritur në kompeticione ndërkombëtare, ndërsa e ka vlerësuar si një zhvillim të natyrshëm.

Nga ana e tij, Rektori Hajrizi u shpreh se u ndje mjaft i kënaqur dhe i nderuar nga vizita në Nju Jork dhe theksoi, edhe një here, angazhimin e tij personal në realizimin e projekteve me institucione amerikane të arsimit të lartë.

Avancimi i studentëve në fushën e mjekësisë

## UBT lidh marrëveshje me Universitetin e Hungarisë



Rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin "Debrecen" në Hungari, respektivisht me Fakultetin e Mjekësisë dhe Shkencave Mjekësore.

Marrëveshja është në interes për dyja institucionet, të cilat do të bashkëpunojnë në fusha përkatëse si dhe ka për qëllim promovimin e fushës së edukimit dhe hulumtimit akademik.

Objektivat kryesore të marrëveshjes janë zhvillimi i projekteve të përbashkëta, realizimi i kompetencave dhe kualitetit në sektorët e mjekësisë dhe shëndetësisë në

Kosovë, përmes shfrytëzimit të praktikave më të mira të sektorit të mjekësisë.

Po ashtu, përveç bashkëpunimit në programet akademike, marrëveshja parasheh edhe themelimin e programeve të reja të studimit në UBT. Programet do të bazohen në kurikulat e akredituara dhe me materiale që studiohen edhe Universitetin "Debrecen" në Hungari.

Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjes do të ketë edhe shkëmbim të stafit akademik si dhe të studentëve, njëherësh në mënyrë reciproke do të zhvillohen vizita studimore.

Plani i prezantuar në kuadër të lëndës Menaxhimi Strategjik dhe Ndërmarrësia

## Përfaqësuesi i delegacionit të shtetit të Iowa-s, i befasuar me zhvillimin e UBT-së

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, sot ka pritur në takim përfaqësuesin e delegacionit nga shteti i Iowa-s në SHBA, njëherësh edhe dekan në Universitetin e Iowa-s, Downing Thomas, që po qëndron këto ditë për vizitë në Kosovë.

Me këtë rast, rektori Hajrizi theksoi se shkëmbimi i përvojave ndërshtetërore është i rëndësishëm për bashkëpunim në ngritjen e cilësisë së arsimit, përkatësisht në ngritjen e nivelit intelektual dhe profesional të gjeneratave të reja, teksa e falënderoi përfaqësuesin e delegacionit të shtetit të Iowa-s, për ndihmën e vazhdueshme që po e ofrojnë për Kosovën në fushën e arsimit.

Ndërsa, përfaqësuesi i këtij delegacioni, Downing Thomas, ndër tjerash, foli për mënyrën e gjetjes së mundësisë së bashkëpunimit të UBT-së me universitetet e shtetit të tij në fushën e arsimit.

Po ashtu, gjatë ditës së djeshme, rektori Hajrizi është takuar edhe me pjesëtarët e tjerë të këtij delegacioni, me ç'rast kanë

biseduar për mundësitë e lidhjes së bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe realizimit të hulumtimeve të përbashkëta, duke ofruar gjithashtu edhe mundësi të zgjerimit të bashkëpunimit me universitetet e këtij shteti, përmes realizimit të vizitave studentore, si dhe ofrimit të mundësisë për studime në këto universitete.

Delegacioni amerikan i cili po qëndron në Kosovë, është i përbërë nga rektorë, dekanë dhe profesorë të universiteteve të këtij shteti amerikan, përfshirë University of Iowa, The University of Northern Iowa, Des Moines Area Community College (DMACC), si dhe Drake University. UBT, tash e shumë vite ka partneritet me universitete të ndryshme amerikane, nga i cili kanë përfituar studentë e profesorë të shumtë të UBT-së, teksa para pak kohësh, përmes programit amerikan për arsim, "Fulbright", disa profesorëve të UBT-së u është ofruar mundësia e ligjërimit në disa universitete amerikane.

## Rektori Hajrizi në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Evropiane të Cilësisë

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Evropiane të Cilësisë, që po mbahet në Bratislavë të Sllovakisë, me ç'rast e ka prezantuar Kosovën, përmes Asociacionit "Quality Kosova", të themeluar nga vetë Hajrizi vite më parë.

Quality Kosova është anëtare e rregullt e EOQ-së dhe ka për qëllim promovimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare për cilësi në Kosovë, si dhe ndihmon në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe në përkrahjen

e institucioneve shtetërore të Kosovës, në mënyrë që të ato të ngritin kompetenca të reja në aspektin e cilësisë dhe ndërkombëtarizimit të produkteve dhe shërbimeve të Kosovës.

Që nga themelimi, UBT ka ndihmuar dhe ndikuar në ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe në lidhjen e bashkëpunimeve në fushën e arsimit edhe me ato vende të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën si shtet, duke u bërë një përfaqësues i denjë dhe lobues i drejtpërdrejtë për vendin tonë.

## Rektori Hajrizi në punëtorinë e organizuar nga Joint Research Center

Me ftesën dhe financimin e Komisionit Evropian, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Joint Research Center, në kuadër të Komisionit Evropian.

Punëtorija u mbajt në Selanik të Greqisë, kurse trajtoi çështje që lidhen me rolin e parqeve shkencore, teknologjive dhe inkubatorëve në ekosistemet inovative.

Me këtë rast, rektori Hajrizi është takuar me përfaqësues të shumë institucioneve evropiane dhe regionale, me ç'rast edhe u pajtuan për të filluar bashkëpunimin dhe hulumtimin e përbashkët në fusha të

ndryshme studimi, që do të zhvillohen në Kampusin Inovativ të UBT-së, si parku i vetëm i shkencës dhe teknologjisë në Kosovë, njëherësh edhe anëtare në IASP. Funkcionet e dizajnuara dhe të implementuara në Qendrën Shkencore dhe Teknologjike, të ashtuquajtur UBT Innovation Campus, janë të bazuara në taktikat më të mira në botë dhe kontribuojnë dukshëm në ngritjen e punësimit, vetëpunësimit, bashkëpunimit, edukimit dhe industrisë, duke krijuar kështu një ekosistem. UBT është lider në teknologji, inovacion dhe ndërmarrësi në Kosovë.



Bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare e vendore

## UBT konkretizon marrëveshjen me Universitetin Politeknik të Milanos

Prodekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr. Visar Krelani vizitoi Universitetin Politeknik të Milanos, për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të vënë në jetë marrëveshjen ndërmjet këtyre dy institucioneve, të cilat pak kohë më parë zyrtarizuan një marrëveshje bashkëpunimi, të nënshkruar nga rektori i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori i Departamentit të Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Milanos, prof. dr. Alberto Gudagnini.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, UBT dhe Universiteti Politeknik i Milanos do ta zgjerojnë bashkëpunimin në fusha të interesit dypalësh, përfshirë këtu edhe realizimin e projekteve të përbashkëta në Erasmus+, Horizon 2020, Marie Curie Actions etj., përmes të cilave do të mundësohet edhe shkëmbim i studentëve dhe stafit akademik ndërmjet këtyre dy institucioneve arsimore.

Për t'i konkretizuar këto qëllime, prodekani Krelani pati takime me drejtorin e Departamentit të Inxhinierisë së

Ndërtimit dhe Infrastrukturës, prof. dr. Andrea Guadagnini, i cili njëherësh është koordinator i Doktoratit në fushën e Hidroteknikës, e që shprehu gatishmërinë për të pasur bashkëpunime të mëtutjeshme dhe studime të nivelit të Doktoraturës për studentët e UBT-së. Po ashtu, u morën edhe hapa konkretë për projektin Erasmus+, ku u pritën edhe nga dekani i këtij fakulteti, prof. dr. Barbara Betti, e cila si udhëheqëse e këtij fakulteti, e hapi rrugën për të gjitha bashkëpunimet, si dhe ofroi përkrahje për studentët e UBT-së, në mënyrë që të kenë mundësi të hulumtojnë dhe të vijnë studimet në këtë universitet.

Gjatë kësaj vizite, Krelani u takua edhe me studentët e Kosovës, të cilët po studiojnë në nivelin master në Universitetin Politeknik të Milanos dhe që i kanë përfunduar studimet bachelor në UBT, nga të cilët u njoftua për mënyrën e studimit në këtë universitet dhe ndihmën që kanë pasur me përgatitjen në UBT.



## Përfaqësuesit e Institutit të Arkeologjisë prezantojnë gjetjet arkeologjike para studentëve të UBT-së



Përmes një konference të organizuar për studentët dhe stafin akademik të UBT-së, përfaqësuesit e Institutit të Arkeologjisë së Kosovës, kanë prezantuar gjetjet e fundit arkeologjike që janë evidentuar në territorin e Kosovës. Ata, në mënyrë kronologjike kanë paraqitur artefaktet të cilat datojnë që nga parahistoria, e deri në mesjetë.

Drejtori i Institutit të Arkeologjisë së Kosovës, Enver Rexha ka bërë të ditur se Kosova posedon një koleksion të pasur arkeologjik dhe fakte të cilat janë zbuluar nga hulumtimet e arkeologëve.

Sipas tij, vitet e lulëzimit të arkeologjisë kosovare datojnë nga viti 2005, e deri më tani.

“Kemi arritur rezultate të mira, kështu, përveç parkut të Ulpianës, në të njëjtën rrugë është edhe fshati Dersnik i komunës së Klinës. Ndërkohë, të arritura pozitive kemi edhe në komunën e Novobërdës, andaj shpresojmë që të marrim sinjale pozitive për sa i përket fondeve, për të vazhduar gërmimet si në këtë pjesë, njësoj edhe në kalanë e Prizreni dhe në atë të Pogradit në Gjiilan”, ka

thënë Rexha.

Ndërkohë, ai tha se kërkimet arkeologjike në vend janë të ndërthurura në mënyrë shkencore, ku vënë në funksion njohjen, analizimin dhe prezantimin e vlerave arkeologjike të Kosovës.

“Trashëgimia arkeologjike paraqet një thesar të çmuar të vendit tonë. Hulumtimet kërkimore arkeologjike u zhvilluan në bazë të kërkimeve sistematike, si dhe përmes studimeve gjeofizike etj. Andaj, këto dëshmi arkeologjike pasqyrojnë gjurmë, mbetje, rrënoja artefakte të civilizimeve të kaluara, si dhe të popullsisë autoktone”, theksoi Rexha.

Tutje, përfaqësuesit e Institutit treguan se gërmimet në shumë pjesë të Kosovës bëhen edhe në bashkëpunim me ekspertë nga vendet evropiane. Sipas tyre, në të ardhmen e afërt do të organizohen shumë ekspedita me karakter të gërmimit arkeologjik në vendbanime të periudhave të ndryshme, nga neoliti e deri në mesjetën e vonë.

## UBT nënshkruan memorandum mirëkuptimi me Spitalin e Përgjithshëm të Pejës

Sekretari i UBT-së, Artan Tahiri është takuar me drejtorin e Spitalit të Përgjithshëm të Pejës, Skender Dreshaj, me ç'rast nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për vendosjen e bashkëpunimit të ngushtë, si dhe eksplorimin e mundësive për bashkëpunim, veçanërisht për potencialet e përbashkëta për të ofruar zgjidhje të reja dhe inovative.

Bashkëpunimi do të ketë orientim të përbashkët kërkimor shkencor dhe hulumtues, të orientuar në sigurimin e vazhdimësisë së praktikave më të mira në nivel kombëtar dhe rajonal, duke e bërë të mundur një vendimarrje të

qëndrueshme dhe sistimore.

Përmes këtij memorandumit, të dy institucionet janë pajtuar për shkëmbimin e përvojave dhe për krijimin e mundësisë që studentët e UBT-së të kryejnë praktikën profesionale në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës, pastaj u pajtuan për realizimin e trajnimeve dhe certifikimeve për stafin e këtij spitali nga UBT, zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore dhe hulumtuese, si dhe ofrimin e njohurive për zhvillimin e punëtorëve, rritjen e kapaciteteve profesionale duke përdorur teknologjitë dhe metodat e reja, ofrimin e ekspertizave profesionale etj.,

nga portfoli i UBT-së për stafin e Spitalit të Përgjithshëm të Pejës, si dhe në këtë marrëveshje përfshihet krijimi i hapësirave dhe pajisjeve të nevojshme nga të dy institucionet, me qëllim të realizimit të qëllimeve të parapara me këtë marrëveshje mirëkuptimi.

UBT ka rreth 300 marrëveshje bashkëpunimi me universitete, kompani dhe institucione tjera, të cilat mundësojnë përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe u ofron studentëve mundësi të shumta për punë praktike dhe për vazhdim të studimeve jashtë vendit.

## Dr. Berisha: UBT është vendi që po krijon ekspertët e së ardhmes

Profesori me repute ndërkombëtare në fushën e bioteknologjisë, prof. dr. Bajram Berisha ka mbajtur një ligjëratë tematike për studentët e drejtimit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, ku ligjëroi temën më titull: “Kërkimi shkencor dhe zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë- Roli i bioteknologjisë”.

Duke shpjeguar rolin e bioteknologjisë dhe rëndësisë së ruajtjes së mjedisit në të cilin jetojmë, Berisha tha se është përgjegjësi e të gjithëve ruajtja dhe kujdesja për një ambient të pastër dhe të përshtatshëm për pasardhësit tanë.

Tutje, profesori Berisha, i shoqëruar nga profesorët e UBT-së, realizuan një vizitë të shkurtër nëpër objektet dhe laboratorët e bioteknologjisë, me ç'rast mbeti i befasiuar me kushtet dhe mundësitë që ofron UBT për studentët.

“UBT është vend i dijes dhe në të gjendet gjithçka që nevojitet për të krijuar ekspertë të përgatitur të së ardhmes”, vlerësoi ai, teksa shtoi se pajisjet që gjenden në UBT, i përkasin nivelit evropian.

Prof. dr. Bajram Berisha është ligjërues në Universitetin Teknik të Munihut dhe në Universitetin e Prishtinës. Ai është ndër shkencëtarët me kontribut ndërkombëtar i njohur për fiziologji, gjenetikë dhe bioteknologji animale, e veçanërisht i mirënjohur për kërkimet e tij origjinale shkencore në fushën e angiogjenezës dhe fiziologjisë së organeve të riprodhimit.

Publikimet e tij shkencore janë cituar më shumë se 2500 herë dhe “Hirsch indeksi” i tij aktual është h=30. Për të arriturat e tij kulminante shkencore në vitin 2012 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) e Kosovës është zgjedhur “shkencëtari më i mirë i vitit”.



Edhe një sukses i të rinjve kosovarë, të përkrahur nga UBT

## Rektori Hajrizi, drejtues i ekipit të Kosovës në FIRST Global Challenge

Nën mentorimin e rektorit të UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, nxënësit kosovarë të shkollave të mesme, Elita Hajrizi, Liburn Bajraktari, Flokart Pajaziti, Gëzim Morina dhe Rigon Statovci, janë duke prezantuar aftësitë në fushën e robotikës në garën FIRST Global Challenge në SHBA.

Pjesë e kësaj gare janë të rinj nga 164 shtete të ndryshme të botës, të cilët do ta sfidojnë njëri-tjetrin, përmes dizajnit dhe programimit të një roboti, për ndërtimin e të cilit është dashur të bashkohen aftësitë, idetë dhe kreativiteti në fushën e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës.

Gjatë kësaj gare, Rektori i UBT-së prof. dr Edmond Hajrizi u takua me udhëheqësit e këtij organizimi, përkatësisht me themeluesin, Dean Kame dhe presidentin aktu-

al, Joe Sestak.

Gjatë këtij takimi, Hajrizi ka marrë lëvdata nga Kame dhe Sestak, për mënyrën profesionale të organizimit dhe funksionimit të ekipit, teksa ndau edhe disa dhurata simbolike për ta.

UBT ka qenë organizatori dhe mbështetësi financiar i ekipit kosovar në garën FIRST Global Challenge, teksa në këtë garë, roboti i Kosovës ka marrë vlerësim të lartë nga teknikët e garës, të cilët kanë qenë kontribuuesit kryesorë në shumicën e garave, për aleancat me të cilat kanë garuar.

UBT do të vazhdojë të kontribuojë në fushën e teknologjisë, ndërmarrësisë, inovacionit dhe në shumë fusha të tjera, të cilat aktualisht janë sfiduese për njerëzimin.



## Ambasadorja Çitaku vizitoi ekipin e Kosovës në garën e robotikës, FIRST Global Challenge



Ambasadorja në detyrë e Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Vlora Çitaku ka vizituar ekipin e Kosovës në garën më të madhe ndërkombëtare në fushën e robotikës, FIRST Global Challenge, që po mbahet në SHBA.

Me këtë rast, Çitaku ka thënë se ndjehet krenare që të rinjtë kosovarë po e përfaqësojnë vendin në mesin e shumë shteteve të tjera të botës.

“Pata kënaqësinë që takova ekipin e mrekullueshëm dhe entuziast të Kosovës, që po merr pjesë në garën ndërkombëtare të robotikës. Jam krenare për mendjet e tyre inovative, kureshtarë dhe të bukura. Të rinjtë si ata do të lëvizin Kosovën përpara në shekullin e 21-të”, ka thënë Çitaku përmes një postimi në llogarinë e saj në Facebook.

## Aktiviteti “Hack Day Kosova 2017”, përfshihet në aktivitetet e BE-së për siguri kibernetike

Aktiviteti “Hack Day Kosova 2017”, që organizohet nga UBT CERT, është pranuar në fushatën më të madhe të BE-së dhe po promovohet në kalendarin e ngjarjeve, që do të organizohen në kuadër të muajit Evropian të Sigurisë Kibernetike (ECSM), që fillon në muajin tetor.

Fushata e ECSM-së ka për qëllim të bëjë vetëdijësimin qytetarëve dhe organizatave për rëndësinë e sigurisë kibernetike dhe për sigurinë e informacionit, si dhe po paraqiten hapat më të thjeshtë që mund të merren për të mbrojtur të dhënat dhe burimet e tyre.

Kërkesa për t’u pranuar në fushatën më të madhe zyrtare të BE-së ishte bërë vitin e kaluar nga UBT CERT, teksa këtë vit Kosova u listua në mesin e vendeve që organizojnë evente për nder të muajit tetor, që cilësohet si muaji evropian i sigurisë

kibernetike.

Me këtë rast, drejtuesit e UBT CERT kanë theksuar se njohja ndërkombëtare dhe pranimi i shpërndarjes së njoftimeve për këto aktivitete është hap pozitiv për Kosovën, njëherësh promovon edhe punën e UBT CERT.

Edicioni i dytë i “Hack Day Kosova 2017” do të mbahet më 12-14 tetor 2017, në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

UBT si institucion i arsimit të lartë në Kosovë, është lider rajonal në fushën Shkencave Kompjuterike, Sistemeve të Informacionit etj., ku edhe këtë vit përmes divizionit UBT CERT, ka marrë përsipër organizimin dhe mbarëvajtjen e aktivitetit të rëndësishëm kushtuar sigurisë kibernetike, “HackDay Kosova 2017”.

## Punimi shkencor i profesorit Tafa, vlerësohet si më i cituari në konferencën “IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing”

Profesori në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, prof. dr Zhibert Tafa është shpërblyer me Çmimin “Punimi më i cituar shkencor”, në konferencën me renome ndërkombëtare në lëmin e shkencave kompjuterike dhe elektroteknikës, “IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing”, që mbahet çdo vit në Mal të Zi.

Kjo konferencë është organizuar nga Fakulteti Elektroteknik i Universitetit të Malit të Zi dhe nga Montenegrin Association for New Technologies, teksa në të, punimi shkencor i profesorit Tafa

është vlerësuar si më i cituari në punime të ndryshme shkencore dhe libra, si pjesë e literaturës në lëmin e shkencave kompjuterike.

Me këtë rast, ai tha se ndjehet i vlerësuar që në mesin e qindra punimeve shkencore të kësaj konference në një periudhë 5 vjeçare, në rrafshin ndërkombëtar, punimi i tij të jetë përmendur më së shumti në literaturë, teksa shtoi se, njëkohësisht, ky shpërblim është edhe një tregues mbi nivelin akademik dhe shkencor të stafit të UBT-së.



## Ekspertët e sigurisë në UBT: Nevojitet krijimi i një grupi teknik për parandalimin e përhapjes së lojës vetëvrasëse “Balena e Kaltër”

Loja e fundit vetëvrasëse në internet, Balena e Kaltër (Blue Whale), e cila është shkaktare e vdekjes së qindra të rinjve nëpër botë, ditëve të fundit ka mbërritur edhe në Kosovë e Shqipëri, me ç’rast pre e saj kanë rënë disa adoleshentë.

Një kërcënim i tillë, ka ngjallur shqetësim edhe tek ekspertët e çështjes së sigurisë dhe privatësisë në UBT, përkatësisht tek Qendra për Siguri kibernetike dhe Privatësi (SKP) dhe tek divizioni për siguri i UBT-së, UBT-CERT.

Duke qenë kështu, ekspertët e këtyre çështjeve brenda UBT-së, vlerësojnë se kjo dukuri negative, e maskuar si një lojë, është rrezik i mundshëm për fëmijët dhe adoleshentët e vendit tonë, andaj edhe ofrojnë bashkëpunim dhe mbështetje të

plotë për institucionet relevante, me qëllim të parandalimit të përhapjes masive të kësaj loje.

UBT-CERT dhe ekipi i UBT-së kanë një përvojë në fushën e sigurisë kibernetike, andaj pohojnë me përgjegjësi të plotë se mund të japin kontribut profesional në raste të tilla. Përveç kësaj, falë bashkëpunimit të mirë ndërkombëtar, ekipi për siguri kibernetike ka mundësi të ofrojë zgjidhje edhe duke bashkëpunuar me ta. Tutje, ekspertët vlerësojnë se krijimi i një grupi teknik të përbashkët, ku do të përfshiheshin të gjitha palët, do të ishte një ide e qëlluar, që do të kishte rezultate të menjëhershme për parandalimin e përhapjes së metutjeshme të kësaj loje vetëvrasëse.

## Në UBT u inaugurua Qendra e Dijes, platformë për centralizimin e dijeve

Në kampusin inovativ të UBT-së, në Lipjan, është inauguruar Qendra e Dijes, qendër kjo e cila do të shërbejë si hapësirë multifunktionale, e përbërë nga sallat e veçanta për libra, hapësirën për studime për studentët dhe studiues të hu-lumtimeve, si dhe sallën e konferencave.

Hapja e kësaj qendre është përkrahur nga Ambasada Amerikane në Kosovë, si dhe USAID, teksa me këtë rast rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi ka thënë se kjo është platformë digjitale që i centralizon të gjitha njohuritë brenda institucionit në një sistem.

Tutje, rektori Hajrizi ka shtuar se hartimi i kësaj strategjie sjell shumë dobi për stafin akademik dhe studentët.

“I kemi regjistruar librat, kemi krijuar disa aplikacione për t’i përdorur dhe ndërlidhur me funksionin e Qendrës së dijës. Ne do të vazhdojmë që klasat t’i integrojmë në procesin e digjitalizimit. Është ideja që studentët të krijojnë dhe të dizajnojnë dhe në fund do të mund të kemi një platformë në të cilën do të mund të ndërlidhim të gjitha kampuset e UBT-së në Kosovë”, ka thënë Hajrizi.

Në hapjen e kësaj qendre ka marrë pjesë edhe bibliotekarja në librarinë e Universitetit e Paqësorit, në San Francisko, Mary M. Somerville, e cila me këtë rast ka thënë se Qendra e Dijes, në UBT është përqendruar që të ndihmojë që njohuritë që fitohen në këtë institucion të kalojnë kufijtë jo vetëm nivelin rajonal, por edhe në atë ndërkombëtar.

“Ky proces është i dobishëm edhe në kuadër të digjitalizimit të shoqërisë. Qendra e Dijes, rëndësi të veçantë do të kush-tojë grumbullimit të dijës, të dhëna të cilat do t’i vijnë në ndihmë gjitha shoqërisë”, theksoi Somerville.



Ndërkohë, profesori në Fakultetin e Shkencave Komputerike në UBT, Betim Gashi, duke folur për objektivin e përgjithshëm e këtij projekti, tha se qendra ka për qëllim rritjen e efikasitetit në menaxhimin e njohurive duke ofruar shërbime të ndryshme duke bashkëpunuar në një infrastrukturë.

“Sistemi do të lejojë studentët dhe profesorët të menaxhojnë dhe të gjejnë informacionin e duhur bazuar në atë që kërkojnë dhe çfarë ata janë të interesuar, duke marrë informacion

nga burimet më të mira. Ideja është të standardizohet dhe të automatizohet mënyra se si për shembull studentët kërkojnë për një temë specifike”, ka thënë Gashi.

Biblioteka në UBT mëton të jetë më e madhja në vend dhe në rajon. Ajo ka mbi 250 mijë tituj. Sot, në kuadër të hapjes së Qendrës së Dijës, studentët dhe të pranishmit janë informuar edhe me mënyrën se si funksionon sistemi i librarisë dhe sisteme tjera, ku do të përfshihen tashmë në këtë qendër.

## Përfaqësuesi i St. John’s University nga SHBA, viziton UBT-në

Dekani i programit Komunikim Ndërkombëtar në St. John’s University, në SHBA, Basilio Monteiro ka vizituar UBT-në, në kuadër të marrëveshjes së arritur kohë më parë mes këtyre dy institucioneve, me qëllim të rritjes së nivelit të bashkëpunimit në rrafshin akademik.

Me këtë rast, ai u prit nga rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, me të cilin biseduan mbi mundësitë për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me Fakultetin Media dhe Komunikim, por me synimin që ta rrisin këtë bashkëpunim

edhe në fusha tjera studimi.

Po ashtu, Monteiro u takua edhe me dekanin, profesorët dhe me studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, me të cilët bisedoi mbi kurrikulat, të ardhmen e gazetarisë, si dhe për mundësitë për vazhdim të studimeve të nivelit master, në programin të cilin ai e udhëheq.

Nën shoqërimin e profesorëve, ai vizitoi Media Group-in e UBT-së, në kuadër të të cilit janë të angazhuar kryesisht studentët të UBT-së, me ç’rast edhe u njoftua me punën që kry-

het nga ta, si dhe vizitoi edhe studion e radios, atë të editimit dhe sallat tjera ku zhvillohet procesi akademik.

UBT dhe St. John’s University kanë nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim në korrik të këtij viti, teksa vlen të përmendet që ky institucion është përzgjedhur si një ndër kolegjet më të mira kombëtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për vitin 2017.

## Siriani që u largua nga Aleppo e Sirisë diplomoi në UBT



I lindur në shtetin e Sirisë, Burhanudin Shishman ka emigruar në Kosovë, në vitin 2012, në kohën kur shumë të rinj kosovarë morën rrugën dhe ju bashkuan luftëtarëve në këtë vend. Ai dhe familja e tij jetonin pak kilometra larg luftës që po zhvillohej në Siri dhe në Shtetin Islamik të Irakut, por duke ndjerë rrezikun dhe duke parë shkatërrimin e vendit, ata vendosën të largoheshin nga vendi, ku kishin jetuar për shumë vjet.

Burhanudini pasi që vendosi të largohej nga Siria, së bashku me nënën, babain dhe 3 vëllezërit e tij, fillimisht nuk i kishin

dyert e hapura në shumë vende të Evropës. Por, ata emigruan në Kosovë, teksa strehim gjetën në qytetin e Prizrenit.

Paraprakisht ata jetonin në qytetin e Aleppos, ku kishin një jetë të mirë. Babai i Burhanudinit, Bekri Shishman ishte profesor i gjuhës arabe, e vëllezërit e tij vijonin shkollimin, ndërkohë pas ardhjes në Kosovë, familja Shishman hapi një biznes në Prizren, parfumerinë e quajtur “Uji Dukati”.

Ndërkohë Burhanudini ka thënë se ka shumë arsye se pse emigruan në shtetin ku kishte pak vjet që kishte dalë nga lufta, në Kosovë, sepse sipas tij, kishin lidhje familjare.

“Kosova është vendlindja e gjyshes sime, pra nënës së babait. Po ashtu, edhe nëna ime është me prejardhje nga Prizreni, andaj Kosova është shtëpia ime e dytë”, ka theksuar Shishman.

Ndërsa tash, disa vjet më vonë, Burhanudini përveç mësim-it të gjuhës shqipe, ka arritur të diplomojë në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT. Thekson se ka përfutur shumë njohuri në fushën në të cilën ka studiuar.

“Kam parë që shumë studentë të UBT-së kanë arritur të jenë shumë profesional dhe kanë dalë të kualifikuar pasi që përfunduan studimet, andaj kjo ka ngjallur interesimin tim për t’u regjistruar në UBT, sepse u binda që UBT ka vlera të mëdha”, ka thënë Shishman.

Tutje, ai ka thënë se stafi akademik dhe administrativ i UBT-së i ka ndihmuar jashtëzakonisht atij, përfshirë në pjesën e literaturës apo edhe shërbimeve të ndryshme, pasi që Burhanudini fillimisht nuk e njihnte mirë gjuhën shqipe.

“UBT-ja është institucioni ku kam mësuar mënyrën e të qenit kritik, më ka bërë profesional në profesionin tim duke

më ofruar literaturën e duhur, andaj më është bërë shumë e lehtë të studioj”, ka thënë ai.

Por, Burhanudini ka bërë të ditur edhe arsyet se pse vendosi ta studioj fushën e arkitekturës.

“Me dijeninë që e fitova në UBT, respektivisht në Fakultetin e Arkitekturës, synoj që të kthehem në Aleppo dhe të bëj plane e të rindërtojë edhe njëherë Sirinë pasi që është shkatërruar nga luftimet. Pra, kjo është ëndërr e imja”, pohoi Shishman.

Familja Shishman tashmë ka krijuar jetë të re në Kosovë, si dhe u pranuan shumë mirë në shoqëri, por se dëshira e tyre është që lufta në Siri të përfundojë e këta të kthehen në vendlindjen e tyre.

Studenti i UBT-së, Burhanudin Shishman në temën e diplomës të quajtur: “Konvikt dhe Qendër Studentore”, me mentor prof.dr Lulzim Beqiri, kishte trajtuar e projektuar një qendër studentore moderne, në kuadër të së cilës ofrohen shumë mundësi dhe aktivitete interaktive.

Derisa, i kënaqur nga rezultatet që ka arritur në studimet e deritashme dhe nga mundësitë që i ka ofruar UBT, Burhanudini tha se do të vazhdojë edhe studimet e nivelit master në këtë institucion.

Studentë të shumtë nga shtete të ndryshme të botës kanë zgjedhur UBT-në për të studiuar, si institucioni më inovativ i arsimit të lartë, në Kosovë. Duke qenë kështu, shumë studentë të huaj kanë filluar studimet ose janë në prag të përfundimit të studimeve themelore në UBT. Në mesin e tyre ishte edhe studentin Burhanudin Shishman.

Edona Jerliu

## Dikur student i UBT-së, tash student i Universitetit Teknik të Vjenës

Ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Dardan Kastrati ka arritur që të pranohet në Universitetin Teknik të Vjenës, në Austri, ku shumë shpejt pritet t'i fillojë studimet e nivelit master.

Ai thotë se pa UBT-në, pranimi në këtë universitet me renome botërore do të mbetej vetëm një ëndërr e paralizuar.

“Si çdo i ri që më tepër ka dëshira sesa njohuri për një profesion, edhe unë kisha paqartësi dhe nevojë për dituri e informata në rrafshin profesional, por falë ndihmës së profesorëve të Arkitekturës në UBT, unë i kam tejkalluar këto pengesa dhe të përgatitem profesionalisht, aq sa edhe të pranohem në një universitet me renome botërore dhe të realizoj ëndrrën time të kamotshme”, theksoi Kastrati.

Sa i përket kurrikulës së programit, ai u shpreh se mënyra e studimit dhe ligjërimit në UBT, është shumë e ngjashme me atë të Universitetit Teknik të Vjenës dhe sipas tij, ky fakt po i ndihmon atij të adaptohet me studimet në një universitet evropian.

Studenti Kastrati tregoi se gjatë kohës sa ishte në studimet bachelor, ai kishte bërë disa plane e projekte, të cilat u dërguan për realizim në Francë e Gjermani.

Ëndrra e këtij studenti për të ardhmen, është që të kthehet në Kosovë dhe të ofrojë kontributin e vet në dhënien e ideve dhe realizimin e projekteve inovative arkitektonike.



## Saranda Demolli pjesë e stafit të UBT-së



Studentja e Fakultetit Mekanikë dhe Menaxhment në UBT, Saranda Demolli është në prag të përfundimit të studimeve të nivelit bachelor, por njëherësh është e angazhuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore në UBT.

Paraprakisht, që nga fillimi i vitit të dytë të studimeve, Demolli është e angazhuar në punë praktike në Fakultetin Mekanikë dhe Menaxhment, e cila zhvillon tutorim në lëndën e matematikës.

“Të jesh pjesë e UBT-së, do të thotë të jesh në hap me trendin teknologjik të botës, sepse UBT-ja është institucioni ku jetësohet teoria në praktikë”, tha Demolli.

Studentja Demolli ka thënë se në UBT ka përfutuar eksperiencën të shumta akademike, e cila theksoi se përvojat

e fituara po i shërbejnë në profesionin dhe karrierën e saj. “Faleminderit UBT-së, që çdo herë krijon hapësirë për bashkëpunim me gjithë studentët e vet, tani njohuritë e marra në UBT do t'i shkëmbejmë me të tjerët”, tha ajo.

Fakulteti për Mekanikë dhe Menaxhment është i vetmi i këtij lloji në Kosovë, si dhe duke qenë kështu, ofron edukim profesional për gjithë studentët të cilët synojnë të studiojnë këtë fushë.

Studentët të cilët përfundojnë studimet në këtë fakultet, specializohen në profilet: menaxhim i mekanikës, automatizim industrial, dizajn të produkteve industriale, robotikë, inxhinieri biomjekësore, telekomunikacion, mekanikë, aeronautikë.

## Hera Luma menaxhere e projektit “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”

Studentja e Fakultetit të Shkencave Politike në UBT, Hera Luma është zgjedhur menaxhere e projektit “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”, projekt ky i organizuar si rezultat i bashkëpunimit ndërmjet OJQ-ve, “Nevo Koncepti” dhe “Save the Children International”.

Në kuadër të këtij projekti që po menaxhohet nga studentja Luma, do të organizohen gjithsej tetë trajnime, përmes të cilëve po synohet që të rriten kapacitetet vendimmarrëse të nxënësve në nivel lokal, përmes formimit

të një asambleje, që do t'i vetëdijesojë fëmijët për detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.

Ajo tha se puna si menaxhere në organizatën “Nevo Koncepti”, po i ndihmon asaj në rritjen e aftësive menaxheriale, si dhe në krijimin e idesë së qartë mbi punën nëpër institucione.

“Falë këtij angazhimi po e kuptoj se si janë të krijuara politikat për funksionimin e një asambleje në mënyrë më të mirë dhe më të suksesshme”, theksoi Luma.

Projekti “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”, ka mbajtur trajnimin e parë më temë: “Mediat dhe Komunikimi”, temë kjo që u zhvillua nga studentja e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, Anisa Rada, teksa trajnimet tjera që do të mbahen brenda periudhës gjashtëmuajore, do të trajtojnë temat: Avokimi, Të drejtat e fëmijëve, Qeverisja lokale, Shkrimi i projekteve dhe Mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

## Studenti i UBT-së, Ramiz Ismajli i punësuar në kompaninë “Mabetex”

Ramiz Ismajli është student i UBT-së, i cili po vijon suksesshëm studimet e nivelit master në Fakultetin për Marrëdhënie Ndërkombëtare, program të cilin UBT e ofron në bashkëpunim me Universitetin e Varshavës, në Poloni.

Studenti Ismajli është i punësuar në kompaninë ndërkombëtare “Mabetex”, ku ka pozitën e zyrtarit të prokurimit. Njëherësh, ai falë njohurive dhe eksperiencave ak-

ademike të fituara gjatë studimeve është kandidat për asamblist në Kuvendin e Komunës së Gjilanit.

“Në kohën kur isha në dilemë se ku do të studioja, unë vendosa të vij në UBT, si dhe kam zgjedhur programin e Varshavës, sepse në kuadër të këtij fakulteti i gjithë stafi akademik janë shumë të përgatitur profesionalisht”, ka thënë Ismajli.

Tutje, Ismajli theksoi se do të puno-

jë gjithmonë në ngjitje profesionale, me ç'rast në këtë aspekt, ai vlerëson se UBT ka strategji të cilat kombinohen me standarde ndërkombëtare.

Programi për Marrëdhënie Ndërkombëtare në UBT ofrohet për të gjithë studentët nga Kosova dhe më gjerë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në Universitetin e Varshavës, duke qenë pjesë e UBT-së, të cilët do të përfitojnë diplomë të dyfishtë.



## Vesa Morina fillon internshipin në UBT



Vesa Morina është studente e UBT-së, e cila po vijon suksesshëm studimet në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, ndërsa mendon që t'i vazhdojë studimet e nivelit master në të njëjtin drejtim.

Krahas studimeve në UBT, ajo është e angazhuar në punë praktike në Fakultetin Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, e cila zhvillon tutorim në lëndët java1 dhe java2.

Në kuadër të punës që po bën, studentja Morina i ndihmon studentët e

SHKI-së në lëndët e lartpërmendura duke ju ofruar ushtrime shtesë, përfshirë në teori dhe praktikë.

“UBT më ka mundësuar që dijen dhe eksperiencat akademike të cilat i përfitova në këtë institucion, t'i ndajë edhe me studentët e tjerë të SHKI-së. UBT është qendër e dijes dhe ekselencës, si dhe është i vetmi i këtij lloji që ofron cilësi e mundësi të mira për punësim e punë praktike, andaj jam shumë e kënaqur me pozitën time aktuale”, ka thënë Morina.

Tutje, ajo vlerësoi se programi akademik i

Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ofron mundësi të studimeve me një ambient të përshtatshëm universitar, në këtë mënyrë, studentët e këtij institucioni po i arrijnë qëllimet e veta.

Programet akademike në UBT, përfshirë edhe Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, zhvillohen me standardet më të larta kualitative ndërkombëtare, prandaj diploma e UBT-së njihet edhe ndërkombëtarisht.

## Kreshnik Zariqi i UBT-së, përfiton nga YouTube

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Kreshnik Zariqi është duke punuar online në YouTube, me ç'rast ka krijuar një llogari që tashmë është verifikuar nga ky uebsite dhe përmes saj, po gjeneron të ardhura financiare.

Nga kanali i vet në YouTube, ai publikon video të ndryshme, dhe në bazë të klikimeve që ato i arrijnë, ai përfiton financiarisht, e kjo e bën studentin Zariqi njërin ndër studentët e shumtë të UBT-së, që gjeneron të ardhura lehtësisht dhe pa pasur ndonjë vend specifik pune apo orar të caktuar.

Muaj më parë, ai ka punuar online edhe në eBay, një treg botëror online, që merret me shitblerjen e produkteve të ndryshme nga e mbarë bota.

Zariqi, aktualisht nuk e sheh të arsyeshme punësimin në një kompani, por thotë se po hulumton dhe po i zgjeron

aftësitë në një fushë shumë pak të zhvilluar në Kosovë, atë të punësimit online nëpër kompanitë më të mëdha dhe më të njohura në botë dhe shprehet se UBT i ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë për ta kuptuar më mirë këtë treg.

“UBT po më ofron një ndihmë të madhe sepse nga këtu kam arritur të fitoj njohuri shumë më të mëdha, më të detajuara dhe më të sakta, në lidhje me shumë çështje që kanë të bëjnë me tregun online të punësimit dhe mund të them se çdo ditë po përfitoj diçka të re”, vlerësoi ai.

Në UBT gjendet shkolla më e madhe e shkencave kompjuterike dhe inxhinierisë në vend dhe rajon, jo vetëm për nga numri i studentëve, por edhe për nga sukseset që ata po i arrijnë, përmes punësimit nëpër kompani të njohura vendore dhe ndërkombëtare, nëpër institucione shtetërore, apo edhe përmes vetëpunësimit.



## Studentja e UBT-së, Endrita Peqani e angazhuar në Zyrën për Informim në Lipjan



Studentja e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit, Endrita Peqani është në prag të përfundimit të studimeve të nivelit bachelor në UBT, por njëherësh është e angazhuar në Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, në komunën e Lipjanit.

Peqani, duke folur për përvojën në profesionin e saj, ka thënë se në këtë rrugë i kanë ndihmuar njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT.

“Gjatë studimeve në UBT, sigurisht që unë përfitova njohuri të shumta të cilat po mund t'i praktikoj në punën që jam e angazhuar. UBT i aftëson studentët e vet, si dhe, në këtë mënyrë, ata po dalin të kualifikuar në gjitha specializimet që i ofron fakulteti”, tha Peqani.

Po ashtu, ajo theksoi se UBT vepron, duke kombinuar teorinë dhe praktikën, njëherësh studentëve u mundëson edhe bursa të studimit.

Vlen të theksohet se një numër shumë i madh i studentëve të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, praktikojnë profesionin ende pa përfunduar studimet themelore, si dhe punësohen në institucione ose kompani të ndryshme mediatike.

Programi i studimit Media dhe Komunikim në UBT, ofron edhe specializimet: Gazetari, Komunikim, Menaxhim i Medias, Marrëdhënie me Publikun, Regji Televizive, Gazetari On-Line, Kamerë dhe Fotografi.

## Anisa Rada e UBT-së, trajnere në projektin “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”

Studentja e nivelit master, në Fakultetin Media dhe Komunikim në UBT, njëherësh edhe tutore në nivelin bachelor në po të njëjtin fakultet, Anisa Rada është duke marrë pjesë në cilësinë e trajneres në trajnimin e organizuar nga OJQ-të, “Nevo Koncepti” dhe “Save the Children International”, në Kosovë.

Gjatë këtij trajnimi, Rada është duke ligjruar për nxënësit përfaqësues të të gjitha shkollave fillore të Prizrenit, përzgjedhja e të cilëve është bërë nga këshilli i nxënësve të shkollave, nëpër të cilat ata e vijnë mësimin. Gjatë ditës së parë, ajo po trajton temën më titull: “Media dhe Komunikimi”, në kuadër të së cilës, nxënësit po informohen mbi konceptin e komunikimit, llojet, elementet përbërëse të komunikimit, pastaj për përkufizimin e mediave, llojet dhe dallimet mes tyre etj.

Kurse, nesër, gjatë ditës së dytë të trajnimit, Rada do të ligjërojë për temën: “Rrjetëzimi dhe përdorimi i rrjeteve sociale”, ku në kuadër të saj do të trajtojë kuptimin e rrjeteve sociale, përdorimin e tyre, rreziqet që vijnë nga

përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale, ngacmimet online, të ardhmen e rrjeteve sociale etj., teksa në fund, për këta nxënës, nën menaxhimin e saj, do të mbahet edhe një punëtori e thjeshtë mbi temat e trajtuara gjatë ligjëratave. Vlen të theksohet se studentja Anisa Rada është përzgjedhur nga organizatorët e këtij trajnimi, si më e kualifikuar për këtë pozitë, falë studimeve, por edhe përvojës profesionale që e ka fituar gjatë punës si tutore me studentët e nivelit bachelor.

Me këtë rast, ajo tha se një përvojë e tillë do të mbetet gjatë në kujtesën e saj dhe shprehet e lumtur që i është ofruar mundësia që t'i përçojë njohuritë e saj tek nxënësit e shkollave fillore, të cilët nuk kanë shumë informacione mbi këto tematika.

Trajnimi po mbahet në kuadër të projektit “Qeverisja e të drejtave të fëmijëve”, organizimi i të cilit është bërë falë bashkëpunimit mes OJQ-së “Nevo Koncepti” dhe “Save the Children International”.



## Studenti i UBT-së, pjesë e kompanisë së njohur “Kosbit”, partner i “AT&T”

Studenti i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Albion Sutaj, në prill të këtij viti është bërë pjesë e kompanisë “Kosbit L.L.C”, që është partner vendor i kompanisë së njohur në fushë e telekomunikacionit në nivel global, “AT&T”.

Në këtë kompani, studenti Sutaj mban pozitën e koordinitorit të projekteve DDPC, si dhe është i angazhuar edhe në përgatitjen e stafit të ri, që do të bëhet pjesë e kësaj kompanie, duke e dëshmuar faktin që studentët e UBT-së janë të suksesshëm jo vetëm në kompanitë vendore, por edhe në ato më të mëdha e më të suksesshme ndërkombëtare.

Ai thotë se të studiosh në UBT, do të thotë të studiosh në nivelin e duhur, sepse sipas tij, programi i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, është unik dhe i vetmi i tillë në Kosovë.

“Të kesh mundësi të studiosh në këtë institucion është

privilegj, pasi që nënkupton mundësi të shumëfishta për të ardhmen. Përparësi e UBT-së, padyshim, është edhe stafi akademik tejet i përzgjedhur, tek të cilët, fokusi kryesor mbetet tek aftësimi ynë, falë ligjëritimit interaktiv dhe metodave më bashkëkohore”, vlerëson Sutaj.

Suksesin e arritur në aspektin profesional, krahas angazhimit të tij, ai ia atribuon edhe UBT-së, me ç'rast shprehet se, “mundësitë që i ofron UBT janë garanci për një të ardhme të suksesshme për të gjithë ne studentët, andaj sugjerimi im për të gjithë studentët e rinj është UBT”. Në UBT gjendet shkolla më e madhe e shkencave kompjuterike në Kosovë e rajon, ku prej saj, çdo vit dalin qindra të diplomuar, shumica dërrmuese e të cilëve, ende pa i përfunduar studimet arrijnë të punësohen ose edhe të krijojnë bizneset e tyre personale, duke krijuar vende pune për vete dhe për njerëz të tjerë.



## Mbi 200 studentë të UBT-së, pjesë e universiteteve me te njohura në Evropë

Lum Dalipi, Ardian Lumi, Syzana Kajtažaj dhe Gentian Retkoceri, janë vetëm disa nga shumë studentë të UBT-së, të cilët kanë qenë pjesë e universiteteve më prestigjioze në Evropë, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UBT ka me mbi 300 universitete të ndryshme të Evropës e botës.

Disa nga këta studentë, këtyre ditëve janë kthyer nga Universiteti i Portugalisë, “NOVA de Lisboa”, ku kanë ndjekur studimet për një vit akademik në këtë universitet. Studenti Lum Dalipi shprehet i lumtur dhe i privilegjuar që ka përjetuar një përvojë të re në studime jashtë vendit dhe tha se kjo mundësi ka qenë ndër përvojat më të mira që ka përjetuar deri më tani.

“Çdo ditë ishte një mësim i ri atje. Kam mësuar shumë lidhur me profesionin, gjithashtu kam takuar shumë studentë të kombësive të ndryshme”, theksoi ai.

Studenti Dalipi, duke e ndarë përvojën e tij, shtoi se UBT është vend i mundësive për studentët e rinj që dëshirojnë të ndërtojnë një karrierë të suksesshme.

Edhe studentët e Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Ardian Lumi, kishte fatin që të studionte në Universitetin e Portugalisë, “NOVA de

Lisboa”.

“Pasi që UBT është partner me universitetin “Nova” të Lisbonës, më mundësoi që ta përfundoj një semestër në këtë vend evropian. Përvojën e fituar kam shumë dëshirë që në të ardhmen ta ndajë me njerëzit e vendit tim”, potencoi Lumi, teksa shtoi se, “studimet në Portugali, nuk kanë dallim me studimet që ofron UBT në Kosovë”.

Aktualisht, UBT ka mbi 200 studentë që janë duke vazhduar studimet nëpër universitetet më të njohura evropiane. Të gjithë studentët të cilët shprehin dëshirë të bëhen pjesë e UBT-së në të gjitha nivelet e studimeve, kanë mundësinë që automatikisht t’i vazhdojnë studimet jashtë vendit, në universitetet më prestigjioze në Evropë dhe nëpër vendet tjera të botës.



## Rinor Haliti i UBT-së, kameraman në KTV



Studenti i Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, Rinor Haliti është punësuar si kameraman në televizionin “KTV”, ende pa i përfunduar studimet e nivelit bachelor.

Ai tha se kjo punë është ajo që ai ka ëndërruar ta bëjë gjithmonë dhe se falë UBT-së dhe njohurive të fituara në studime, ëndrra e tij tashmë është jetësuar.

“Gjatë studimeve në UBT, kemi marrë mjaftueshëm njohuri, aq sa të pranohej lehtësisht në punë edhe nga televizionet më me zë, siç është KTV”, theksoi Haliti.

Tutje, ai shtoi se mënyra se si në UBT ligjërohet mbi të

gjitha llojet e mediave dhe punëve që bëhen brenda tyre, i mundëson çdo student të gjejë vetën dhe të jetë i suksesshëm në punën e zgjedhur.

Studenti Haliti tha se në planet e tij për të ardhmen, përfshihet vazhdimi i studimeve në UBT, si dhe vazhdimi i profesionit që ka zgjedhur në televizionin ku është duke punuar aktualisht.

Fakulteti i Medias dhe Komunikimit në UBT, për studentët e vet ofron këto specializime: Gazetari, Komunikim, Menaxhim i Medias, Marrëdhënie me Publikun, Regji Televizive, Gazetari Online, Kamerë dhe Fotografi.

## Studenti Sylja, i impresionuar me praktikën njëmuajore në kompaninë “Bechtel Enka”

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, Agron Sylja është njëri ndër studentët e UBT-së, i cili e ka përfunduar me sukses të lartë punën praktike në kompaninë “Bechtel Enka”, prej nga ka dalë me njohuri të shumta, të fituara gjatë përcjelljes së punimeve në autostradën “Arbën Xhaferi”.

Sylja tha se për të kjo praktikë njëmuajore ka qenë përvojë shumë e mirë profesionale, duke qenë se, sipas tij, projekti i autostradës është projekti me i madh kapital qeveritar.

“Të jesh pjesë e këtij projekti është një mundësi jashtëzakonisht e mirë sepse projektet e tilla nuk ndodhin shpesh, e sidomos në një territor relativisht të vogël që e ka Kosova për ndërtimin e autostradave”, theksoi ai, teksa vlerësoi se nga kjo praktikë të gjithë studentët kanë marrë njohuri të gjithanshme profesionale.

“Puna praktike përveç se do të na shërbejë në ngritjen e aftësive profesionale dhe në ndërlikimin e pjesës teorike dhe asaj praktike, në të njëjtën kohë, në të ardhmen do të ketë një rol të veçantë në konceptimin, planifikimin dhe projektimin e rrugëve”.

Falë bashkëpunimit të mirë të UBT-së me kompaninë “Bechtel Enka”, dy grupe studentësh të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, kanë përfunduar punën praktike njëmuajore, gjatë së cilës kanë ndihmuar në realizimin e projekteve dhe finalizimin e punëve të ndryshme në autostradën “Arbën Xhaferi”.

Vlen të theksohet se grupi i dytë, i përbërë nga shtatë studentë, ka filluar praktikën para pak ditësh dhe do të zgjasë gjatë tërë muajit shtator.



## Ish-studentja e UBT-së, arkitekte kryesore në kompaninë “Enggroup”

Ish-studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Tirana Selimi është vetëm njëra nga mijëra studentë e ish-studentë të UBT-së, të cilët me profesionalizmin e treguar, janë pranuar me lehtësi në tregun e punës.

Selimi, tash e pesë vite është pjesë e kompanisë së specializuar për projektim, “Enggroup”, në Prishtinë, ku e mban pozitën e arkitektes kryesore të kompanisë.

Para kësaj, ajo ka kryer internshipe në disa kompani e studio të arkitekturës, përfshirë studion “Alping, në Pr-

ishtinë”, “Meier-Koop”, si dhe ka qenë pjesë e punëtorisë “Connecting Dots”, që u mbajt në Stamboll, më 2014.

Selimi thotë se sukseset e arritura ia atribuon UBT-së dhe profesorëve të përgatitur në aspektin profesional.

“Studimet në UBT më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Fale profesorëve me renome botërore që ligjërojnë dhe që sjellin një frymë të re të arkitekturës dhe të të menduarit si arkitektë, ne si studentë kemi arritur ngritje profesionale”, vlerësoi ajo, teksa tregoi se në planin e saj për të ardhmen janë vazhdimet e studimeve të doktor-



## Studenti i UBT-së ndërton projektin “Solar Tracker” (Ndjekësi Solar)

Studentët e UBT-së, përveç anës teorike, ata angazhohen edhe në praktikë, duke projektuar dhe ndërtuar projekte atraktive dhe inovative.

Kësaj radhe, studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Inxhinierisë së Energjisë, Musa Rama ka realizuar një pro-

jekt shumë interesant. Ai ka punuar një projekt të quajtur “Solar Tracker” (Ndjekësi Solar), i cili lëviz me orientim të dritës.

Ky projekt ka për qëllim rritjen e efikasitetit të paneleve diellore, duke bërë përcjelljen apo ndjekjen e intensitetit

dhe burimeve të dritës.

Ndërkaq, student Rama, po ashtu e ka ndërtuar edhe modulën e kontrollit, duke bërë lidhjen servo të motorëve dhe të pjesës së kontrollit, duke përfshirë edhe programimin e mikrokontrollerit.

## Punimi shkencor i studentit të UBT-së, u zgjodh ndër më të mirët në konferencën “Teknologjia që punëson”

Punimi shkencor i Edi Bushatit, student i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, u zgjodh në mesin e punimeve më të mira në konferencën studentore “Teknologjia që punëson”, të mbajtur në Tiranë të Shqipërisë.

Krahas Bushatit, në këtë aktivitet fitues u zgjodhën edhe Hristo Miho nga Universiteti Metropolitan i Tiranës, Enxhi Kreshpa nga Universiteti Politeknik i Ti-

ranës, Ledia Maleqka dhe Rrezarta Meni nga Universiteti i Tiranës, të cilët fituan bursa të plota studimi, si dhe do ta kenë edhe mundësinë për të qenë të pranishëm në shkollën verore në Pragë, e mundësuar nga NATO, me të gjitha shpenzimet e mbuluara.

Në këtë konferencë, UBT u përfaqësua nga menaxheri i UBT-CERT, njëherësh ishte edhe anëtar i jurisë për përzgjedhjen

e punimeve më të mira të studentëve, At-dhe Buja, si dhe nga një grup i studentëve të SHKI-së.

Ky aktivitet u zhvillua nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike e Shqipërisë, në bashkëpunim me UBT-CERT, në kuadër të Javës së Shkencës, që po mbahet në Shqipëri.

Në fund të këtij aktiviteti, pjesëmarrësit u shpërblyen me certifikata pjesëmarrjeje.



## Mbi 20 studentë të UBT-së, pjesë e kompanisë “JusPost”



Mbi 20 studentë të Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, aktualisht janë duke punuar në kompaninë e themeluar së fundmi, “JusPost”, e cila ka për synim që t’i lidhë tregjet e pasurive të patundshme nga e mbarë bota, në të njëjtën kohë dhe në një rrjet të vetëm, ku përdoruesit do të jenë në gjendje të tregtojnë, shfletojnë dhe reklamojnë pronat e tyre dhe pasuritë e tjera të patundshme.

Themeluesi i kësaj kompanie, Haxhi Rugova tha se pjesa dërrmuese e stafit të

kompanisë është i përbërë nga studentët e UBT-së, dhe sipas tij, kjo më së miri e tregon nivelin e zhvillimit të tyre akademik e profesional.

“Ne jemi shumë të kënaqur që jemi duke bashkëpunuar me UBT-në, si me studentët, ashtu edhe fakultetin. Studentët janë shumë të talentuar dhe deri më tash kanë qenë të përkushtuar ndaj njëri-tjetrit, por mbi të gjitha, të përkushtuar ndaj arritjes së qëllimeve tona në realizimin e projekteve, andaj ne jemi të lumtur që ata

janë pjesë integrale e ekipit tonë në rritje”, theksoi Rugova.

Studentët janë të angazhuar në kompaninë “JusPost” si pjesë e stafit të rregullt, si dhe disa prej tyre janë duke kryer edhe punë praktike, me mundësi punësimi në të ardhmen, teksa angazhimi i tyre është vetëm një fakt që dëshmon për lehtësinë me të cilën studentët e UBT-së pranohen si vlerë shtesë në tregun e punës.

## Bashkëpunimi i UBT-së me Autostradën Biennale, komunitetit i sjell inovacione teknologjike dhe artistike

Studentët e Fakultetit të Mekatronikës në UBT, Kenan Alija dhe Kushtrim Ajazaj, si dhe nxënësi Nart Gashi, të udhëhequr nga profesori i UBT-së, prof. dr Valmir Hoxha, kanë realizuar njërin ndër inovacionet më të mëdha të edicionit të parë të Autostradës Biennale, robotin lypsar, projekt ky i artistit të njohur slloven, Sašo Sedlaček.

Roboti është ndërtuar për më pak se një javë, teksa realizimi i tij është bërë pa asnjë kosto financiare, nga hardueri kompjuterik tashmë i pashfrytëzuar.

Qëllimi kryesor për të cilin është ndërtuar ky robot është mbledhja e parave, me ç’rast funksionon si një agjenci zëvendësuese e krijuar për një botë, në të cilën të marginalizuarit, si individët dhe familjet

e varfra, refugjatët dhe azilkërkuesit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe ata të fshehtit nga sytë e publikut, kurrë nuk do të dalin në rrugë për të kërkuar lëmshë, me përjashtim të rrethanave të caktuara.

I lumtur me punën dhe ndihmën që kanë ofruar studentët në këtë aktivitet, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se qëllimi i institucionit të cilin ai e udhëheq, është që studentët t’i përfshijë në sa më shumë punë praktike, duke gjeneruar rezultate dhe kompetenca me njohuritë dhe aftësitë që i kanë.

“Ndërtimi i robotit është rezultat i dijes që gjendet brenda stafit dhe studentëve të UBT-së dhe ne jemi të lumtur që e kemi mundësinë t’i bashkojmë forcat tona me

festivale e ngjarje të ndryshme, në mënyrë që të sjellim diçka kreative dhe inovative në shërbim të shoqërisë”, theksoi Hajrizi. Artisti slloven, i cili e projektoi robotin lypsar, Sašo Sedlaček u shpreh i impresionuar me punën e bërë nga studentët e UBT-së, veçanërisht me profesionalizimin me të cilin kanë punuar ata.

“Studentët e UBT-së nga Prishtina, të udhëhequr nga profesori Valmir Hoxha, kanë bërë njërin ndër robotët më të avancuar deri më tani, madje edhe më të avancuar se një që e kam bërë në Japoni dhe jam plotësisht i kënaqur me rezultatin”, vlerësoi Sedlaček.

Me të njëjtën krenari, për studentët flet edhe mentori i tyre gjatë realizimit të

kësaj pune, prof. dr Valmir Hoxha, i cili tha se ata kanë punuar me një përkushtim dhe precizitet të madh.

“Studentët e UBT-së dhe nxënësi, kanë arritur që për një kohë rekord të zhvillojnë një robot të kompletuar dhe funksional”, tregoi Hoxha.

Roboti lypsar është i pari i këtij lloji i ndër-tuar ndonjëherë në Kosovë dhe momentalisht është duke qëndruar në hapësirën e Stacionit të Autobusëve të Prizrenit.

Ndërtimi i këtij roboti, ndër tjerash, do të luajë edhe një rol shumë të rëndësishëm humanitar, teksa pas përfundimit të Autostradës Biennale, ai do të vendoset në laboratorin e mekatronikës në UBT, dhe do të vazhdojë të shfrytëzohet për raste të ndryshme humanitare.



## Studentët e UBT-së përfundojnë internship-in në Autostradën Biennale

Studentët e UBT-së, të Departamentit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Dizajnit të Integruar, Medias e Komunikimit dhe Mekatronikës, kanë përfunduar internship-in e tyre dy-javor në festivalin e artit bashkëkohor, “Autostrada Biennale, që sivjet u mbajt për herë të parë në Prizren dhe mbledhi artistë të shumtë nga e mbarë bota, me misionin për të zgjeruar kulturën dhe

për të rigjallëruar komunitetin e saj. Studentët kanë funksionuar në mënyrë të organizuar dhe kanë dhënë kontribut nëpër departamente të ndryshme, duke kryer punët dhe angazhimet në cilësinë e stafit ose vullnetarëve. Ata janë duke ndihmuar në punët organizative, në menaxhimin e hapësirave, në punët e produksionit, në koordinimin dhe mbulueshmërinë e anës mediale, si dhe në përgatitjen e skenave

dhe ndërtimin e robotëve, që janë nga artistët për realizimit të veprave të tyre artistike.

Bienalja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor, “Autostrada Biennale”, e cila në edicionin e vet të parë po trajton temën “E ardhmja e kufijve”, është hapur më 19 gusht dhe do të zgjas deri më 23 shtator.

## Studentët e UBT-së, lehtësisht të qasshëm në tregun e punës

Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Blerta Emini, e cila aktualisht është në përfundim të studimeve master, tash e tri vite është duke punuar në byronë projektuese “ARCHIDES”, në Prishtinë, byro kjo që merret kryesisht me pjesën e enterierit.

Emini tha se studimet në UBT, i kanë ndihmuar asaj për t’u qasur me lehtësi në tregun e punës, teksa shtoi se meritat për

suksesin e saj dhe të studentëve tjerë, i kanë edhe profesorët maksimalisht të përgatitur. “Studimet në UBT më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë, kjo falë profesorëve që ligjërojnë në atë formë që, studentët të jenë të gatshëm për tregun e punës, si dhe fokusohen në gjëra praktike, të cilat na shërbejnë gjatë karrierës”, vlerësoi ajo, teksa shtoi se, “edhe lëndët me profesorët e huaj na kanë sjellë njohuri dhe mënyra të

reja të të menduarit si arkitektë”.

Studentja Emini ka qenë edhe pjesë e internshipit, që UBT e ofron për studentët e vet të dalluar nëpër të gjitha departamentet, përmes të cilit ka për qëllim t’i stimulojë studentët për t’u rritur në aspektin profesional, duke punuar përkrahë ekspertëve të njohur vendorë e ndërkombëtare në fushat përkatëse, të cilët janë njëherësh edhe pjesë e UBT-së.



## Dy studentë të UBT-së fitojnë bursë të plotë nga Morehead State University, në SHBA



Pas suksesit të treguar nga studentët e UBT-së, në hulumtimin e përbashkët me Morehead State University, në SHBA, ky universitet ka ofruar dy bursa të plota studimi për studentët e UBT-së për master. Studentët e UBT-së shfaqën përvojën dhe angazhimin e tyre dhe u treguan shumë të suksesshëm në një hulumtim, i cili kishte të bënte me analizimin e ndërlidhjes mes realitetit virtual dhe kontrollerëve industrialë, të dr. Jorge Ortega nga Departamenti për Menaxhimin e Inxhinierisë dhe

Teknologjisë brenda Morehead State University.

Studentët e UBT-së, gjatë muajit të kaluar kanë qëndruar në MSU dhe gjatë asaj kohe kanë përfunduar trajnimet për Fanuc Robot, teksa vlen të theksohet se studentët e UBT-së ishin mjaft të suksesshëm edhe në testimin për certifikim.

Ata janë pajisur me certifikata të njohura ndërkombëtarisht për kontributin e dhënë në hulumtim.

## Studentët e Arkitekturës në UBT, pjesë e rëndësishme e projektit për shëtitoren në Fushë Kosovë



Katër studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, në kuadër të bashkëpunimit me Fondacionin Kosovar të Arkitekturës, kanë qenë pjesë e projektit njëvjeçar të komunës së Fushë Kosovës.

Projekti ka të bëjë me shndërrimin e rrugës "Dardania" në Fushë Kosovë, në shëtitore.

Sipas studentëve, projekti është finalizuar dhe është aprovuar nga Komuna e Fushë Kosovës, teksa ky projekt është realizuar në vazhden e bashkëpunimit me Fondacionin Kosovar të Arkitekturës (KAF). Studentët thanë se ky projekt do të mundësojë qarkullim të lirë të qytetarëve, si dhe do të ofrojë mundësi relaksimi për qytetarët.

## Studentët e UBT-së, pjesë e rëndësishme e festivalit ndërkombëtar "DokuFest"



Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, po marrin pjesë në festivalin ndërkombëtar të dokumentarëve dhe filmave të shkurtër "DokuFest", festival i cili organizohet tash e gjashtëmbëdhjetë vite, në Prizren.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me drejtuesit e festivalit, sipas së cilës është hartuar një projekt i përbashkët, në kuadër të të cilit studentët e Fakultetit për Media

dhe Komunikim janë angazhuar në përcjelljen e ngjarjeve me shkrime dhe video-materiale.

Qëllimi i bashkëpunimit mes UBT-së dhe DokuFest-it është që studentët të përfitojnë përvoja profesionale si dhe të aftësohen për profesionin e tyre.

Përmes këtij projekti synohet që, në kuadër të bashkëpunimit, studentët të kenë mundësi të ushtrojnë profesionin në

aspektin praktik, të punojnë dhe njëkohësisht të fitojnë disiplinë në punë si dhe atyre u krijohet mundësia që të punojnë me staf profesional të mediave.

Projekti ka filluar në maj të këtij viti dhe pritet të përfundojë më 14 gusht, me ç'rast për studentët pjesëmarrës do të ndahen certifikata nga UBT dhe "DokuFest".

## Gentiana Xhemaili e UBT-së, e punësuar në Komunën e Prishtinës

Studentja e UBT-së, Gentiana Xhemaili, e cila i ka përfunduar studimet e nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, që nga viti 2015 është e punësuar në Komunën e Prishtinës, në pozitën e arkitektes në Zyrën për Rigjenerim Urban, ku përveç përgatitjes së projekteve të ndryshme, ajo bënë edhe menaxhimin dhe mbikëqyrjen e projekteve.

Para kësaj përvoje, Xhemaili ka punuar si arkitekthe në studiot e arkitekturës, "ViaArchitects" dhe "Unit Grup", si dhe në kompaninë "HymeriKleman".

Ajo tha se njohuritë e fituara në UBT dhe dashuria për profesionin, i kanë ndihmuar që të përmirësohet dhe të arrijë të zgjerojë njohuritë profesionale, por edhe të fitojë vendin e saj të punës.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT është njëra ndër shkollat më të mëdha për arkitekturë në vend e rajon, teksa shumica e studentëve arrijnë të kyçen në tregun e punës ende pa i përfunduar studimet themelore.



## Studentja dhe profesori i UBT-së, pjesë e rëndësishme e Shkollës Verore Ndërkombëtare, në Kroaci



Sukseset e studentëve dhe stafit të UBT-së nuk kanë të ndalur. Ata po përfaqësojnë Kosovën nëpër ngjarjet dhe konferencat e ndryshme jashtë vendit.

Së fundmi, studentja në Fakultetin Politika Publike dhe Menaxhim në UBT, Kristina Quni ka marrë pjesë në Shkollën Verore Ndërkombëtare, në ishullin Shipanë të Kroacisë.

Kjo shkollë ka trajtuar temën më titull: "Roli i ri i NATO-s dhe sfidat e saj në Ballkanin Perëndimor", teksa është organizuar nga Këshilli i Atlantikut të Kroacisë dhe

nga Instituti Ndërkombëtar për Paqe i Austrisë.

Krahas kësaj, në këtë shkollë ka ligjruar edhe profesori i UBT-së, prof.dr Ylber Sela.

Ligjërata e tij ka trajtuar temën më titull: "Sfidat dhe mundësitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt integriteteve euroatlantike".

Gjithashtu, në këtë shkollë ligjruan profesorë, diplomatë dhe politikanë të shquar nga Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Austria, Italia, Amerika, Rusia dhe Izraeli.



Suksese të studentëve të UBT-së

## Feim Brava krijon fabrikën e parë në regjion për prodhimin e paneleve

Ish-studenti i programit Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci në nivelin master, Feim Brava, tashmë pjesë e stafit të UBT-së, ka filluar të prodhojë diçka të veçantë për tregun tonë, por edhe më gjerë.

Për herë të parë në Kosovë, ai ka krijuar fabrikën “Euro Panel”, në Obiliq, që merret me prodhimin e paneleve. Sipas tij, panelet janë produkte shumë të kërkuara në tregun vendor e ndërkombëtar dhe po përdoren me të madhe në ndërtimtari, andaj përmes prodhimit të tyre në kompaninë e tij, ai po synon ta mbulojë tregun vendor, por edhe atë ndërkombëtar.

“Çdo vit në Kosovë importohen në vlerë tregtare rreth 10 milionë euro panele nga vendet e ndryshme të botës, kurse tash, ne jemi prodhuesit e vetëm të paneleve në Kosovë dhe regjion”, tregoi Brava, teksa shtoi se ka zgjedhur pa asnjë ngurrim t’i punësojë studentët e UBT-së, sepse sipas tij, i plotësojnë të gjitha kriteret që kërkohen në tregun e punës.

“UBT është një nga institucionet më serioze dhe që i aftëson studentët për tregun e punës. Jam jashtëzakonisht i

kënaqur dhe besoj se ky bashkëpunim do të funksionojë shumë mirë sepse UBT ka qenë njëra nga mundësitë më të mëdha për mua, veçanërisht falë bashkëpunimit me rektorin Edmond Hajrizi”.

Ndonëse niveli i ulët i punësimit të të rinjve kosovarë është në shifra të ulëta, ish-studenti Brava ka siguruar punë edhe për dhjetëra studentë të UBT-së, t cilët janë duke ndërtuar karrierë në profesionin e tyre.

Njëri ndër studentët e punësuar në kompani, Gentrit Makolli tha se asnjëherë nuk e kishte menduar se do të mund të punësohet ende pa i përfunduar studimet.

“Kjo është një mundësi shumë e mirë për ta dëshmuar veten, por edhe me siguruar të ardhura sepse kur filluam fakultetin para tri viteve, nuk kam menduar që do të jetë kaq e thjeshtë të punësohesh”, tregoi studentit Makolli. Rreth 90% e studentëve dhe ish-studentëve të UBT-së, kanë arritur të punësohen nëpër kompani të ndryshme, por edhe të krijojnë kompanitë e tyre, duke gjeneruar vende pune jo vetëm për veten, por edhe për të tjerët.



## Esat Xani i vetmi në Kosovë i diplomuar në nivelin master për Sisteme të Informacionit



Studenti i UBT-së, Esat Xani ka diplomuar në nivelin master, në Fakultetin Sisteme të Informacionit, i cili ka trajtuar temën të titulluar: “Përdorimi i teknologjisë UAV (fluturake pa pilot) në kadastrën e Kosovës”.

Ai është i pari në Kosovë, i cili diplomon në nivelin master në këtë fushë mjaft delikate.

Fokusi kryesor i temës që ka trajtuar është vërtetimi për përdorimin e teknologjisë UAV në kadastrën e Kosovës. Po ashtu janë bërë analiza me projekte të ngjashme, që janë realizuar në rajon dhe në botë, si dhe e tërë puna është bërë nën mentorimin e profesorit Hazer Dana.

Po ashtu, punimi shpjegon procesin dhe rezultatet lidhur me pilot projektin që është realizuar në Kosovë në fund të vitit 2015 dhe në vitin 2016 nga Agjencia Kadastrale e Kosovës në mbështetje të Bankës Botërore.

Teksa, vetë studentit Xani ka konstatuar se teknologjia UAV

lehtëson shumë prodhimin e ortofotove dhe hartave 3D të cilat mund të gjejnë përdorim të gjerë në kadastrë. Sipas tij, përdorimi i teknologjisë UAV së bashku me softuerë “open source” është shumë i lehtë dhe praktik për përdorim, të cilin është munduar edhe ta sqaroj në këtë punim.

Studimi në Fakultetin e Sistemeve të Informacionit në UBT, i aftëson studentët për të zhvilluar zgjidhje kreative dhe inovative të problemeve dhe mundësive në organizata qeveritare, në biznese dhe organizatat jofitimprurëse dhe kjo mund të bëhet në të dy nivelet, bachelor e master.

Studimi në këtë fakultet mundëson njohjen dhe kuptimin e ndërlidhjes, të komunikimit dhe të funksionimit në mes të menaxhimit (proceseve biznese/organizative), menaxhmentit (strukturës biznese/organizative) dhe të teknologjisë (kompjuterëve, rrjetave, software-ve, hardware-eve, bazës së të dhënave, serverëve, etj.).

## Qëndrim Begisholli pranohet në Universitetin Politeknik të Milanos

Ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Qëndrim Begisholli është pranuar në Universitetin Politeknik të Milanos, për të vazhduar studimet e nivelit master në këtë drejtim.

Aktualisht ai po vijon studimet në specializimin për struktura komplekse, teksa ka thënë se kjo ka qenë ëndërr e tij, pra t’i vazhdoj studimet jashtë vendit.

“Për studimet e nivelit baçelor pata zgjedhur UBT-në, ngaqë është më cilësori, si dhe një prej institucioneve që ofron shumë mundësi, përfshirë edhe studime jashtë vendit. Po përgatitem profesionalisht në këtë fushë falë edhe shumë profesorëve në UBT”, ka thënë Begisholli.

Tutje, ai ka thënë se UBT i ndihmon studentët e vet, duke

i përgatitur profesionalisht për vazhdimin e mëtejshëm të studimeve, si master ashtu edhe për doktoratë.

Vlen të theksohet se shumë studentë të UBT-së, po vazhdojnë studimet e nivelit master falë konkretizimit ose marrëveshjeve të bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Milanos dhe jo vetëm.

Institucionet, pra UBT dhe Universiteti Politeknik i Milanos, kanë zgjeruar bashkëpunimin dypalësh, përfshirë këtu edhe realizimin e projekteve të përbashkëta në Erasmus+, Horizon 2020, Marie Curie Actions etj., përmes të cilave do të mundësohet edhe shkëmbim i studentëve dhe stafit akademik.



## Studentja e UBT-së, Ilda Bicurri e angazhuar në studio të dizajnit të modës



Ilda Bicurri është studente e nivelit baçelor, e cila vijon suksesshëm studimet në vitin e dytë, në Fakultetin Dizajn i Integruar në UBT. Falë praktikave dhe trajnimeve të zhvilluara në UBT, aktualisht ajo është angazhuar në studio të dizajnit të modës, tek kreatorja e njohur Drenusha Xharra.

Studentja Bicurri ka theksuar se është mahnitur me atë çfarë ofron ky fakultet në UBT. Sipas saj, fakulteti posedon studiot më moderne në vend dhe më gjerë, njëherësh është shkolla e parë e këtij lloji në Kosovë.

“Programi që aplikohet në kurset studimore në UBT-së, pra në Fakultetin Dizajn i Integruar, ofron qasje sistematike kundrejt modës, në kuadër të së cilës zhvillohen koncepte të kërkimit kreativ. Duke qenë kështu falë shumë mundësive të ofruara nga UBT, praktikat më të mira që i mësova, po i aplikoj në këtë studio të dizajnit ku jam e angazhuar”, tha Bicurri.

Tutje, ajo ka thënë se UBT është institucion ku i mundëson studentëve të vet trajnime të ndryshme, si dhe vizita të shumta studimore. Teksa shtoi se e veçanta e këtij programi është se ofrohet për herë të parë në stilin e integruar.

Një numër i konsiderueshëm i studentëve të Fakultetit Dizajn i Integruar në UBT, ende pa përfunduar studimet punësohet ose mbajnë praktikë, në studio të shumta të dizajnit të modës ose të produkteve.

## Getoar Salihu asistent i drejtorit të kompanisë “A Con SHPK”



Studenti i UBT-së në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Getoar Salihu, i cili ka përfunduar suksesshëm studimet themelore në këtë drejtim, është punësuar në kompaninë ndërtimore “A Con SHPK”.

Aktualisht, në këtë firmë ai mban pozitën e asistentit të drejtorit gjeneral të firmës, si dhe merret kryesisht me punët e prokurimit.

Studenti Salihu ka thënë se në aktivitetin me të cilin merret, aplikon praktikën të cilat i ka praktikuar si student në UBT. Sipas tij, meritat për arritjet e tij në profe-

sion, janë të UBT-së.

“Kam përfituar shumë, sidomos në lëndën e betonit, ku profesorët e kanë ligjësuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Andaj, studimet më kanë shërbyer në ngritje si në profesion, ashtu edhe në kualitetin e punës”, theksoi Salihu.

Paraprakisht, studenti i UBT-së, Getoar Salihu ka qenë i punësuar edhe në kompaninë e ndërtimit “Al Trade”, ku është marrë me shumë projekte.

Ai ka qenë i angazhuar edhe në projektin për trajtimin e ujërave në Shkabaj, projekt i cili është udhëhequr nga kompania e njohur “Strabag AG”.

“UBT i përgatit studentët gjithmonë për tregun e punës. Studentët e UBT-së përfitojnë njohuri të shumta, si nga ana teorike, gjithashtu edhe në atë praktike”, tha Salihu.

Qindra studentë të UBT-së, që përfundojnë studimet në fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, punësohen ose kërkohen në tregun e punës, kjo pasi që ata aftësohen për punët e ndërtimit konstruktive dhe

## Studenti i UBT-së, Ermal Osaj i angazhuar në kompani të ndërtimit



Studenti i UBT-së në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Ermal Osaj, i cili tashmë është duke përfunduar suksesshëm studimet themelore në këtë drejtim, është punësuar në kompaninë e ndërtimit “R&RUKOLLI”.

Aktualisht në këtë firmë ai mban pozitën e udhëheqësit të punimeve në ndërtimin e komplekseve afariste-banesore tek lagjja Mati I.

Studenti Osaj ka thënë se po fiton përvojë profesionale me aktivitetin që ushtron dhe, sipas tij, meritat për këtë janë të UBT-së.

“UBT i përgatit studentët gjithmonë për tregun e punës. Studentët e UBT-së përfitojnë njohuri të shumta, si nga ana teorike gjithashtu edhe në anën praktike. Ky institucion i ofron studentëve kushte, kualitet në punës dhe programe akademike”, ka thënë Osaj.

Paraprakisht, studenti i UBT-së Ermal Osaj ka qenë i punësuar edhe në kompaninë e ndërtimit “Al Trade”, ku është

marrë me shumë projekte. Ai kryesisht ka qenë i angazhuar në projektin si atë për trajtimin e ujërave në Shkabaj, projekt sipas të cilit është udhëhequr nga kompania e njohur “Strabag AG”.

Ai ka thënë se kompania në të cilin aktualisht punon, ka shprehur interesimin për të bashkëpunuar me UBT-në, në mënyrë që studentët e drejtimeve përkatëse të vizitojnë punimet që realizon “R&RUKOLLI”, në mënyrë që të praktikojnë anën teorike.

## Ish-studenti Roni Kasemi, i punësuar në kompaninë Machinery Technology Company



Ish student i UBT-së Roni Kasemi, menjëherë pas përfundimit të studimeve në bachelor, në drejtimin e Menaxhimit të Mekatronikës, është punësuar në kompaninë Machinery Technology Company. Aktualisht, ai po punon si inxhinier i servisit të makinave të kësaj kompanie, e cila merret me prodhimin e makinerive për riciklimin, shtrimin dhe prodhimin e as-

faltit, si dhe për përpunimin e mineraleve. Sipas Kasemit, studimet në UBT e kanë përgatitur mjaft për tregun e punës, ku ai tregoi se gjatë studimeve kishte mundësi ta ushtronte profesionin edhe në vende tjera të punës.

“Studimet në UBT më kanë përgatitur në karrierë, ku një prej veçorive kryesore që kam përfituar gjatë studimeve, ka qenë

fleksibiliteti për t’u përshtatur në ambiente të ndryshme të punës”, vlerësoi ai.

Tutje, studenti Kasemi tha se UBT si institucion i arsimit të lartë, ka një kuadro profesional, një planprogram të shkëlqyer dhe të gjitha kushtet e duhura për studime, gjëra të cilat, sipas tij, e bëjnë këtë institucion të dallohet nga shumë institucione të tjera në vend.

## Studentja Shala fillon internshipin në UBT, falë sukseseve të treguara gjatë studimeve

Arjeta Shala është studente e UBT-së, e cila po përfundon suksesshëm studimet në Fakultetin Juridik, ndërsa mendon që t’i vazhdojë studimet e nivelit master në të njëjtin drejtim.

Krahas studimeve në UBT, ajo është e angazhuar në Qendrën e Karrierës në UBT, ku mban pozitën si asistente në aktivitete të cilat janë kompetencë e kësaj qendre.

Studentja Shala tha se në kuadër të punës që zhvillon, i njofton, këshillon dhe orienton studentët për konkursat e punësimit, çështje këto që janë me interes për të gjithë studentët.

“UBT është institucion i arsimit të lartë, që studentëve u jep mundësi shumë të mira, përfshirë aftësimin për tregun e punës, u ndihmon studentëve për depërtim në tregun e punës, njëherësh ndanë edhe bursa për studentët e

dalluar”, theksoi Shala.

Tutje, ajo vlerësoi se programi akademik i Fakultetit Juridik në UBT, ofron mundësi të studimeve të aspekteve ligjore me një ambient të përshtatshëm universitar, në mënyrë që studentët të arrijnë qëllimet e veta.

“UBT-ja më ka ndihmuar shumë në profesionin që kam zgjedhur për faktin se kam përfituar shumë si nga ana teorike, ashtu edhe në atë praktike. Jam aftësuar për këtë drejtim, andaj do të kontribuoj në zhvillimin e një shoqërie juridike”, potencoi Shala.

Programet akademike në UBT, përfshirë edhe Fakultetin Juridik, zhvillohen me standardet më të larta kualitative ndërkombëtare, prandaj diploma e UBT-së njihet edhe ndërkombëtarisht.



## Studenti i UBT-së, i punësuar në komunën e Rahovecit

Studenti i UBT-së, Bylbyl Hoxha, i cili aktualisht është duke i vijuar studimet e nivelit master në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, tash e një vit është duke punuar si zyrtar i vlerësimit të pronës në drejtorinë e Financave, në komunën e Rahovecit.

Në këtë vend të punës, ai është sistemuar falë aftësive të treguara, teksa sipas tij, në këtë sukses ka ndikuar edhe edukimi kualitativ që ofron UBT.

“Kam fituar përvojë të re, kam mësuar si të punoj në grup, si dhe kam vënë në praktikë teorinë dhe praktikën e mësuara në UBT, pra, në këtë mënyrë më është lehtësuar puna jashtëzakonisht shumë”, tha ai.

Tutje, studenti Hoxha theksoi se do të punojë që t’i re-

alizojë synimet e tij, përfshirë edhe vazhdimin e studimeve, ku shtoi se, UBT ka strategji të cilat kombinohen me standarde ndërkombëtare.

“Ky institucion është vendi ku mund të studiosh dhe të punosh. Andaj, mendoj të vazhdoj studimet në këtë institucion, duke marrë parasysh se UBT është partner me shumë universitete ndërkombëtare, pra, dua të përfitoj nga këto programe dhe të bëhem doktor shkence”, theksoi Hoxha.

Programet akademike në UBT ofrojnë njohuri teorike dhe praktike, andaj, në këtë mënyrë studentët avancohen dhe bëhen të gatshëm për tregun e punës.





## Studenti i UBT-së, i punësuar në byronë “ArchiPoints”

Studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Hekuran Tërpeza është duke punuar në byronë projektuese “ArchiPoints”, në Prishtinë, në cilësinë e arkitektit.

Tërpeza thotë se është sistemuar në këtë vend pune ende pa i përfunduar studimet themelore, teksa për këtë sukses të arritur, vlera i atribuon edhe UBT-së.

“UBT dhe profesorët më kanë ndihmuar tejet shumë në zgjerimin e njohurive të mia rreth arkitekturës, por edhe në sistemimin tim në tregun e punës”, tha ai.

Për studentin Tërpeza, rrugëtimi drejt ngritjes në karrierë nuk përfundon këtu, pasi që, ai së shpejti planifikon t’i fillojë studimet në nivelin master.

## Fortesa Krasniqi e UBT-së, pjesë e shumë mediave vendore

Studentja e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit, Fortesa Krasniqi, ende pa i përfunduar studimet e nivelit bachelor në UBT, është sistemuar në tregun e punës, me ç’rast pas shumë përvojave në media të shkruara e audiovizuale, aktualisht është duke punuar në portalin OnAir Media.

Duke folur për përvojën e saj në gazetari, Krasniqi tha se në këtë rrugë i kanë ndihmuar njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT.

“Mund të them me plot bindje se njohuritë që i kam marrë në UBT, më kanë shërbyer shumë gjatë eksperiencave të

ndryshme në punë sepse falë përkushtimit të stafit akademik, tashmë i kam arritur synimet e mia”, vlerësoi ajo, teksa shtoi gjatë katër viteve përvojë pune, deri tash ka punuar në Radio Dukagjin, në RTK, pastaj në Gazetën Express dhe në Sovrani.info.

Falë gërshetimit të teorisë dhe punës praktike gjatë viteve të studimeve, shumica e studentëve të UBT-së janë të kërkuar dhe të përgatitur për tregun e punës ende pa i përfunduar studimet themelore.



## Studentja e UBT-së, e punësuar në Raiffeisen Bank



Studentja e UBT-së, Arbënora Maliqaj, e cila aktualisht është duke i vijuar studimet e nivelit master në Fakultetin për Ndërmarrësi dhe Menaxhim të Inovacionit, tashmë është punësuar në bankën Raiffeisen dhe po mban pozitën e udhëheqëses së ekipit të agjendave të shitjes për rajonin e Prishtinës.

Studentja Maliqaj tregoi se sa ishte studente në nivelin bachelor në UBT, kishte filluar me praktikë në këtë bankë, por më pas, falë aftësive të treguara, ishte sistemuar me punë të rregullt. “Jam shumë falënderuese ndaj UBT-së, për bazën e njohurive që më ka ofruar gjatë këtyre viteve dhe që më kanë bërë të futem në treg të punës. UBT na ka dhënë mundësi që në kuadër të studimeve bachelor, të marrim pjesë në trajnime

në fushën e biznesit, përfshirë trajnimet në banka dhe organizata”, tha ajo.

Tutje, Maliqaj theksoi se do të punojë në ngjitje profesionale, ku me ndihmën, përkrahjen dhe motivimin nga profesorët, shpreson se do të t’i realizojë synimet e saj, me ç’rast në këtë aspekt, ajo vlerëson se UBT ka strategji të cilat kombinohen me standarde ndërkombëtare. Sipas saj, ky institucion është vendi ku mund të studiosh dhe të punosh.

UBT është institucion i arsimit të lartë, që u mundëson studentëve zhvillim të karrierës së tyre në fusha të ndryshme, që janë të përpiluara në atë mënyrë që, ata të marrin njohuri dhe praktika të avancuara.

## Studenti i UBT-së, Gent Reshtani punësohet në kompaninë Kosbit.net

Studenti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Gent Reshtani, i cili është në përfundim të vitit të parë të studimeve, është punësuar në kompaninë e IT-së, Kosbit.net, teksa më vonë, kjo kompani ia ka dhënë atij mundësinë që të punojë edhe për korporatën amerikane “AT&T”.

Aktualisht, ai po punon si arkitekt i zgjidhjeve teknike, përkatësisht i rrjetave kompjuterike për këtë korporatë amerikane, ku obligimi i tij është menaxhimi i pajisjeve, dizajnimi në nivel të lartë i rrjetave dhe përkthimi i shërbimeve në pajisje fizike për klientët e AT&T-së.

Sipas Reshtanit, praktika duhet të kompletojë diturinë teorike, andaj për këtë arsye, ai thotë se e ka zgjedhur

UBT-në.

“Si një institucion në të cilin jam zhvilluar dhe po vazhdoj të zhvillohem, vlerësoj se stafi profesional i UBT-së dhe kurrikula, në bazë të së cilës i zhvillojmë studimet, vlerësoj se janë shtytës që përveç mësimëve teorike, të ndjek edhe anën teknike të zhvillimit”, theksoi ai.

Tutje, studentin Reshtani tha se këshilla e tij është që të gjithë të rinjtë të sfidohen për avancim profesional dhe akademik dhe si persona që dëshirojnë një të ardhme më të mirë për veten dhe vendin.

Sikurse në drejtimet tjera, ashtu edhe në drejtimin e SHKI-së, UBT po vazhdon të sistemojë në treg, të rinj entuziastë dhe të suksesshëm për punën që e bëjnë.



## Studenti i UBT-së, Liridon Parduzi përfaqësoi Kosovën në “Berlin Startup Camp”



Ish-studenti i UBT-së, Liridon Parduzi ka përfaqësuar Kosovën në organizimin “Startup Camp”, në Gjermani, ku ka shpalosur idenë për biznes planin e tij, që ka të bëjë me krijimin e një ueb sistemi të quajtur “MosPrit”, që i dedikohet udhëtarëve.

Konceptin për biznesin e tij, Parduzi e ka prezantuar para shumë ndërmarrësve dhe investitorëve potencialë nga e gjithë bota.

“Berlin Startup Camp” i përkrah ndërmarrësit e rinj që duan të fillojnë biznesin e tyre.

Misioni i këtij organizimi është të lidhë themeluesit, startuesit dhe investitorët me njëri-tjetrin për të krijuar një rrjet të gjerë. Po ashtu, “Startup Camp”, ky organizim ka për qëllim mësimin e përbashkët dhe një imazh poziti

tiv të biznesit.

Liridon Parduzi ka mbaruar suksesshëm studimet në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në UBT. Nga studimet ai thotë se ka përfituar njohuri teorike dhe praktike në zhvillimin e ueb sistemeve, si dhe ka mësuar arkitekturën e sistemeve kompjuterike në përgjithësi.

Ai është fitues i vendit të parë nga trajnimet që ka marrë pjesë me organizatën “GIZ”, për idetë dhe prototipet e zhvilluara.

Veç kësaj, për disa muaj me radhë ai ka punuar në kompaninë teknologjike “LinkPlus”, ku është marrë me zhvillimin e softuerit të specializuar në ndërtimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve të lëvizshme në shkallë të gjerë.

## Studentët kosovarë takohen me kryeministrin e Portugalisë



Studentët e SHKI-së, Ardian Lumi dhe Lumi Dalipi, të cilët aktualisht janë duke i vazhduar studimet në Universitetin NOVA de Lisboa, të Portugalisë, janë takuar me kryeministrin e këtij shteti, António Costa, me ftesën e zyrës së tij.

Takimi është mbajtur me qëllim të festimit të 30 vjetorit të themelimit të programit Erasmus+, si dhe për të shënuar përmbylljen e aktivitetit “Java e Rinisë Evropiane”.

Të ftuar në këtë takim kanë qenë studentë nga shtete të ndryshme të botës, të cilët studiojnë në drejtime dhe në nivele të

ndryshme studimi në shtetin e Portugalisë dhe që njëherësh janë edhe përfitues të bursave, të cilat i ndan programi Erasmus+.

Më pas, kjo ngjarje është pasuar me diskutime rreth programit, si dhe me rrëfime personale të studentëve, që kanë marrë pjesë dhe kanë përfituar nga ky program. Një numër i madh i studentëve të UBT-së janë përfitues të bursave, të cilat ndahen nga programi Erasmus+, falë marrëveshjes së arritur mes tyre disa vite më parë.

## UBT u ofron mundësi për punë praktike studentëve të vet

Arta Jusaj është studente e UBT-së, e cila aktualisht po i ndjek studimet në nivelin bachelor, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, në drejtimin Rjeta dhe Telekom.

Deri më tani, ajo ka treguar rezultate të shkëlqyera, ndërkohë që aftësitë dhe shkathtësitë e saj janë treguar në vijimësi gjatë aktivitetit studimor dhe shkencor, falë të cilave Jusaj ka filluar internship-in në departamentin për përgatitjen, administrimin dhe menaxhimin e projekteve.

Në këtë kontekst, duke folur për mundësinë e dhënë nga UBT-ja, ajo tha se falë mundësive dhe njohurive studimore, kërkimore dhe shkencore, që i ka marrë nga UBT, ka arritur të jetë një studente e shkëlqyer.

“Objektivi im primar është që me njohuritë dhe eksperiencën e fituar në UBT, të arrij sukses në profesionin tim, jo vetëm brenda Republikës së Kosovës, por edhe me gjerë”, theksoi ajo, teksa i këshilloi edhe studentët tjerë që të bëhen pjesë e UBT-së, nëse duan të krijojnë karrierë të suksesshme.

Në këtë pozicion, studentja Jusaj është duke treguar një performancë të jashtëzakonshme, e cila flet për një shkallë të lartë të mundësisë së studentëve të UBT-së për të kryer praktikë dhe më vonë edhe t’u punësuar.



## Studenti i SHKI-së, i punësuar në kompaninë “Kutia Digital Agency”



Studenti i vitit të dytë, në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, Astrit Zeqiri, ende pa i përfunduar studimet është punësuar në kompaninë “Kutia Digital Agency”, si zhvillues i ueb-it.

Me këtë rast, Zeqiri ka tha se për suksesin e arritur, i është falënderues UBT-së, që sipas tij, ka ofruar përgatitje profesionale.

“Falë lëndëve të mësuara e që janë të nevojshme për programin, unë dhe shumë studentë të SHKI-së, jemi sistemuar dhe jemi të gatshëm për tregun e punës”, vlerësoi ai.

Tutje, Zeqiri i këshilloi të gjithë të rinjtë që pretendojnë të arrijnë sukses në inxhinierinë softuerike, që ta zgjedhin UBT-në për t’i kryer studimet

## Studentet e UBT-së, fituese të konkursit “ASA Awards”

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT, Ramize Sinani dhe Natyra Misini janë fitueset e vendit të parë në edicionin e gjatë të konkursit “ASA Awards”, të mbajtur në Tiranë.

Tema me të cilën studentet u shpallën fituese ishte “Techno Youth”, përmes së cilës paraqitën një projekt për Qendrën kulturore për të rinj, teksa në këtë konkurs morën

pjesë krijues të rinj nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, në degët Art, Stilim dhe Arkitekturë.

Si pjesëmarrës nëpër konkurse e gara të ndryshme vendore e ndërkombëtare, studentët e UBT-së në vazhdimësi janë fitues, falë njohurive të marra, por edhe për shkak të gatishmërisë dhe dëshirës së tyre për të përmirësuar cilësinë dhe mënyrën e jetesës së njerëzve.



## Gresa Brestovci dhe Herolinda Demolli diplomuan në nivelin master, në Politika Publike dhe Menaxhim

Studentët e UBT-së, Gresa Brestovci dhe Herolinda Demolli diplomuan në nivelin master, në Politika Publike dhe Menaxhim, që njëherësh janë edhe studentët e parë që diplomojnë në nivelin master, në Fakultetin për Politika Publike dhe Menaxhim.

Titullin master, Brestovci e ka mbrojtur me temën: “Analizë e Politikave dhe Vendimmarrjes në sektorin shëndetësor”, ndërsa Demolli ka trajtuar temën “Asociacioni si formë e bashkëpunimit ndërkombëtar: Një qasje analitike e çështjes së Kosovës”.

Temat janë mbrojtur para komisionit, të përbërë nga

Ruzhdi Matoshi – kryetar, Ylber Limani – mentor dhe Bekim Baliqi – anëtar.

Të diplomuarit në këtë drejtim konsiderohet të marrin role dhe përgjegjësi në sferën e politikave publike dhe menaxhimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ata aftësohen duke marrë njohuri dhe përvoja të reja për të zhvilluar politika dhe shërbime, si dhe do jenë në gjendje për të menaxhuar ato si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Programi Politika Publike dhe Menaxhim ofron mundësi për të krijuar aftësi të cilat shumë lehtë do të transferohen



Liria e medias

# Instituti i Medias dhe UBT mbledhin shumë ekspertë për të diskutuar për sigurinë e gazetarëve në Kosovë

“Ndikimi i mediave është shumë i fuqishëm dhe këtë ndikim po e shtrijnë përmes rrjeteve sociale dhe mediave të tjera elektronike. Kështu me rritjen e lajmeve të rrejshme, po rriten mundësitë për të manipuluar publikun dhe kjo është një sfidë e rrezikshme”, tha ish-zëvendës kancelari i Austrisë, dr Erhard Busek

Liria e shtypit dhe e fjalës, është liri e njeriut, ndërsa në Kosovë, siç tregon edhe raporti më i ri i “Freedom House”, gazetarët dhe mediat nuk e gëzojnë këtë liri në masë të duhur dhe të kënaqshme.

Kështu u tha në konferencën me temë “Siguria e gazetarëve në Kosovë”, organizuar në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit, nga Instituti i Medias në Kosovë, në bashkëpunim me UBT-në.

Në këtë organizim i ftuar ishte ish-zëvendës kancelari i Austrisë, dr Erhard Busek, si dhe gazetarë, analistë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe udhëheqës të institucioneve arsimore, të cilët diskutuan për problemet e gazetarëve të cilët përballen çdo ditë në punën, sigurinë e tyre si dhe reflektimin e mediave në proceset shoqërore.

Kryetari i Institutit të Medias, Fazli Veliu ka theksuar se mediat në vend kanë probleme të dukshme dhe serioze që vijnë kryesisht nga ndërhyrja e politikës. Sipas tij, Kosova vazhdon të jetë mes vendeve me probleme serioze në lirinë e shtypit e të gazetarëve.

“Në Kosovë, në 20 vjetet e fundit, janë vrarë 11 gazetarë të etnive të ndryshme dhe asnjë autor i tyre nuk është zbuluar. Kjo në fakt është shqetësuese nga ana e sundimit të ligjit. Në anën tjetër, gazetarët nuk po guxojnë të bëjnë hulumtime shkaku i presioneve. Ata nuk ndjehen të sigurt as në mediumin ku punojnë as në rrugë as në shtëpi”, ka thënë Veliu. Ish-zëvendës kancelari i Austrisë, dr Erhard Busek ka theksuar se liria e shprehjes, medias dhe informacionit janë të drejta që janë të rrënjësura në mënyrë të prerë në kornizën ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Andaj sipas tij, mediat duhet të ngrisin zërin për ndryshime.

“Ndikimi i mediave është shumë i fuqishëm dhe këtë ndikim po e shtrijnë përmes rrjeteve sociale dhe mediave të tjera elektronike. Kështu me rritjen e lajmeve të rrejshme, po rriten mundësitë për të manipuluar publikun dhe kjo është një



sfidë e rrezikshme”, tha Busek.

Duke folur për lajmet jo të vërteta që publikojnë mediat në Kosovë, Agron Bajrami kryeredaktor në gazetën “Koha Ditore”, ka thënë se lajme të tilla janë të sponsorizuara.

“99 për qind janë lajme nga nevoja për përfitime, që po i dëmtojnë vetë mediat dhe ata që synojnë të merren me gazetari profesionale”, tha ai.

Ndërkohë rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi ka thënë se UBT është institucion i arsimit të lartë, i cili është i interesuar dhe po punon në lidhje me identifikimin e problemeve potenciale, si lirinë e mediave dhe besueshmërinë e tyre.

“UBT në bashkëpunim me Institutin e Medias po realizon projekte që kanë të bëjnë me gjendjen dhe lirinë e besueshmërinë e mediave, sepse konsideroj që gazetarët kanë rol kyç në procesin e pranimit dhe dhënies së informacionit”, ka bërë të ditur Hajrizi.

Kryetarja e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, deputetja Xhevahire Izmaqi, tha se

përveç problemeve të shumta që ballafaqohen gazetarët, një tjetër çështje shqetësuese është se ata nuk paguhet me rregull për punën e tyre.

Derisa Mentor Shala, drejtor gjeneral i Radio Televizionit të Kosovës, ka theksuar se kohëve të fundit janë shtuar edhe kërcënimet ndaj gazetarëve. Sipas tij, problemi qëndron tek prokuroria, sepse ajo këto raste duhet t’i trajtojë me urgjencë.

“Në këtë segment duhet të punohet shumë sepse ka filluar të ashpërsohet gjuha kërcënuese ndaj gazetarëve”, tha Shala. Për aspekte të ndryshme të gazetarisë në Kosovë dhe sigurisë së gazetarëve kontributin e tyre me diskutime e dhanë edhe gazetarë më përvojë të gjatë Halil Matoshi, Nexhmedin Spahiu e të tjerë.

Konferenca u përfundoi me një debat të gjerë lidhur me sigurinë e gazetarëve, profesionalizmin e medias dhe gazetarëve, në një kohë kur e gjithë media, në nivel global, po njej zhvillime të hovshme, të diktuar nga zhvillimet teknologjike.

Konferenca “A dream only- Or the only way ahead for Kosovo”

## Ekspertët: Në Kosovë nevojitet një bashkëpunim i domosdoshëm mes sektorit publik dhe privat



Në kampusin e UBT-së, në Prishtinë, të mërkurën u mbajt konferenca “A dream only- Or the only way ahead for Kosovo”, në të cilën ekspertë vendorë e ndërkombëtarë trajtuan aspekte të bashkëpunimit të ndërsjellë mes fushës së etikës, ekonomisë, politikës, arsimit, hulumtimit dhe shëndetit mes sektorit publik dhe privat, me ç’rast ata konstatuan se për t’u zhvilluar fushat e ndryshme në Kosovë dhe për t’u rritur efikasiteti i partneritetit me vendet tjera, patjetër duhet që sektori publik dhe ai privat të bashkëpunojnë, me qëllim të përmirësimit dhe të zhvillimit të mëtutjeshëm të fushave të ndryshme dhe të rëndësishme për Kosovën.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se për të bërë rimodelimin e një zhvillimi të përgjithshëm dhe që në veçanti ndikon në rritje ekonomike dhe në ngrit-

jen e cilësisë së jetës, është e rëndësishme që qasja jonë të jetë sistemore.

“Është shumë e nevojshme që të kemi qasje sistemore dhe përpjekje të vazhdueshme për të ndërlidhur dhe bashkërenduar të gjitha elementet që ndikojnë në zhvillimin e fushës së arsimit, shëndetësisë, ekonomisë e hulumtimit, duke u bazuar në praktikën më të mirë të shfrytëzuar më parë nga të tjerët”, vlerësoi Hajrizi, teksa shtoi se në këtë aspekt, “ka rëndësi që të arrihet autonomia akademike dhe nevoja e përgjegjësisë për etikën dhe elementet tjera që lidhen me aspektin etik profesional.

Ish-zëvendës kancelari i Austrisë, Erhard Busek, duke treguar mbi përvojat e tij jetësore, tha se bota po kalon nëpër një tranzicion të madh në të gjitha fushat, por sipas tij, e rëndësishme është që të mësohemi me ndryshimet.

“Ne duhet të mësohemi me situatat të cilat janë krijuar aktualisht në botë dhe të zhvillohemi me ndihmën e tyre, por paraprakisht, gjithmonë duhet të shikohen mundësitë që na ofrohen nëpër të gjitha fushat”, potencoi ai. Busek theksoi se një rol të madh në realitetin e krijuar e luan edhe zhvillimi i hovshëm ekonomik, që po shkakton ndryshime të mëdha.

“Zhvillimi i teknologjisë, automatizmi dhe robotika po ndikojnë që shumë njerëz të mbesin pa punë, por në anën tjetër, nga po të njëjtat, po zhvillohen pajisje e makineri tjera dhe po krijojnë hapësirë për vende të reja pune”, tha Busek. Deputeti i Parlamentit të Kosovës, njëherësh edhe ligjërues në UBT, Ilir Deda konstatoi se Kosova duhet ta shtyjë përpara procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, kjo për

arsye se, sipas tij, ky proces është më i duhuri dhe më i nevojshmi për vendin tonë.

“Procesi i integritimit është rruga më e mirë nëpër të cilën duhet kaluar, sepse kjo do të na detyrojë të planifikojmë dhe ta zhvillojmë ekonominë, arsimin, shëndetësinë dhe të gjitha fushat tjera të zhvilluara në Kosovë”, theksoi Deda, me ç’rast theksoi se, “të orientohesh kah Bashkimi Evropian, do të thotë të jesh për shoqëri dhe popull të zhvilluar”.

Ekspertja e sistemit shëndetësor, Elizabeth Campestrini tregoi se sipas studimeve të fizibilitetit të sektorit shëndetësor në Kosovë, është vënë re një mungesë bashkëpunimi mes sektorit publik dhe atij privat shëndetësor.

“Përderisa në vendet e zhvilluara ka një bashkëpunim të madh drejt përmirësimit të nivelit të shëndetësisë, në Kosovë ka një lloj gare për mbizotërim”, vlerësoi Campestrini.

Sipas saj, bashkëpunimi ka shumë rëndësi jo vetëm në Kosovë, por edhe në mbarë botën, kjo sepse krijohet një mundësi për ofrimin e ndihmës dhe për plotësimin e njëra-tjetrës.

“Nuk mund të injorohen sistemet që janë krijuar, por duhet të bashkëpunojnë për të arritur standarde evropiane, duke marrë shembuj nga praktikat te mira dhe duke krijuar strategji të përbashkëta veprimi”, potencoi ajo.

Zëvendësministrja e Integritimit Evropian, Anila Statovci vlerësoi se zhvillimi dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit, është esencial për zhvillimin e tërësishëm të Kosovës.

“Ne duhet të fokusohemi në arsim sepse pa e krijuar fundamentin dhe pa e pasë secili perceptimin se Kosova është e para, rruga për t’u zhvilluar tutje do të mbetet vetëm një ëndërr”, theksoi Statovci, nën arsyetimin se, së pari duhet ta zhvillojmë dhe ta forcojmë Kosovën dhe më pas, të zhvillojmë partneritet me të tjerët”, përfundoi ajo.

Në UBT u mbajt pjesa e parë e punëtorisë “E ardhmja e kufijve

# Si do të dukej e ardhmja e një bote pa kufij

“Ndikimi i mediave është shumë i fuqishëm dhe këtë ndikim po e shtrijnë përmes rrjeteve sociale dhe mediave të tjera elektronike. Kështu me rritjen e lajmeve të rrejshme, po rriten mundësitë për të manipuluar publikun dhe kjo është një sfidë e rrezikshme”, tha ish-zëvendës kancelari i Austrisë, dr Erhard Busek



Në UBT u mbajt pjesa e parë e punëtorisë dyditore “E ardhmja e kufijve”, qëllimi së cilës ishte që të përcaktohej se si do të dukej e ardhmja e një bote pa kufij për refugjatë, pa punëtorë emigrantë, pa korporata transnacionale, pa katastrofa mjedisore, pa identitete nacionale dhe etnike, për promovimin e artit bashkëkohor.

Gjatë kësaj punëtorie u bë prezantimi i projektit dhe i stuhive të mendimeve të pjesëmarrësve, duke i trajtuar dy pika kryesore, pjesëmarrjen dhe angazhimin e stafit të UBT në aktivitete të përbashkëta para dhe gjatë bienales, si dhe

aranzhimi i studentëve potencialë për punëtori sipas departamenteve potenciale.

Duke folur për krijimin e partneriteteve, njëri nga themeluesit e projektit “Autostrada Bienale”, Leutrim Fishekqiu theksoi se në aspektin e edukimit, ata kanë një bashkëpunim shumë të mirë me UBT-në.

“Përmes këtij projekti mendojmë që studentët mund të përfitojnë shumë, duke e zhvilluar profesionin e tyre, andaj kemi nevojë për përfshirjen dhe organizimin e stafit dhe të studentëve të UBT-së”, tha Fishekqiu.

Kuratori dhe kritiku i pavarur i bienales, Manray Hsu nga Taiwan, potencoi se përmes bashkëpunimit me UBT-në, bienalja do të ketë qasje dhe angazhim më të madh për krijimin e identitetit të saj, duke e shndërruar qytetin në muze. “Për realizimin në mënyrë sa më të mirë të kësaj ideje, neve na duhet një staf teknik e cilësor”, vlerësoi Hsu.

Ndërkaq, studentët pjesëmarrës, përpos që do t’ju jepet mundësia për të përfituar më shumë informacione dhe njohuri, ata po ashtu do të kenë mundësi edhe të ushtrojnë profesionin e tyre në praktikë, teksa do t’ju krijohet mundësia që të punojnë me pagesë, me ekipe profesionale të fushave të caktuara, ku do të ballafaqohen me probleme që do të shfaqen edhe në të ardhmen e tyre si profesionistë të ardhshëm të fushës përkatëse.

Autostrada Bienale planifikon ta bëjë qytetin dhe qytetarin pjesë tejet të rëndësishme të organizimeve të saj, duke i përfshirë ata pavarësisht përkatësisë nacionale, fetare dhe kulturore. Kjo do të jetë një nismë për shfrytëzimin e hapësirave dhe objekteve të vjetra, që kanë vlera të trashëgimisë kulturore, por edhe të kujtesës kolektive, duke i shfrytëzuar për organizimin e aktiviteteve në kuadër të artit bashkëkohor.

Për më tepër, në këtë projekt do të angazhohen artistë vendorë dhe ndërkombëtarë, për të promovuar artin e tyre dhe trashëgiminë e pasur kulturore të Kosovës.

Ligjëratë në UBT

## Zëvendësministrja Anila Statovci-Demaj flet për raportin Kosovës-BE

Raporti midis Bashkimit Evropian dhe Kosovës ishte tema e ligjëratës së zëvendësministres së Ministrisë për Integritet Evropian, në Kosovë, Anila Statovci-Demaj, në UBT.

Ligjëratë, e mbajtur në shënim të Ditës së Evropës, i është dedikuar procesit të integritetit evropian, në fokus për proceset e zhvilluara për integritetin e Kosovës në BE.

Zv.ministrja Statovci me theks të veçantë ka folur për demarkacionin me Malin e Zi, duke thënë se rinegociimi i marrëveshjes me BE-në është proces i pamundur. Në këtë drejtim ajo ka thënë se Kosova duhet të ketë kujdes në negociim të marrëveshjeve.

Sipas saj, në bazë të vlerësimeve dhe dëshmive aktuale, demarkacioni është vijë kufitare e konfirmuar. Ajo tha se përkufizimi i kufirit ka qenë një kriter për Malin e Zi, sepse në këtë mënyrë do të pranohet në NATO, por njëkohësisht është kriter edhe për Kosovën.

Statovci-Demaj theksoi edhe faktin se Kosova duhet të ketë përgjegjësi në rastin kur lidh marrëveshje ndërkombëtare.

Ajo tha se Kosova duhet të ketë vëmendje të madhe në momentet kur negociohen marrëveshjet në BE, sepse kjo varet shumë se sa tregohemi seriozë në rrugën evropiane.

Ajo shtoi se BE investon shumë për këto negociata dhe është shumë e vështirë të rinegociohen këto marrëveshje.

Ndërkohë Statovci ka përmendur të arriturat kryesore gjatë procesit të Kosovës drejt integritetit në BE. Ajo ka thënë se është dëshmuar që Bashkimi Evropian është i interesuar që ta çojë vendin tonë përpara.

Ndërkohë, sipas saj, agjenda evropiane është një ndër agjendat më të rëndësishme që ka Kosova dhe se procesi i integritetit të saj në BE ka pasur një dinamikë të zhvillimit.

“BE-ja është e interesuar që vendet e Ballkanit Perëndimor t’i mbajë nën ombrellën e vet. Mendoj që këtë e ka, si dhe do ta ketë prioritet parësor”, ka thënë ajo.

Ligjëratë e zëvendësministres Anila Statovci-Demaj është organizuar në kuadër të aktivitetit “Java e Evropës në UBT”, që po mbahet për nder të Ditës së Evropës, që shënohet më 9 maj.



Konferenca “A dream only- Or the only way ahead for Kosovo”

## Ekspertët: Në Kosovë nevojitet një bashkëpunim i domosdoshëm mes sektorit publik dhe privat



Kosova ka mungesë të noterëve

Themelimi i noterisë në Kosovë, u ka ndihmuar qytetarëve të Kosovës për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me çështjet ligjore, ndërkaq në të njëjtën kohë është lehtësuar puna e gjykatave në vend.

Këto komente i ka bërë kryetarja e Odës së Noterëve të Kosovës, Arbena Shehu gjatë një ligjërate tematike në UBT, e cila i ka njoftuar studentët për aktivitetin e noterëve dhe rolin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Ajo ka theksuar se komunat në Kosovë po ballafaqohen me mungesë të noterëve. Sipas saj, në disa qytete nuk ka fare noter, teksa me këtë rast, e përmendi specifikisht komunën e Skenderajt.

“Numri i noterëve duhet të rritet sepse kemi ende komuna pa mbulim të noterëve, por ka edhe komuna që kanë numër të vogël të noterëve. Ka komunë deri në 100 mijë banorë dhe ka vetëm një noter”, ka thënë Shehu, teksa shtoi se, “Oda e Noterisë së Kosovës përbëhet nga 74 noterë, të cilët shërbejnë në tërë territorin e Kosovës”.

Shehu tha se noteria në Kosovë i përmbushë të gjitha standardet evropiane, ndërkaq bëri të ditur që, Oda e Noterëve të Kosovës është e anëtarësuar në Unionin Ndërkombëtar të Noterisë.

“Oda është e pavarur në veprimtarinë e saj. Të gjithë noterët janë detyrimisht anëtarë të Odës së Noterëve të Kosovës, që nga dita e caktimit në pozitën e noterit”, tregoi Shehu, për të shtuar se, “noteria në vend është vlerësuar si më e mira në Ballkan, vetëm një vit pas anëtarësimit në Unionin Ndërkombëtar të Noterisë”.

Ajo ka bërë të ditur se financimi i Odës bëhet nga kontributi i noterëve. Sipas saj, çdo noter është i obliguar që të paguaj 2% të të ardhurave mujore për Odën e Noterëve.

Në kuadër të forumeve të debateve të shkencave shoqërore, UBT vazhdimisht po organizon ligjëratë me tema të ndryshme dhe në interes të studentëve, ku ftohen zyrtarë dhe ekspertë të fushave përkatëse.

Sfidat e të ardhmes së Kosovës

# Veseli e Haradinaj bashkëbisedojnë me studentët e UBT-së



Kryetari i PDK-së, Kadri Veseli dhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë mbajtur një bashkëbisedim me studentët dhe stafin e UBT-së, me ç'rast kanë diskutuar për sfidat e të ardhmes së Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke e vendosur theksin tek të rinjtë.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se vendimmarrjet dhe strategjitë politike, na ndihmojnë në procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi: "Të rinjve u intereson qasja dhe vizioni, përmes të cilit do të krijohet një e ardhme më e mirë për ta dhe për gjeneratat tjera pas tyre", vlerësoi Hajrizi.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli theksoi se fokusi i politikës kosovare duhet të jetë tek rinia

e Kosovës, në mënyrë që, sipas tij, ata të mos ndihen më inferiorë sesa moshatarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera të botës.

"Të rinjtë e vendit tonë nuk duhet të ndjehen të përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes, por të jenë bashkëvendosës për vendin e tyre dhe të mos ndjehen të anashkaluar kur ballafaqohen me bashkëmoshatarët e tyre", potencoi Veseli, teksa konkludoi se në një proces të tillë, rol të madh luan edhe fuqizimi dhe përmirësimi i pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

"Një shoqëri nuk mund të ec përpara nëse nuk e shton dhe nuk e njeht rolin dhe ndikimin e gjysmës së popullatës kosovare, grave".

Tutje, Veseli shtroi edhe nevojën për gjenerimin e vendeve

të reja të punës, me qëllim të ngritjes ekonomike dhe shtimit të përdorimit të produkteve vendore.

"Në mënyrë që Kosova të fuqizohet ekonomikisht, të rinjtë nuk duhet vetëm të gjejnë vende pune, por duhet të bëjnë përpjekje për të krijuar vende të reja pune për të tjerët", tha ai, duke shtuar se UBT, duke i përgatitur studentët për tregun e punës, është në hapin e duhur në këtë aspekt.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj vlerësoi se hapi i parë drejt zhvillimit të një vendi, krahas menaxhimit të mirë dhe ndërmarrësisë, mbi të gjitha është ngritja e nivelit të sigurisë.

"Synimi i secilës qeverisje duhet të jetë në krijimin e një vlere të re, duke e shtuar nivelin e elementit të sigurisë, kjo sepse, askush nuk investon në një vend që ka probleme me sigurinë", konstatoi Haradinaj.

Duke folur për mënyrat e ngritjes së zhvillimit ekonomik, Haradinaj tha se qytetarët duhet t'i duan më tepër produktet vendore dhe në këtë mënyrë mund të zgjerohet edhe nevoja për shtimin e vendeve të reja të punës.

"Arsyeja se pse po kërkojmë që Beogradi të mos ndërhyjë në asnjë formë në Kosovë, nuk është vetëm për nacionalizëm, por duhet të jetë një shenjë që qytetarët kosovarë vendosin për veten dhe shtetin e tyre", theksoi ai, teksa bëri me dije që nuk ka ndryshuar qëndrimin sa i përket marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi.

Në fund të këtij bashkëbisedimi, profesorët dhe stafi i UBT-së, shtruan pyetje, të cilat kryesisht kishin të bënin me nevojën për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, përfshirë këtu edhe përcaktimin e fushave me prioritet për ekonominë kosovare, pastaj për sfidat në fushën e arsimit dhe barrierat që i hasin studentët kosovarë për të studiuar jashtë vendit, për përkrahjen e kosovarëve që jetojnë në territorin e Serbisë dhe përfshirja e çështjes së tyre në dialogun me Serbinë etj.

Zv.shëfi i EULEX-it mbajti ligjëratë në UBT

## Thran: Njerëzit aktivë dhe koha do të ndikojnë në normalizimin e raporteve

Normalizimi i raporteve mes Kosovës dhe Serbisë nuk mund të arrihet brenda natës, duhet kohë, përkushtim dhe njerëz aktivë, të cilët duan të jetojnë në paqe me njëri-tjetrin. Këtë e ka thënë zv.shëfi i EULEX-it, Berndt Thran, gjatë një ligjërate të mbajtur për studentët dhe stafin e UBT-së, e cila ndërlihej me sfidat nëpër të cilat po kalon Kosova, si dhe me kushtet që duhen plotësuar për të qenë pjesë e organizatave ndërkombëtare.

"Koha do ta sjellë paqen, por ju duhet të bëheni aktivë. Nuk duhet të prisni që dikush të merret me sjelljet tuaja, nuk do të jetë dikush tjetër që do të zgjidhë problemet tuaja", porositi Thran, teksa shtoi se, "palët dhe gjeneratat e reja duhet t'u japin fund problemeve".

Ai theksoi se integrimi evropian i Kosovës është një proces jetik, kjo për faktin se, sipas tij, nga integrimi varet jo vetëm zhvillimi politik, por edhe ai ekonomik i vendit.

"Pa zgjidhjen e problemeve mes Kosovës e Serbisë, Koso-

va nuk mund të përfitojë investime evropiane, të cilat hapin vende të reja pune për të rinjtë kosovarë, por pa procesin e normalizimit, është e pamundur të arrihen këto zgjidhje", vlerësoi Thran, teksa si shembull konkret të një problemi të tillë e mori konfliktin ndërshtetëror mes Gjermanisë dhe Francës, në periudhën gjatë dhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

"Sfidat drejt normalizimit të marrëdhënieve mes Francës dhe Gjermanisë ishin të mëdha, vështirë se dy shtete armike dikur, tash të bëheshin vende mike, por pa njerëzit gjermanë dhe francezë, paqja dhe pajtimi nuk do të ndodhte kurrë.

Në fund të kësaj ligjërate, referuesit u përgjigjën në pyetjet e të pranishmëve, që kryesisht kishin të bënin me sfidat që vijnë nga mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, me rastet e papërfunduara të EULEX-it mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar, me vështirësitë të cilat i pati Gjermania në procesin e ribashkimit etj.



Konferenca "A dream only- Or the only way ahead for Kosovo"

## Akademiku Ilirjan Malollari ligjëron për studentët e UBT-së

Në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan, për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë dhe ata të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, mbajti ligjëratë tematike akademiku i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Ilirjan Malollari, me ç'rast trajtoi temën më titull: "Metodat e trajtimit të mbetjeve nga industria ushqimore dhe shfrytëzimi i biomasës organike për prodhimin e energjisë".

Në kuadër të kësaj ligjërate u trajtua çështja e transformimit të mbetjeve ushqimore për përfitimin e produkteve të dobishme dhe të energjisë, pastaj u diskutua për përbërjen e ujërave të shpëlarjes së ullinjve, për komponimet organike, për komponimet fenolike, për industrinë e përpunimeve të qumështit, për efektin në mjedisin ujor, metodat e trajtimit të mbetjeve të rrushit, trajtimi biologjik i shkarkimeve ujore

nga industria e ushqimore e mishit, trajtimin e ujërave të ndotura etj.

Me këtë rast, Malollari vlerësoi se duhet të bëhen më shumë përpjekje për të trajtuar çështjen e mbetjeve ushqimore, si dhe, sipas tij, të gjejnë zgjidhje për një problem të tillë.

"Duhet të jemi të fokusuar në mbetjet ushqimore dhe në pjesën e transformimit të tyre për efektin e eliminimit të ndotjes në mjedis, për përfitimin e produkteve të dobishme, por edhe për përfitimin e energjisë", tha Malollari, teksa shpjegoi që, "një komunikim i përbashkët mund të ndihmojë të gjithë kolegët dhe studentët që të hapin fusha të reja të interesit dhe të komunikimit për këto çështje".

Në fund të ligjëratës, studentët patën mundësinë të parashtrojnë pyetje rreth ligjëratës së trajtuar.

Në kuadër të vizitave të profesorëve ndërkombëtarë

## Profesori irlandez Darkwa ligjëroi për studentët e UBT-së

Profesori i Universitetit të Dublin-it, në Irlandë, Immanuel Darkwa ka mbajtur ligjëratë tematike për studentët e UBT-së, me ç'rast trajtoi çështjen e inovacionit, kuptimin dhe dimensionin e këtij termi.

Gjatë kësaj ligjërate, Darkwa tha se inovacioni ka shumë kuptime dhe definime, por, sipas tij, konkretisht përfshinë gjithçka që quhet e re dhe që pranohet e kërkohet nga tregu.

“Inovacioni është diçka e re, diçka e ndryshme, si dhe është ide praktike dhe implementim i suksesshëm i saj”, tregoi profesori Darkwa, teksa shpjegoi se inovacion nuk mund të

jetë vetëm një shpikje e re.

“Inovacioni është sukses dhe pranim i shpikjes së re sepse ka shumë shpikje të reja në botë, por që kurrë nuk e mbërrijnë tregun”.

Tutje, ai vlerësoi se inovacioni më shumë se gjithçka tjetër është veprim dhe komercializim i një ideje, duke u bërë kështu e pranueshme për njerëzit dhe tregun.

Në fund të ligjëratës, studentët patën mundësi të parashtronjë pyetje mbi shpikjet e fundit inovative në botë dhe me inovacionet e ndryshme që i përdorin kompanitë e mëdha botërore.



## Në UBT u mbajt ligjëratë tematike rreth buxhetit të Kosovës

Për studentët e vitit të tretë, të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, mbajti ligjëratë tematike analisti i institutit GAP (Instituti për Studime të Avancuara), Berat Thaqi, me ç'rast trajtoi temën me titull: “Pse është më rëndësi të kuptohet buxheti i Kosovës?”.

Në kuadër të kësaj ligjërate, u trajtua çështja se si mbushet buxheti i Kosovës, tatimet, të hyrat komunale, për mënyrat se si shpenzohet buxheti i Kosovës, procesi buxhetor, avokimi etj.

Me këtë rast, Thaqi tregoi se instituti GAP është platforma e vetme që e vizualizon buxhetin e Kosovës, teksa shtoi nevojën që secili qytetar të ketë njohuri të mirëfillta për buxhetin e vendit ku jeton dhe rëndësinë e tij.

“Ne jemi pronarë të buxhetit të Kosovës dhe nëse dikush tenton t'i vjedhë apo ta dëmton këtë buxhet, na dëmton

edhe neve personalisht. Buxheti aq sa është publik, është edhe personal”, theksoi ai.

Në fund të ligjëratës, studentët patën mundësi të parashtronjë pyetje rreth ligjëratës të trajtuar.

Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Këtë e bëjnë duke avokuar për një qeverisje më të mirë, duke monitoruar punën e institucioneve publike, dhe duke rekomanduar zgjidhje konkrete mbi politikat publike.

Kryetari i OAK në UBT

## Havolli: Avokatët në Kosovë duhet të profilizohen

Një numër i konsiderueshëm i avokatëve operojnë në Kosovë. Aktualisht, mbi 700 avokatë sa janë të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, edhe në bazë të ligjit përfaqësojnë klientët e tyre për çështjet ligjore, por, si të tillë ata aktualisht nuk janë të profilizuar për drejtimet përkatëse, ani pse organet kompetente një gjë të tillë e kanë rekomanduar kohë më parë.

Këto komente i ka bërë kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, Osman Havolli, në një ligjëratë para studentëve të UBT-së, ku ndër të tjera ka theksuar se roli i avokatëve ndryshon, varësisht nga fusha e specializimit të tyre.

“Jemi duke bërë përpjekje që të bëhet sa më shpejt profilizimi i avokatëve. Ka shumë fusha, pra nuk duhet të shikohet avokatia vetëm në sistem gjyqësor, ngaqë kjo është gabim, sepse për avokatët profesionalë do të ketë punë gjithnjë”, ka thënë Havolli.

Tutje, Havolli ka theksuar se pavarësisht sfidave, Oda e Avokatëve të Kosovës për qëllim kryesor ka avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë, duke mbështetur procesin e reformave ligjore.

Sipas tij, OAK do të bëjë përpjekje që të vendosë standarde të larta të profesionalizmit, besimit dhe sjelljes etike për avokatët në Kosovë.

“Një ndër organet që luan rol të rëndësishëm është komisioni disiplinor i Odës së Avokatëve. Në rast se shkelen ligjet nga këta të fundit, ndaj atyre do të shqiptohen masa disiplinore deri në marrje të licencës”, tha Havolli.

Po ashtu, ai tha se në bazë të ligjit në fuqi, avokatët janë të detyruar të arsimohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të pasurojnë njohuritë për ushtrimin e avokatisë në pajtim me aktet e përgjithshme të Odës.

Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK) është një organizatë vetëqeverisëse e avokatëve në Kosovë, e cila vepron si e pavarur nga organet shtetërore.

OAK është e përbërë nga organet dhe zyrtarët si: Kuvendi, i cili është i përbërë nga të gjithë avokatët e regjistruar dhe të licencuar; Kryetari, me një mandat dyvjeçar; Këshilli Drejtues, i cili përbëhet nga 11 anëtarë, që shërbejnë për mandat dyvjeçar; Këshilli Mbikëqyrës dhe Komiteti për Ankesa i Kuvendit të OAK-së.



## Artisti Stefano Romano prezanton punën e tij në UBT

Artisti nga Italia, Stefano Romano, gjatë një vizite të bërë në UBT, mbajti ligjëratë tematike për studentët dhe stafin e UBT-së, në të cilën e prezantoi punën e tij përmes disa instalacioneve artistike, të paraqitura përmes fotografive dhe videove.

Me këtë rast, Romano tha se në thelbin e tërë punës së tij janë njerëzit, prej të cilëve, sipas tij, rrjedhin edhe idetë.

“Punoj me media të ndryshme, por që puna ime zakonisht lidhet me ide politike, megjithatë nuk janë politike, por estetike”, vlerësoi ai, teksa shtoi se, “arti nuk provon të gjej përgjigje, por përmes tij, shtrohen pyetje ende më

të mëdha”.

Gjatë kësaj ligjërate, në të cilën ishte i pranishëm ishte edhe zv.ambasadori i Italisë në Kosovë, Matteo Corradini, përmes shembujve konkretë, Romano tregoi krijimet e tij të realizuara në shtete të ndryshme të botës, me ç'rast përmes tyre, ai mundohet t'i paraqesë të metat e politikës nëpër vendet përkatëse, duke e shprehur edhe kritikën dhe revoltën prej artisti.

Vlen të theksohet se artisti në fjalë do të marrë pjesë edhe në Autostradën Bienale, që do të mbahet në Prizren, prej datës 19 gusht, e deri më 23 shtator të këtij viti.





Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, e ka nderuar me çmimin “Excellence Leadership Award” diplomatin e njohur amerikan, William Pope

## Pope: Në Kosovë është bërë punë e shkëlqyeshme

“Vlerat e tij njerëzore dhe diplomatike e bëjnë diplomatin Pope një personalitet me dije dhe aktivitete të çmuara, si në SHBA, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, kurse sot ai erdhi në shtetin që po zhvillohet dhe po integrohet falë kontributit të vendit të tij, që është shtyllë ku shteti i Kosovës mbështetet në rrugëtimin e saj të gjatë drejt zhvillimit dhe integritit”, theksoi rektori Hajrizi në ceremoni. Ai tha se kontributi dhe puna e përshtur e Pope, e bënë atë anëtar të familjes sonë të madhe dhe mik të përhershëm të UBT-së

Në një ceremoni të veçantë, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, e ka nderuar me çmimin “Excellence Leadership Award” diplomatin e njohur amerikan, William Pope, për kontributin e tij të madh dhënë për çështjen e Kosovës në aspektin e sigurimit të njohjeve të reja dhe për anëtarësimin e vendit në organizata të mëdha ndërkombëtare.

Me rastin e nderimit të diplomatit Pope, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se UBT është institucion që di të vlerësojë vlerën e personaliteteve të mëdha, e që sipas tij, në radhën e figurave të tilla renditet edhe diplomati Pope, si kontribuues dhe njohës i mirë i rrethanave të Kosovës deri në ditët e sotme.

“Vlerat e tij njerëzore dhe diplomatike e bëjnë diplomatin Pope një personalitet me dije dhe aktivitete të çmuara, si në SHBA, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare, kurse sot ai erdhi në shtetin që po zhvillohet dhe po integrohet falë kontributit të vendit të tij, që është shtyllë ku shteti i Kosovës mbështetet në rrugëtimin e saj të gjatë drejt zhvillimit dhe integritit”, theksoi Hajrizi.

Ai tha se kontributi dhe puna e përshtur e Pope, e bënë atë anëtar të familjes sonë të madhe dhe mik të përhershëm të UBT-së.

Duke u zotuar se vendi i tij do të jetë përherë mbështetës besnik i Kosovës dhe qytetarëve të saj, fituesi i çmimit “Excellence Leadership Award”, William Pope tha se në tërë karrierën e tij diplomatike, nuk ka bërë asnjëherë asgjë më të drejtë, sesa kur mori vendimin për ta mbështetur rrugëtimin e Kosovës në procesin e shtetndërtimit dhe integritit.

“Ka shumë shtete të reja që po krijohen nëpër botë dhe ato që janë, nuk po tregohen shumë të suksesshme, por një përjashtim të madh në këtë aspekt e bën Kosova, sepse ajo çfarë kam parë është e mrekullueshme dhe e gjitha është puna juaj, kurse ne vetëm ju kemi mbështetur”, potencoi Pope, teksa u shpreh se ndihet i impresionuar dhe i nderuar me vlerësimin që iu bë atij, përmes dhurimit të këtij Çmimi. Në këtë ceremoni, i pranishëm ishte edhe ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, i cili tha se rruga e popullit kosovar drejt lirisë, pavarësisë dhe krijimit të një shoqërie demokratike ka qenë e vështirë, por vullneti i pathyeshëm



Diplomati amerikan Pope Në Kosovë është bërë punë e shkëlqyeshme

politik i qytetarëve të Kosovës, vetëdija e sakrificës, shpresa dhe mosdorëzimi dhe mbështetja e miqve ndërkombëtarë, veçanërisht e Amerikës, ka bërë që të gjitha proceset të jkalohej e realizohen me sukses.

“Mbështetja e shteteve karshi Kosovës është e madhe, por kjo mbështetje ka emra dhe mbiemra konkretë, të cilët kanë kontribuar në procesin e arritjes së njohjeve ndërkombëtare dhe integritimin e vendit tonë”, theksoi Hoxhaj, duke aluduar në ndihmën e ofruar nga diplomati William Pope, për institucionet e Kosovës.

Zv.ambasadori i Kosovës në New York, Ylber Kryeziu konstatoi se, ndonëse e ardhmja e Kosovës është në Evropë, SHBA duhet të ketë përgjegjësi të posaçme për fatin e Kosovës, të cilën do ta mbajë përmes njerëzve të saj.

“Është një listë e gjatë e heronjve të panjohur që punojnë për ta çuar përpara procesin e ruajtjes së paqes në botë, andaj ndonëse emri i diplomatit Pope nuk është shumë i njohur në opinionin publik, por emri i tij e ka simbolikën e angazhimit amerikan për zhvillimin dhe njohjen e Kosovës”, vlerësoi ai.

“Excellence Leadership Award” është Çmimi më i lartë që e dhuron UBT për personalitete të shquara vendore e ndërkombëtare, që kanë dhënë kontribut dhe kanë shënuar arritje në fusha të ndryshme.

UBT ka nderuar deri tash një varg personalitetesh, si humanisten austriake, Marianne Graf, zëvendëskancelari austriak dhe diplomati i shquar evropian, Erhard Busek dhe selektori i Kosovës në xhudo, Driton Kuka

## Juristi Sejdiu ligjëron për studentët e UBT-së



Në kampusin e UBT-së, në Prishtinë, për studentët e Fakultetit Juridik, Shkenca Politike dhe Media e Komunikim, mbajti ligjëratë tematike juristi Korab Sejdiu, gjatë së cilës trajtoi temën e reformave dhe qasjes së qytetarëve në drejtësi.

Me këtë rast, Sejdiu tha se sistemi i drejtësisë në Kosovë çalon në shumë aspekte dhe se kjo përbën pengesë të madhe

në tërheqjen e investitorëve të huaj.

“Kompanitë e mëdha nuk pranojnë të investojnë në një vend që ka probleme të mëdha me sistemin e drejtësisë sepse për të investuar, të gjitha kompanitë e mëdha kërkojnë siguri që problemet e tyre do të zgjidhen shpejt dhe në mënyrë efikase, andaj nuk mund të flitet për zhvillim ekonomik, pa e rregulluar më parë sistemin e drejtësisë”, theksoi ai.

Sejdiu vlerësoi se drejtësia në Kosovë nuk mund të rregullohet dhe të jetë funksionale pa reforma, por të cilat, sipas tij, nuk mund të bëhen pa një qasje dhe një plan gjithëpërfshirës, në realizimin e të cilit mund të ndikojnë të gjithë.

“Shumë njerëz duhet ta kryejnë punën në mënyrë të duhur, për të ardhur deri tek rezultati i duhur sepse mjafton që një komponent të dështojë dhe dështon i tërë procesi”, potencoi ai, teksa shprehu shqetësim për buxhetin e ulët që ndahet për sistemin e drejtësisë.

“Drejtësia është shtylla kryesore e funksionimit të një shteti, por edhe përkundër kësaj, vetëm 1 përqind e buxhetit të tërësishëm të shtetit ndahet për të, në anën tjetër, për të funksionuar sistemi i drejtësisë, ka nevojë për shtim të kapaciteteve humane dhe ekonomike”.

Tutje, ai shtoi se drejtësinë kosovare e kanë kapluar shumë probleme, duke përfshirë buxhetin tejet të ulët, numrin e madh i lëndëve të pazgjidhura, mungesën e personelit dhe teknologjisë, mungesën e kapacitetit profesional, përfaqësimin nga jojuristët, mungesën e guximit profesional etj., teksa shtoi se zgjidhjen adekuate e sheh tek dhënia e ideve që japin rezultate të shpejta.

“Zgjidhja e shpejtë dhe që jep rezultate gjendet tek krijimi i një mekanizmi mbikëqyrës për shkeljet eventuale, tek investimi në kapacitetet humane dhe ekonomike, tek vëzhgimi dhe auditimi i vazhdueshëm i pasurisë së gjyqtarëve, tek digjitalizimi dhe llogaridhënia mbi moskryerjen e punëve të caktuara dhe mbi të gjitha, tek vetëdijësimi i njerëzve për të drejtën e tyre, të cilën duhet ta kërkojnë me ngulm”.

Ligjëratë tematike në temën niveli i arsimit të lartë në Kosovë

## Drejtoresha e Departamentit të Arsimit të Lartë, Drita Kadriu Kadriu ligjëroi për studentët e UBT-së

Drejtoresha e Departamentit të Arsimit të Lartë, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Drita Kadriu mbajti një ligjëratë tematike për studentët dhe stafin akademik të UBT-së, në fokus të së cilës ishte niveli i arsimit të lartë në Kosovë, cilësia e përgatitja e studentëve për tregun e punës dhe roli i mësimdhënësve në ditët e sotme.

Duke folur për cilësinë dhe nevojën e ndryshimeve dhe reformave në arsim, Kadriu tha se në ditët e sotme kërkohet një qasje ndryshe e arsimit, pasi që, sipas saj, mësuesit nuk janë më qendra e mësimin për nxënësit, sepse ata i marrin mësimet dhe informacionet në forma tjera. “Në ditët e sotme, roli i mësuesit është t’i bëjë të vetëdijshëm për të mësuarit si proces, se të mësuarit është në interes të individit, në mënyrë që ata të kenë një orientim konceptual të procesit zhvillimor të arsimit dhe këtë e ka mundur zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë”, tha ajo.

Kadriu vlerësoi se është e rëndësishme që studentët, duke i njohur të gjitha nivelet e të menduarit kritik, të krijojnë shkathtësi për hulumtim dhe për marrjen e vendimeve demokratike, por, sipas saj, kërkohet mobilizim i stafit akademik që këtyre koncepteve t’i japin shije të reja. “Kosova nuk është më në fazën e tranzicionit dhe tani është koha që të hapet një debat social për cilësinë në arsim, duke dalë me rekomandime që i ndihmojnë procesit dhe që e ndërtojnë konceptualisht kahjen e sistemit të arsimit në Kosovë”, vlerësoi ajo.

Në fund të ligjëratës, të pranishmit parashtruan pyetje që kishin të bënin me profilizimin e gjeneratave të reja nëpër drejtime studimi, për lehtësimin e procesit të përfshirjes së studentëve në tregun e punës, pastaj për problemin e shkallës së ulët të të diplomuarve, përkundër numrit të madh të të pranuarve, për nevojën e profilizimit të universiteteve dhe kolegeve private në Kosovë etj.



## Besa Zogaj-Gashi e Ilir Deda flasin për sfidat e të rinjve të Kosovës



Zëvendësministrja e Zhvillimit Ekonomik, Besa Zogaj-Gashi dhe ish-deputeti i parvarur në Kuvendin e Kosovës, Ilir Deda, kanë mbajtur një bashkëbisedim me studentët dhe stafin e UBT-së, me ç’rast kanë diskutuar për të ardhmen e Kosovës dhe sfidat me të cilat po përballen qytetarët e saj.

Ata, me theks të veçantë kanë përmendur të rinjtë, ku vlerësuan se rinia e Kosovës duhet të ketë rol kryesor si në vendimmarrje, ashtu edhe në strategji politike.

Zëvendësministrja e Zhvillimit Ekonomik, Besa Zogaj-Gashi ka thënë se të rinjtë e Kosovës nuk duhet t’i shohin partitë politike si mundësi më të lehtë për punësim dhe avancim në karrierë, por sipas saj, ata duhet të luajnë një rol tejet të rëndësishëm në mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme politike.

Ndërkohë, ish-deputeti Deda tha se me potencialin që e kanë të rinjtë kosovarë, ata mund të sjellin në politikë një frymë të re në mënyrën se si duhet të zhvillohen proceset politike dhe se ata mund të jenë iniciatorë të shumë proceseve, që janë të domosdoshme për zhvillimin e vendit.

Gjatë bashkëbisedimit, profesorët dhe stafi i UBT-së patën mundësi të bëjnë pyetje për sfidat me të cilat po përballen qytetarët, përfshirë fushën e arsimit si dhe atë të shëndetësisë.

## Konsulenti për energji, Ibrahim Hajdari ligjëroi për studentët e UBT-së

Për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë, mbajti ligjëratë tematike konsulenti dhe drejtori për Energji në Ministrinë e Infrastrukturës, Ibrahim Hajdari.

Kjo ligjëratë në fokus kishte temën më titull: “Energjia e ripërtëritshme, rëndësia dhe standardet e Bashkimit Evropian”, ku në kuadër të saj u trajtua edhe rregullimi normativ i energjisë eficiente në Bashkimin Evropian, pastaj specifikat e energjisë eficiente në Belgjikë, energjia e ripërtëritshme – fokusi në panelet fotovoltaïque etj.

Gjatë këtij prezantimi, Hajdari ka folur për kuadrin ligjor, të cilin BE e ka vendosur në mënyrë që t’i orientojë shtetet anëtare se çfarë duhet të bëjnë që në programin “Horizon 2020”, të kemi shtete të gjelbra me energji të ripërtëritshme, teksa përmendi edhe nevojën që ka Kosova për të ndërmarrë hapa të tillë.

“Në Kosovë kemi nevojë për inxhinierë të cilët e kanë refleksin për të qenë inovativë, në kuptimin që të mendojnë dhe të krijojnë instalime të së ardhmes, të cilat shpenzojnë pak energji, por ofrojnë performancë të lartë”, tha ai.

Tutje, Hajdari potencoi se energjia dhe aspektet mjedisore nuk janë aspekte të izoluar që i përkasin vetëm një konteksti të zhvillimit të një shteti, dhe sipas tij, UBT po e bën një punë të mirë në këtë fushë.

“Në këtë fushë, UBT ka një qasje inovative, ku në vizion e ka rrugën e Bashkimit Evropian, ashtu siç kalon përmes kriterëve politike dhe ekonomike, në paralele janë edhe kriteret tjera mjedisore dhe të energjisë eficiente”, vlerësoi ai.



Energjia eficiente është një nga prioritetet e UBT-së në pesë vitet e fundit, në të cilën ka bërë investime në kuadër të një projekti rajonal, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Aktualisht, përveç nivelit bachelor, UBT është duke e përparuar edhe nivelin master, ku si institucion i arsimit të lartë, ka për qëllim t’i ofrojë shoqërisë mjete apo forma alternative të prodhimit të energjisë së ripërtëritshme.

Konkursi ndërkombëtar për arkitektë të rinj, "Young Architects Competitions"

## Arkitektët kosovarë finalistë në garën më të madhe ndërkombëtare për arkitekturë



Studentët e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, dega në Ferizaj, Qëndrim Begisholli, Besim Krosa dhe Leart Miftari, në bashkëpunim me profesorët e tyre, Arbër Sadiki dhe Arnisa Kryeziu, u për zgjodhën në mesin e 30 finalistëve

në konkursin ndërkombëtar për arkitektë të rinj, "Young Architects Competitions".

Rezultatet e këtij konkursi janë sinjal i mirë për të gjithë studentët që, plasimi në sferën ndërkombëtare të arkitekturës është i mundshëm dhe vjen përmes konkurseve të denja dhe të pastra arkitektonike, me ç'rast kjo mundësi më së lehti arrihet përmes studimit në UBT.

Kriteret dhe kërkesat e këtij edicioni kanë qenë dizajnimi i një kompleksi të shtëpive të observimit të qiellit nokturnal, pranë kalasë shumëshekullore të qytetit Roccascalegna, në Itali, teksa sfida e grupit punues ishte ruajtja dhe promovimi i vlerave ekzistuese të arkitekturës së kalasë dhe natyrës rrethuese, si dhe sigurimi i funksioneve të reja duke krijuar një simbiozë në mes të resë dhe të vjetrës.

Anëtarë të jurisë profesionale në këtë garë ishin arkitektë shumë prezentë dhe aktivë në skenën ndërkombëtare të arkitekturës, përfshirë Enrique Sobejano nga Nieto Sobejano Arquitectos, në Madrid, Rodrigo Duque Motta nga Santiago, Nicodemos K. Tsolakis nga Tsolakis Architects, në Nikozi, pastaj Felix Perasso nga Snohetta, në Innsbruck, Simon Frommenwiler nga Hhf Architects, në Bazel, Pippo Ciorra nga Fondazione Maxxi, në Romë, Francesco Cotellera nga Oappc, në Chieti, si dhe përfaqësues e zyrtarë të institucioneve kulturore dhe lokale të Italisë.

Young Architects Competitions (YAC) është një platformë ndërkombëtare, e cila nxitë konkurset e arkitekturës me qëllim të promovimit të talentit dhe kreativitetit të dizajnesve dhe arkitektëve të rinj, në revistat dhe platformat digjitale më të denja të arkitekturës.

Gjithashtu, qëllimi i YAC është të nxisë hulumtime rreth dizajnit duke provokuar reflektime rreth vendeve fizike për aktivitete njerëzore, të cilat çdo ditë po bëhen gjithnjë e më të paparashikueshme dhe dinamike.

## Fakulteti i Arkitekturës në UBT, qendra më e madhe për arkitekturë në Kosovë e rajon

Arkitektura është një profesion në lulëzim e sipër në vendin tonë dhe nevojat e shoqërisë janë shumë të mëdha, kjo jo vetëm për shkak të zhvillimeve aktuale, por edhe për shkak të nevojave të së ardhmes për një nivel të standardit sa më kualitativ jetësor në raport me kushtet urbane-arkitektonike, bazuar në proceset integruese dhe standardet ndërkombëtare.

Mbi këtë bazë, UBT ka themeluar Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, si një lider i fuqishëm për kryerjen e studimeve të arkitekturës, ndërtimtarisë dhe planifikimit hapësinor, përmes kreativitetit dhe vizioneve, me theks te veçantë në aplikimin e standardeve më të larta në projektim, planifikim dhe menaxhim të projekteve, duke siguruar mirëqenie ekonomike, sociale dhe kulturore.

Si qendra më e madhe e arkitekturës në Kosovë dhe rajon, ky program ka për qëllim të ofrojë njohuri dhe të përgatisë ekspertë në fushën e arkitekturës, për identifikimin dhe analizën e problemeve arkitektonike, hartimin dhe zhvillimin e

projekteve në arkitekturë dhe përmirësimin e aspekteve estetike, duke i lidhur të gjitha këto me parametra të tjerë të rëndësishëm si vlera shoqërore, estetike dhe ekologjike.

Studentët që e përfundojnë këtë fakultet do të jenë në gjendje të aplikojnë njohuri të avancuara, bazuar në aspektet njerëzore, teknike sociale, si dhe do të jenë kompetentë për të zgjidhur problemet e natyrës inxhinierike, arkitektonike, urbanistike dhe ndërtimore.

Shkathtësitë e tyre të zgjeruara të komunikimit, zgjidhjes së problemeve dhe analizave, do t'i përgatisin ata për të zbatuar një projekt më kompleks dhe do t'ju hapë rrugë për kërkime akademike.

Programi i studimit, ndër tjerash, ka për qëllim që të krijojë një logjikë të të mësuarit gjatë gjithë jetës, teksa përfshin edhe kurse që u ndihmojnë studentëve të ndërtojnë kompetenca personale dhe produktive, të cilat mund t'ju ndihmojnë atyre të transferojnë dhe të kontekstualizojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme të punës dhe në mjedis.



Stafi akademik i këtij fakulteti përbëhet nga ekspertë vendorë e ndërkombëtare, me kualifikime shumë të larta akademike-shkencore dhe që kanë përvojë të madhe, të cilën kanë reputacion të vlerësuar në fushën e mësimdhënies dhe të hulumtimit.

## Fakulteti i Mekatronikës në UBT, vatra e inovacioneve inxhinierike në Kosovë dhe rajon



Inxhinieritë klasike, siç janë: inxhinieria elektrike, elektronike, mekanike etj., çdo ditë e më tepër po pësojnë rënie për arsye të kërkesave më komplekse të tregut të punës, andaj drejtimi i Mekatronikës është shumë i qëlluar për ata të cilët kërkojnë të jenë zhvillues të produkteve industriale dhe jo vetëm.

Nisur nga ky fakt, UBT ka themeluar Fakultetin Mekatronikë dhe Menaxhment, në nivelin bachelor e master, përmes të cilit ofron gërshetimin e shumë disiplinave të inxhinierisë klasike, përfshirë inxhinierinë elektrike, atë elektronike, mekanike dhe sistemet e kontrollit dhe njëherësh, mundëson

edhe trajnimin e brezave të ardhshëm të inxhinierëve, duke u dhënë atyre aftësi gjithëpërfshirëse në sistemet përkatëse dhe në menaxhimin e tyre dhe më e rëndësishmja, duke i bërë ata ekspertë dhe liderë të kësaj fushe në Kosovë.

Kërkesa e vazhdueshme e tregut për ngritje të prodhueshmërisë dhe ofrimin të produkteve me kualitet të njëjtë brenda një kohe më të shkurtër, po e orienton industrinë më shumë drejt automatizimeve të bazuara në sisteme kompjuterike, duke e bërë kështu fushën e mekatronikës faktorin më ndikues në këtë aspekt, Megjithatë edhe përkundër kësaj, mekatronika është shumë pak e zhvilluar dhe e aplikuar në vendin tonë. Andaj, Mekatronika e UBT-së po sjellë një ndryshim të modelit industrial tek inxhinieria e re konkurruese në kornizat e të menduarit në proces të dizajnit të makinave dhe po synon që me qasjen e vet të integruar multidisciplinare në dizajnin e produkteve, të bëhet teknologjia kryesore në zhvillimin e një fuqie garuese në kohën moderne të prodhimit.

Krahas kësaj, Fakultetin e Mekatronikës dhe Menaxhmentit e bën akoma më të kompletuar profesionalizmi dhe përgatitja akademike e ligjëruesve vendorë e ndërkombëtarë, të cilët sjellin për studentët praktikën më të mira dhe më të reja ndërkombëtare në këtë fushë, teksa studentët aktualë dhe ata të diplomuar, përmes njohurive të fituara, po gjenerojnë vende të reja pune dhe po e ngritin zhvillimin e kësaj fushe

në një tjetër nivel, duke sjellë e realizuar projekte deri më tash të papara në vendin tonë dhe më gjerë.

Ky fakultet ka krijuar specializimet që i përshtaten kryekëput nevojave të tregut të punës, duke e bërë këtë drejtim të vështirë të krahasueshëm me ndonjë tjetër.

### Për nivelin bachelor, Fakulteti Mekatronikë dhe Menaxhment ofron specializimet:

- Menaxhim i Mekatronikës
- Automatizim Industrial dhe Proces i Kontrollit
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Sistemet Inteligjente dhe Robotikë
- Inxhinieri Biomjekësore
- Inxhinieri Elektrike/Elektronike
- Inxhinieri e Telekomunikacionit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieri Aeronautike

### Ndërsa, për nivelin master ofrohen specializimet në fjalë:

- Menaxhim i Mekatronikë,
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Proces i Prodhimit Inxhinierik dhe Teknologji.

Vizitat studimore – një mundësi shtesë për studentët

## Studentët e gazetarisë vizituan televizionin Top Channel

Studentët e vitit të parë dhe vitit të tretë të drejtimit Media dhe Komunikim, vizituan televizionin Top Channel, në Tiranë, me ç'rast u pritën nga gazetar i showbiz-it "Top Show", Roland Spahiu.

Gjatë kësaj vizite, ata u njoftuan me organizimin e mediumit, funksionimin, skenat e emisioneve, si dhe me ambientet tjera të punës.

Ndërkaq, studentët gjatë vizitës patën rastin të jenë edhe shikues të drejtpërdrejtë të emisionit "Portokalli".

Duke folur për rëndësinë e vizitave studimore nëpër medime, Spahiu tha që e përgëzon nismën e UBT-së për të sjellë studentët

e Medias dhe Komunikimit më afër ambienteve të një medie, për t'u familiarizuar me infrastrukturën e medias dhe për të parë përtej asaj që shihet në ekran nëpërmjet programeve televizive.

"Është e domosdoshme të krijohet marrëdhënia studentë-media, por edhe si profesionistë të ardhshëm të medias, sidomos kur ata janë të pasionuar, kureshtar e dhe të vëmendshëm", theksoi ai.

Në kuadër të vizitave studentore, UBT po vazhdon të organizojë vizita nëpër institucione të ndryshme, me qëllim të vetëdijesimit të studentëve me mënyrën e punës, por edhe me rëndësinë e profesionit të tyre.



## Studentët e Juridikut në UBT vizituan Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë



Studentët e vitit të parë në Fakultetin Dizajn i Integruar në UBT, kanë vizituar ndërmarrjen prodhuese të veshmbathjeve në Kosovë, "S//Sprint", që konsiderohet si prodhuesi më i specializuar i veshjeve sportive, njëkohësisht njihen për rroba cilësore në treg. Studentët janë pritur nga përfaqësuesja e kompanisë, Xufe Sopa, e cila ka bërë të ditur se ndërmarrja punon me standarde evropiane, si dhe ofron produkte të modës së fundit. Ajo ka theksuar se kompania sjell risi të ndryshme në veshmbathje gjatë tërë vitit

dhe jo vetëm në sezone.

Studentët janë njohur rreth procesit të prodhimit në tërësi, duke filluar nga modeli, prerja, qepja, hekurosja, kontrolli i cilësisë e paketimi i tyre. Po ashtu, ata kanë parë edhe teknologjinë e makineritë që përdoren, veçanërisht për qëndisje dhe stampim.

Në kuadër të vizitave studimore studentët do të vizitohen edhe prodhues të tjerë tekstilësh e ndërmarrje të tjera.

## Studentët e gazetarisë vizituan portalin lajmi.net

Studentët e vitit të parë të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, vizituan portalin lajmi.net, me ç'rast u pritën nga kryeredaktori, Besnik Batusha dhe nga redaktori, Elhami Ismajli.

Gjatë kësaj vizite studentët u njoftuan për funksionimin e portalit, me stafin, sfidat, si dhe pan+te nga afër ambientet e punës.

Duke bashkëbiseduar me studentët për sfidat e gazetarisë, kryeredaktori Batusha u ofroi atyre mundësi për praktikë, si dhe mundësi për punësim.

Në kuadër të vizitave studimore, në ditët në vijim, studentët do të vizitohen edhe medime televizive, portale dhe gazeta vendore.



## Studentët e MBE-së vizituan kompaninë Zero Pozitive Publicis

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, të specializimit Marketing dhe Shitje, vizituan kompaninë Zero Pozitive Publicis, e cila është një nga Agjencitë lidere të Marketingut dhe Komunikimit në Kosovë.

Gjatë kësaj vizite, ata u pritën nga drejtori gjeneral i kompanisë, Ardian Thaqi dhe nga menaxheri i medias së këtij institucioni, Artan Hyseni, të cilët i njoftuan studentët për historikun e kompanisë së tyre, shërbimet, produktet që ofrohen nga kjo kompani, si dhe për sfidat e kompanisë.

Ndërkaq, studentët përcollën me interes funksionimin e kësaj kompanie, ku u njoftuan me mënyrën e qasjes dhe komunikimit me klientët, krijimin e produkteve dhe brendit të një kompanie, krijimin e një media plani, strategjinë e segmentimit të tregut dhe klientëve etj.

Fakulteti i MBE-së është i përkushtuar që literaturën ta ndërlihdë me industrinë përmes vizitave në kompani të ndryshme, me qëllim të përgatitjes profesionale të studentëve për tregun e punës.



## Studentët e UBT-së vizituan universitetin turk "Kadir Has"

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar, të udhëhequr nga dekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr Muhamet Ahmeti dhe nga profesorët në UBT, prof. dr Ajhan Bajmaku dhe prof. Skender Kosumi, kanë realizuar vizitë studimore në Turqi, ku ndër tjerash, kanë vizituar universitetin turk "Kadir Has", ku u pritën nga përfaqësuesit e këtij universiteti, përkatësisht nga dekani i Arkitekturës, dr. Didem Kiliçkiran, udhëheqësi i departamentit të Dizajnit Industrial, dr. Ihan Erhan, nga profesorët, dr. Aslihan Demirtas dhe dr. Zuhul Ulusoy, të cilët i informuan studentët me zhvillimet në universitetin e tyre, si dhe shprehën gatishmërinë për të bashkëpunuar në të gjitha nivelet me UBT-në, duke përfshirë edhe shkëmbimin

e studentëve.

Tutje, ata u takuan edhe me koordinatoren e programit Erasmus+, prof. dr Ezgi Tuncer, e cila i informoi për mundësitë e bashkëpunimit, për krijimin e grupeve dhe organizimin e punësive në fushën e arkitekturës dhe të dizajnit, për organizimin dhe mbajtjen e konferencave të përbashkëta etj.

Studentët patën mundësi t'i vizitohen edhe klasat ku mbahet mësimi, ku morën pjesë në ushtrime dhe ligjërata, si dhe vizituan pjesë të ekspozitës së punimeve të studentëve, të organizuara nga universiteti Kadir Has.



## Studentët e UBT-së vizituan Panairin e materialeve ndërtimore në Turqi

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar, të udhëhequr nga dekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr Muhamet Ahmeti dhe nga profesorët në UBT, prof. dr Ajhan Bajmaku dhe prof. Skender Kosumi, kanë realizuar vizitë studimore në Turqi, me ç'rast ishin pjesëmarrës në Panairin e ndërkombëtar të materialeve ndërtimore, që po mbahet për herë të 40-të në këtë shtet.

Ky panair është njëri nga më të mëdhenjtë dhe më të rëndësishmit në rajon dhe Evropë, ku këtë vit morën pjesë mbi 200 shtete dhe më shumë se 2000 kompani të ndryshme, të cilat merren me prodhimin e materialeve të ndryshme ndërtimore.

Me këtë rast, studentët patën mundësi të shohin materiale të ndryshme inovative, të cilat janë duke u aplikuar nëpër projekte të ndryshme në botë.

Krahas kësaj, studentët bënë edhe një shëtitje me anije nëpër grykën e Bosforit, konkretisht tek ura e Bosforit, që e lidhë Evropën me Azinë.

Tutje, ata vizituan Qendrën Tregtare "Zollu", si njëra ndër qendrat më të mira për arkitekturë në Evropë, teksa panë edhe akuariumin e Stambollit, që është njëri nga më të mëdhenjtë në botë për nga madhësia dhe numri i llojeve të ndryshme të peshqve dhe botës bimore.



## Studentët e UBT-së vizituan universitetin turk "Mimar Sinan Fine Arts"

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar, të udhëhequr nga dekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr Muhamet Ahmeti dhe nga profesorët në UBT, prof. dr Ajhan Bajmaku dhe prof. Skender Kosumi, kanë realizuar vizitë studimore në Turqi, ku ndër tjerash, kanë vizituar universitetin e njohur turk "Mimar Sinan Fine Arts".

Gjatë kësaj vizite, ata u pritën nga rektori i këtij universiteti, prof. dr Yalçın Karayağiz, i cili i informoi lidhur me punën

dhe zhvillimet në këtë universitet, si dhe shprehu gatishmërinë që të thellohet bashkëpunimi në mes universitetit të cilin ai e drejton dhe UBT-së, me qëllim të shkëmbimit të studentëve, pastaj për realizimin e punëtorive dhe konferencave ndërkombëtare të përbashkëta.

Pos kësaj, studentët patën mundësi të përcjellin edhe procesin mësimor në disa lëndë, të cilat ishin duke u zhvilluar gjatë kohës së vizitës, si dhe vizituan laboratorë të ndryshëm, bibliotekën e universitetit, galerinë e arteve moderne etj.



## Studentët e UBT-së vizitojnë objekte të lashta ndërtimore në Turqi

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, të Arkitekturës dhe të Dizajnit të Integruar, të udhëhequr nga dekani i Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr Muhamet Ahmeti dhe nga profesorët në UBT, prof. dr Ajhan Bajmaku dhe prof. Skender Kosumi, kanë realizuar vizitë studimore në Turqi, me ç'rast kanë vizituar vende të ndryshme dhe objekte të rëndësishme, që i përkasin periudhës bizantine dhe asaj otomane, në Erdine dhe Stamboll. Gjatë kësaj vizite, studentët vizituan muzetë, objektet fetare dhe monumentet tjera të lashta e të rëndësishme historike të Turqisë, disa prej të cilave konsiderohen të jenë veprat e fundit ndërtimore me rëndësi, të periudhës së

lashtësisë së vonë.

Me këtë rast, ata vizituan muzeun e qytetit të Stambollit, "Aja Sofia", pastaj Pallatin "Top Kapi", që u shndërrua në muze në vitin 1924, duke u bërë kështu muzeu i parë i Republikës së Turqisë, Xhaminë e Kaltër, si dhe vizituan edhe Rezervuarin Bazilik, Xhaminë e Selimit në Erdine etj.

Kjo vizitë studimore u realizua me qëllim të njohjes së studentëve me ndërtimet arkitektonike të periudhës së hershme dhe me ndryshimet që kanë ndodhur ndërmjet formave së ndërtimeve në Turqi, nëpër periudha të ndryshme kohore.



## Studentët e UBT-së vizituan kampin ushtarak "Bondsteel"

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, të shoqëruar nga profesorët e këtij departamenti, prof. dr Muhamet Ahmeti, prof. dr Elvida Pallaska, prof. dr Visar Krelani, cand. dr Vlora Aliu dhe cand. dr Mimoza Sylejmani, vizituan kampin ushtarak amerikan në Kosovë "Bondsteel", me ç'rast panë infrastrukturën e këtij kampi ushtarak.

Kjo vizitë është kryer me qëllim që të shihet mënyra e furnizimit me ujë, si dhe mënyra e trajtimit të ujrave të zeza brenda këtij vendi, ku përfaqësuesit e kampit, të angazhuar për furnizim me ujë, kanë sqaruar detaje lidhur me procesin teknologjik të marrjes, përpunimit dhe jonizimit, duke sjellë në këtë kamp standardet e kërkuara nga ushtria amerikane, teksa ata dhanë shpjegime edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe për procesin e përcjelljes së ujit deri tek përdoruesit.

Tutje, është vizituar sistemi i trajtimit të ujrave të zeza

, ku nga përfaqësuesi dhe përgjegjësi i këtij sistemi, janë dhanë të gjitha sqarimet për mënyrën dhe fazat e trajtimit të ujrave të zeza, deri në largimin e tyre dhe derdhjen në kanalin afër këtij kampi, ku tani këto ujëra janë plotësisht të pastra dhe nuk kane as një ndikim negativ në rrethinë. Kjo vizitë pati një rëndësi të veçantë për të gjithë pjesëmarrësit pasi që, për së afërmi u informuan lidhur me sistemin e pavarur të furnizimit me ujë edhe energji, pastaj me trajtimin e ujrave të zeza, me infrastrukturën, logjistikën dhe me tërë sistemin e këtij kampi, e po ashtu u njoftuan edhe me aspektin shoqëror se si zhvillohet jeta në këtë kamp.

Vlen të theksohet se grupi i përbërë nga studentët dhe stafi akademik i UBT-së, është ndër grupet e para që i është lejuar vizita e lirë në këtë kamp ushtarak shumë të rëndësishëm për forcat e NATO-s

## Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit vizituan autostradën "Arbër Xhaferi"

Studentët e vitit të tretë, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, realizuan vizitë njëditore në autostradën "Arbër Xhaferi", përkatësisht në segmentin e Sojevës, punimet e së cilës është duke i përfunduar kompania ndërtimore "Bechtel Enka"

Vizita studimore kishte për qëllim që t'i njoftonte studentët me rolin, rëndësinë, veprimet dhe aktivitetet, të cilat zhvillohen gjatë ndërtimit të veprave inxhinierike, konkretisht në këtë rast, në autostradën "Arbër Xhaferi", si dhe t'i njihje nga afër me pjesën më të madhe të objekteve inxhinierike,

që janë në ndërtim e sipër në këtë autostradë.

Me këtë rast, studentët u pritën nga përfaqësuesit e departamentit për marrëdhënie me publikun dhe nga përfaqësuesja e kësaj kompanie, Arta Salihu, nën shoqërimin e të cilëve, studentët arritën të shohin pjesën kryesore të punimeve ndërtimore që janë duke u kryer në autostradë, përkatësisht në segmentin e Sojevës, e që shërbeu si një praktikë ideale e integritit të pjesës teorike të mësuar në UBT, me atë praktike.

Tutje, studentët i realizuan dy teste, me ç'rast i pari kishte

të bënte me matjen e koeficientit të ngjeshjes së shtresave të asfaltit përmes aparatit të TROXLER (metoda joshkatëruese), e cila sipas shpjegimit të dhënë aty, kishte një rezultat matje deri në 95% të saktë, kurse testi i dytë kishte të bënte me matjen e uljes së pilotës për forca goditëse, duke filluar nga 50 cm e tutje, e cila realizohej me pajisje konstruktive të konstruktuar mbi pilot, duke e vënë në funksion përmes vinçit ngritës, me masë goditëse 15 tonë.

Konsiderohet se studentët me përvojën e fituar, mund dhe janë të aftë të zgjidhin probleme inxhinierike për lloje të ndryshme të veprave inxhinierike.

## Studentët e Fakultetit të Mekatronikës vizituan fabrikën e medikamenteve "Trepfarm"

Studentët e Fakultetit të Menaxhimit të Mekatronikës në UBT, në kuadër të lëndës Automatizimi i Prodhimit, vizituan fabrikën e medikamenteve "Trepfarm", me ç'rast u pritën nga menaxhmenti i fabrikës.

Gjatë kësaj vizite, studentët u informuan rrjedhimisht lidhur me kapacitetin e prodhimit të fabrikës me teknologji e en-

ergji, ambientet e punës, stafin dhe funksionimin, elemente këto që ndërlidhen drejtpërdrejt me programin e Mekatronikës.

Tutje, ata u informuan edhe me kontrollin automatik të ajrit, gjegjësisht të temperaturës dhe të lagështisë, që janë specifika të veçanta në këtë industri.

Në fazën e fundit të vizitës, studentët patën rastin të shohin nga afër repartin e prodhimit dhe të deponimit, duke u informuar plotësisht me procesin e prodhimit, elementet e kontrollit, procesin dhe sistemin e kontrollit automatik, makinat automatike, laboratorin për testime, depon, hapësirat për paketim të produkteve etj.

## Përfaqësuesit e universitetit NOVA vizitojnë UBT-së, impresionohen me punën e studentëve

Përfaqësuesit e Universitetit NOVA de Lisboa, përkatësisht, kryesuesja e Zyrës së Sipërmarrjes në këtë institucion, Lara Ligeiro dhe zyrtari i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Joao Oliveira, kanë qëndruar për një vizitë në UBT, me ç'rast u takuan me studentët e UBT-së, që janë shpallur fitues të projekteve në punëtorinë "UPSHIFT", për të shkuar mundësinë e financimit të projekteve të tyre. Me këtë rast, studentët prezantuan para tyre idetë, qasjen

dhe mënyrat se si planifikojnë t'i kthejnë në prototipe dhe në produkte idetë e tyre., teksa pas dëgjimit, përfaqësuesit e universitetit portugez u shprehën të impresionuar me inovacionin e shprehur brenda ideve të studentëve, si dhe me mënyrën se si ata janë shumë pasionantë për punën e tyre dhe se nuk e kanë qëllimin tek përfitimimi, por tek ndihma që synojnë ta ofrojnë për komunitetin. Vlen të theksohet se, profesorët në fjalë, në mesin e të gjitha

vendeve tjera, e kanë përzgjedhur Kosovën dhe konkretisht UBT-në, për realizimin e mobilitetit të tyre, në kuadër të programit Erasmus+. Universiteti NOVA, është njëri nga shumë universitete ndërkombëtare, me të cilat UBT ka marrëveshje për shkëmbim të studentëve dhe për krijim dhe ofrim të mbështetjes në realizimin e projekteve të përbashkëta.

## Studentët e UBT-së vizituan Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale dhe Kuvendin e Maqedonisë

Studentët e nivelit master në programin Politika Publike, realizuan vizitë njëditore në qytetin e Shkupit, në Maqedoni, nën udhëheqjen e prof. dr Ylber Sela. Me rastin e kësaj vizite, studentët e UBT-së vizituan Agjencinë për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale, ku

u pritën nga drejtori i këtij institucioni, dr Zoran Trajčevski dhe nga prof. Milaim Fetaj, me ç'rast prej tyre u njoftuan me funksionimin dhe organizimin, me punën e përditshme praktike të Agjencisë dhe kompetencat e saj, si dhe me mënyrën e funksionimit të Këshillit të kësaj agjencie.

Tutje, studentët vizituan edhe Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, ku u pritën nga kryetari Talat Xhaferi, i cili gjatë një bashkëbisedimi, i njoftoi në mënyrën e punës, organizimit dhe funksionimit.

## Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit vizituan laboratorin "INKOS"

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, kanë vizituar laboratorin e gjeomekanikës "INKOS", në Obiliq. Me këtë rast, studentët u njoftuan me punën dhe aktivitetet që ndërmerren për trajtimin e dherave dhe përcaktimin e parametrave fiziko-kimikë në laboratorin "INKOS", të cilët

janë të rëndësishme së veçantë në fazën e planifikimit dhe realizimit të veprave të ndryshme inxhinierike. Gjatë kësaj vizite, ata u pritën nga udhëheqësi i laboratorit, Avdullah Krasniqi dhe nga tekniku i tij, Nebih Grajčevci, të cilët i prezantuan për studentët të gjitha sallat e përgatitjes dhe ekzaminimit të provave, me ç'rast përmes pamjeve fo-

tografike treguan punën në laboratorë, kampionet (mostrat) dhe procedurat e nxjerrjes së parametrave fizikë dhe mekanikë. Ku patën rastin të shohin nga afër edhe procedurat nga marrja e mostrave, e deri në nxjerrjen e rezultateve finale, sa i përket vetive fizike dhe mekanike të dherave. Falë kësaj vizite, konsiderohet se studentet me përvojën e fituar, do të jenë të aftë të zgjidhin probleme inxhinierike nga fusha e gjeomekanikës.

## Studentët e Arkitekturës vizituan punishte ndërtimi, analizuan procedurat e ndërtimit

Studentët e vitit të tretë në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, për herë të dytë kanë organizuar vizitë në terren, konkretisht në punishte ndërtimi, vizitë kjo e realizuar në kuadër të lëndës "Puna Praktike". Me këtë rast, ata kanë parë nga afër punët që janë duke u zhvilluar në ndërtimin e një objekti hotelier, teksa analizuan procedurat

e armimit të shtyllave, betonimit të shtyllave, trajeve, pllakës dhe shkallëve, pastaj analizuan edhe kallupimin e shtyllave, hidrozolimin e mureve të bodrumit, murimin, dilatimin total dhe atë parcial, tokëzimin mbrojtës, rrufepritësin etj. UBT, në vazhdimësi është e përkushtuar që për studentët të ofrojë pjesën teorike, të ndërlidhur me atë praktike

## Studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit vizituan QTSMF-në

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në UBT, kanë vizituar Qendrën për Trajnime për Siguri dhe Mbrojtje në Punë (QTSMF), me qëllim që të njihen me rolin, rëndësinë, veprimet dhe aktivitetet që i zhvillon ky institucion, duke vepruar në kuadër të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Gjatë kësaj vizite, studentët u pritën nga drejtori i QTSMF-së, Safet Ymeri, i cili i njoftoi me historikun e themelimit dhe zh-

villimin e QTSMF-së, teksa vazhdoi me një prezantim për sigurinë dhe mbrojtjen në punë, duke u fokusuar në sigurinë industriale dhe mbrojtja kundër zjarrit. Pas prezantimit, studentët patën rastin të vizitojnë disa nga sallat për trajnime në fusha specifike, me ç'rast arritën të krijojnë një vizion të qartë në lidhje me rolin dhe rëndësinë që ka QTSMF, për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve.

## Studentët e UBT-së kryejnë praktikën në ATK

Studentët e Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, të specializimit Banka, Financa dhe Kontabilitet, Aurora Mustafa, Rina Kadriu dhe Vehbi Hajrullahu, si dhe studentët e Shkencave Politike, të specializimit Administratë Publike, Ariana Orllati, Agon Dedushi, Fahrie Llugiqi dhe Blerina Islami, janë duke kryer punë praktike në Administratën Tatimore të Kosovës, me mundësi vazhdimi pas përfundimit të studimeve bachelor. Puna praktike u zhvillua në dy departamente ku në atë të

Shërbimit Publik Edukimit të Tatimpaguesve, studentët patën mundësi të shohin mënyrën e zbatimit të legjislacionit tatimor të Kosovës, duke përfshirë procedurat për Administratën Tatimore, TVSH-në, tatimin në të ardhura personale, si dhe tatimin në të ardhura të korporatave, me ç'rast panë edhe zhvillimin e politikave dhe procedurave për publikun për të kërkuar shpjegime, pastaj lëshimin e shpjegimeve individuale dhe publike për tatimpaguesit etj., teksa në departamentin e Kontrollit, detyrat e studentëve ishin që të këshillojnë në përzgjedhjet

e tatimpaguesve jo-individualë, të cilët do t'i nënshtrohen kontrollit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, në përputhje me "planin e kontrollit" të Administratës Tatimore, pastaj se si të asistojnë në menaxhimin dhe aprovimin e rimbursimit të TVSH-së, se si duhet bërë analizat periodike mbi rrjedhën e kontrolleve dhe planit për TVSH etj. Krahas kësaj, studentët janë pajisur dhe janë informuar edhe me ligjet e ATK-së, duke përfshirë ligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat, ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, atë për Tatimin e të Ardhurave Personale dhe ligjin për Tatimin e të Ardhurave të Korporatave.

## Studentët e Shkencave të Ushqimit vizitojnë fabrikën "Bylmeti"

Studentët e vitit të parë në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në fabrikën e përpunimit dhe prodhimit të produkteve të qumështit "Bylmeti", në Fushë Kosovë. Teknologët e fabrikës kanë bërë të ditur për studentët që veprimtaria primare e kësaj ndërmarrjeje është grumbullimi i qumështit të freskët, përpunimi i qumështit dhe distribuimi i prodhimeve nga qumështi. Derisa sipas tyre, si veprimtari të dytë ka tregtimin e

prodhimeve ushqimore. Gjatë kësaj vizite studentët janë njoftuar rreth problemeve me sigurimin e lëndës së parë, me bazë qumështin, si dhe janë njohur nga afër edhe me standardet e cilësisë dhe sigurisë, higjienës së qumështit dhe sistemet e ftohjes. Ndërkohë, përfaqësuesit e fabrikës "Bylmeti", kanë theksuar se nuk do të mungojë bashkëpunimi në të ardhmen me stafin dhe studentët e UBT-së.

## Përfaqësuesit e UBT-së vizitojnë Qendrën e Kompetencës në Skenderaj

Një delegacion i UBT-së, i përbërë nga dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, prof. dr Muhamet Ahmeti dhe prodekani i po të njëjtit fakultet, prof. dr Visar Krelani, vizituan Qendrën e Kompetencës profesionale në Skenderaj, me ç'rast vizituan objektin e kësaj shkolle, si dhe zhvilluan një takim me stafin dhe nxënësit e kësaj shkolle. Përfaqësuesit e UBT-së patën një takim me maturantët e kësaj shkolle, me ç'rast i njoftuan ata me historikun e themelimit të UBT-së, me programet, si dhe me kushtet

e studimeve në UBT, duke i shoqëruar edhe me këshilla se çfarë njohurish i marrin dhe se sa është i rëndësishëm vendimi për vazhdimin e studimeve. Tutje, ata vizituan edhe laboratorët me të cilët është e pajisur kjo shkolle, si njëri ndër laboratorët më modernë në Kosovë, ku edhe u paraqit nevoja e ndërsjellë për bashkëpunim, në kuadër të eksperimenteve, që mund të realizohen në këta laboratorë, si dhe të arrihet edhe një marrëveshje bashkëpunimi në lëmin e ndërtimit, arkitekturës dhe dizajnit.

## Studentët e Arkitekturës vizituan objektin e World Trade Center

Studentët e Fakultetit të Arkitekturës në UBT, vizituan objektin në ndërtim të World Trade Center, në kuadër të lëndës "Praktika e Punës". Në këtë vizitë, studentët u njoftuan me punimet që janë duke u realizuar, si dhe me të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë procesit të ndërtimit, derisa rëndësia e këtij ob-

jekti qëndron edhe në faktin se në këtë objekt është duke u përdorur sistemi i ndërtimit "COBIAX" dhe "Paranderja", i përdorur për herë të parë në Ballkan. Ky sistem mundëson që largësia mes dy mbështetësve të kalojë distanca shumë të mëdha deri në 30 metra, ku me këtë rast, distanca e objektit përkatës është 16 metra, gjë që

mundëson të kemi hapësirë të lirë, në mënyrë që të organizohet përdorimi i këtyre sipërfaqeve, sipas nevojës dhe destinimit. Tutje, studentët u informuan nga përgjegjësit e objektit edhe me punimet që janë duke u kryer me sistemin më të ri tek dyert dhe dritaret, si dhe produktet tjera.

Ndahet nga jeta profesori i UBT-së

## Përkujtim i përhershëm për kolegun Ganimet Klaiqi

Në periudhën mes dy numrave të gazetës së studentëve “UBT Neës” nga ne u nda profesori i nderuar i Fakultetit Media dhe Komunikim, Ganimet Klaiqi.

Ai zhvilloi një karrierë të gjatë si gazetar dhe si profesor, profesionist i vërtetë, i nderuar dhe i respektuar kudo ku punoi. Njeri që tërë shekullin e jetës, së këputur herët, qëndroi i palëkundur në mbrojtje të profesionalizmit, të së vërtetës dhe virtyteve njerëzore shumë pozitive, me të cilat rrezatoi gjithmonë dhe la kujtimet më të mira.

Ganimeti shkoi herët, duke lënë boshllëk të madh në familjen e tij, në të gjitha institucionet ku punoi, por sidomos në UBT, ku ne si kolegë dhe sidomos studentët, e ndjejmë për çdo ditë mungesën e fjalës, këshillës, dijes së tij.

Ai lindi më 26 janar 1965, në Poliçkë të Kamenicës. Shkollën fillore e ka mbaruar në vendlindje, të mesmen në Dardanë, fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në Prishtinë, si dhe studimet e nivelit master i ka mbaruar në Fakultetin e Filologjisë, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Klaiqi gjatë vitit shkollor 1993/1994, ka punuar si arsimtar i Gjuhës dhe letërsisë shqipe, në shkollën fillore “Abdullah Krashnica”, në Preshevë.

Më 1997 kishte nisur punën si korrespondent në të përditshmen “Koha Ditore”.

Pas përfundimit të luftës, në institucionet e përkohshme ka punuar një vit si shef i Zyrës së Informacionit në Kamenicë. Gjatë kësaj kohe është marrë me shkrime të ndryshme, në prozë e poezi. Në vitin 2000 i është rikthyer gazetarisë ku ka vazhduar deri më 2015, ku në të njëjtën kohë filloi ligjërimin edhe në UBT, për të vazhduar këtë punë deri në ditët e fundit të jetës së tij.

Disa orë para se të vdiste, ai la një porosi për institucionet, gazetarët dhe studentët e tij:

“Të nderuar miq, profesorë, gazetarë, familjarët e mi të dashur, vëllezër e motra, që më rrini pranë në këto ditë të



vështira për shërimin tim. Lajmet nga shoqëria po vinë si bombë e kurdisur, pa rrugëdalje, për shkak të mendësisë del të jetë primitive, sepse sulmet ndaj mendimit të lirë janë sulme ndaj vetë historisë njerëzore. Edhe në organizimet më të vjetra liria e shprehjes ishte dhe mbeti bosht i demokracisë. Mos i sulmoni gazetarët për bindjen e lirë, ata mund të jenë shtyllat që i japin hov luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar! Janë tanët dhe ashtu i duam!!!”.

Kujtimi për kolegun tonë të vyeshtëm, profesorin shembullor, mikun e madh, do të jenë të përhershme.

Buzëqeshja e tij do të na mungojë gjithmonë të gjithëve.

Në këtë gazetë të studentëve të UBT-së do të na mungojnë shkrimet e tij profesionale.

U prehsh në paqe, gazetari e profesori i shkëlqyeshëm, Ganimet Klaiqi.

## UBT mbajti ceremoninë e diplomimit për vitin akademik 2016/2017



Trembëdhjetë gjenerata të graduara në përvjetorin e 16-të të themelimit të UBT-së. Këtë bilanc, ky institucion i arsimit të lartë në Kosovë, e kurorëzoi të hënën, në sallën “1 Tetori” të Prishtinës, ku mbajti ceremoninë e graduimit.

Gjatë kësaj ceremonie madhështore, mbi 600 studentë, që po gradoheshin, dhjetëra profesorë të UBT-së, mijëra prindër, që kishin ardhur për t’i kurorëzuar sukseset e fëmijëve të tyre dhe mysafirë nga Kosova e ndërkombëtarë, i uroi për suksesin e përbashkët të arritur rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi.

“Sot është një ditë e veçantë sepse ne si UBT, si institucion i arsimit të lartë, që sivjet e shënon 16 vjetorin e themelimit, jemi krenarë që po përcjellim një gjeneratë të re, të përgatitur

dhe me energji për të kontribuar në ballafaqimin me sfidat e shoqërisë”, tha rektori Hajrizi, sipas të cilit, studentët e diplomuar tashmë janë ambasadorët dhe përfaqësuesit më të mirë të UBT-së dhe shtetit tonë.

“UBT i ka pajisur studentët me aftësitë kyçe për të qenë inovatorë dhe kampionë të ideve kreative, të cilat jo vetëm që u sigurojnë atyre një vend pune, por u japin nder vendit tonë, avancojnë një sektor të caktuar dhe krijojnë punë për të tjerët”, theksoi Hajrizi, duke iu drejtuar studentëve.

Profesoresha amerikane, Mary Somellwise tha se ndihet e emocionuar dhe e mrekulluar nga ajo që ka parë gjatë kësaj ceremonie.

“Ju jeni studentët më të mirë në institucionin më të mirë

arsimor, ndërsa sot për ju fillon një kapitull i ri në jetën tuaj sepse do të bëheni të gatshëm për t’u bërë pjesë e tregut të punës”, vlerësoi ajo, teksa i këshilloi studentët që ta sfidojnë dhe ta gjejnë veten.

Në vijim studentët kanë dhënë betimin akademik dhe janë pajisur me certifikata, kurse ish-studenti i UBT-së, Ideal Lecaj dhe studentja e dalluar, Abetare Shabani, kanë uruar gjeneratën për sukseset dhe kanë treguar për mundësitë e mirë që i ofron UBT për studim.

Në fund të ceremonisë, studentët kanë hedhur kapelat studentore, e cila është një traditë në këso ngjarjesh.

Infrastruktura në UBT – m'7 e kompletuara në rajon

## Rreth 100 laboratorë të specializuar në dispozicion të studentëve të UBT-së

Me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për studentët që zgjedhin të studiojnë në UBT, rektori prof. dr Edmond Hajrizi i ka kushtuar një vëmendje të veçantë kapaciteteve infrastrukturore të UBT-së.

UBT zhvillon veprimtarinë mësimore dhe shkencore në disa objekte. Në Kampusin Inovativ në Lipjan janë të pozicionuar tri objekte të ndërtuara me model dhe infrastrukturë më moderne. Objekti i UBT-së në Prishtinë, sidhe qendrat e UBT-së në Ferizaj dhe në Prizren, të cilat plotësojnë të gjitha kushtet për realizimin e procesit mësimor.

Rreth 100 laboratorë janë në dispozicion të studentëve për të zhvilluar punën praktike. Për të bërë më të lehtë mësim-nxënien, UBT në Kampusin Inovativ ka shtuar edhe shumë laboratorë të rinj, si mbi 50 laboratorë bashkëkohorë dhe gjithçka tjetër të nevojshme për të gjitha fushat e shën-

detësisë, kurse laboratorët aktualë, përfshirë atë të Arkitekturës, Infermierisë, SHKI-së, Mekatronikës, Shkencave të Ushqimit, Inxhinierisë së Energjisë etj, janë plotësuar me aparaturë dhe mjete të reja.

Këta laboratorë krijojnë kushte komode për realizimin e procesit të mësimdhënies. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me materiale të nevojshme për zhvillimin e orëve mësimore.

Rektori i UBT-së prof. dr Edmond Hajrizi tha se strategjia e UBT-së në vazhdimësi është që të bëjmë më të përshtatshëm studimin në zhvillimin e punëve praktike në laboratorë.

“Ne si një shtet në zhvillim, kemi nevojë për kuadro të reja dhe të përgatitura profesionalisht, që nuk kanë nevojë të bëjnë punë praktike jashtë vendit, sepse të gjitha do t'i gjejnë në UBT dhe do t'i zbatojnë po këtu”, tha Hajrizi.



## Studentet e UBT-së projektojnë shkop me sensorë për të verbërit



Shumë persona në shoqërinë tonë jetojnë me sfidën e mungesës në të pamur.

Statistikat tregojnë se aktualisht janë rreth 4 mijë persona të verbër dhe me të parë të dobësuar, që jetojnë në Kosovë. Kjo kategori e shoqërisë përballet me mungesë të infrastrukturës dhe kushteve për një jetë sa më të rehatshme.

Duke e parë këtë sfidë me të cilën përballet kjo kategori njerëzish, studentet e vitit të parë në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, Dylbere Rrustemi, Blerinë Sylja, Miradije Hasani dhe Emine Sylja, kanë menduar për këtë t'ua bërë me të lehtë jetën personave të verbër. Ato kanë projektuar një shkop të veçantë për këta persona, i cili përbëhet nga sensorë, të cilët kryejnë funksione

të shumta, duke përfshirë sensorin e ujit, të distancës, të vibrimit, që lidhen me GPS dhe butonin informues. Andaj, Falë këtij shkopit, të verbërit në bazë të tingujve dhe vibrimit, do të njoftohen për pengesat që gjenden para tyre.

Sipas studenteve, një shkop i tillë nuk ka ekzistuar më parë. Ato thonë se shkopit që kanë të verbërit tani nuk është shumë funksional dhe insistojnë në faktin se produkti i tyre ofron shumë funksione për të verbërit.

“Sensori i ujit do të vendoset në pjesën poshtë shkopit dhe do të njoftojë me vibrim dhe me tinguj se në afërsi ka ujë. Ndërsa, sensorin e distancës do të tregoj largësinë prej tre metrave dhe do të lëshoj tinguj të veçantë, në mënyrë që ta njoftojë personin e verbër që afër tij është një pengesë

fizike”, tregoi studentja Blerinë Sylja.

Ky shkop përveç që i ndihmon personave të verbër, është projektuar që t'ju ndihmojë edhe familjarëve.

Në bazë të tingujve dhe vendosjes së GPS-it dhe 3G, so dhe programit të instaluar në telefonat e familjarëve, ata do të njoftohen për gjendjen e familjarit të tyre të verbër.

“Butoni i projektuar në këtë shkop ka shumë funksione, butoni ka për qëllim që të lajmëroj familjarët për gjendjen e familjarit të tyre”, sqaroi studentja Sylja, e cila duke treguar për mënyrën e funksionimit të këtij shkopit, shtoi se, “nëse butoni mbahet i shtypur një sekondë, tregon se ku është vendndodhja e personit të verbër, nëse butoni mbahet i shtypur më shumë se tre sekonda, të jep sinjal që gjendja e familjarit të verbër është e keqe ka nevojë për ndihmën tonë”.

Studentet në fjalë treguan se deri te konkretizimi i idesë për këtë shkop ishte nxitëse punëtorja e “UPSHIFT: Social Impact Workshop”, që u organizua nga UNICEF Innovations Lab Kosovo, në bashkëpunim me UBT-në.

Në këtë punëtori, ideja e këtyre studenteve u shpërblye me çmimin e parë.

Duke treguar për idenë për shpikjen e një shkopit të tillë, Studentja Dylbere Rrustemi tha se është inspiruar nga përvoja e saj personale.

“Ideja ka qenë spontane duke u bazuar në përvojën e familjare. Gjyshi im ka qenë i verbër për shumë vite dhe i kam parë nga afër vështirësitë me të cilat është përballur ai, andaj kam menduar që bashkë me shoqet e mia, të bëjmë diçka më ndryshe”, tha ajo, teksa tregoi se ato e kanë konkretizuar idenë dhe po synojnë që këtë produkt ta finalizojnë së shpejti, me ç'rast tutje e pret faza e testimit dhe e prezantimit në tregun vënde e ndërkombëtar.

## Studentët e Infermierisë ofrojnë shërbime mjekësore falas për qytetarët në parkun e Gërmisë

Fakulteti i Infermierisë në UBT, në kuadër të Ditës Botërore të Hipertensionit, organizoi një aktivitet sensibilizues në parkun e Gërmisë, në Prishtinë.

Ky aktivitet u organizua nën kujdesin e Dekanit të Fakultetit të Infermierisë, Fitim Alidema, si dhe në bashkëpunim me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare “Fehmi Agani” në Prishtinë.

Me këtë rast, dhjetëra studentë të Fakultetit të Infermierisë të UBT-së, bënë matje të hipertensionit arterial për mbi 100 qytetarë të rastit, që treguan interes për këtë aktivitet.

Gjithashtu, studentët u dhanë informacione të detajuara mbi rëndësinë e një ushqyerje korrekte, të aktivitetit fizik dhe mbajtjes së kontakteve të rregullta me mjekun e familjes dhe mjekun specialist.

Në këtë aktivitet, po ashtu u shpërndanë për qytetarët edhe broshura informuese.

Kjo nuk është hera e parë që Fakulteti i Infermierisë në UBT po organizon aktivitete sensibilizuese për shëndetin e njeriut. Studentët e këtij fakulteti në vazhdimësi po ofrojnë shërbime sensibilizuese për një jetë të shëndetshme.



## Banka “ProCredit” ofron mundësi praktike për studentët e UBT-së



Në UBT është mbajtur sesioni informues për mundësitë e angazhimit praktik të studentëve të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në bankën “ProCredit”.

Në kuadër të këtij sesioni janë prezantuar mundësitë mbi programet profesionale që ofrohen nga banka për studentët. Me këtë rast përfaqësuesit e bankës kanë thënë se programi i praktikës ka për qëllim që t'i ofrojë studentëve që janë në studime, mundësi praktike dhe përfitim të përvojës së punës. Lirik Bakalli, përfaqësues i bankës “ProCredit”, ka theksuar

se “ProCredit Entry Programm”, është pika e vetme e qasjes në karrierë me bankën. Sipas tij, banka ofron aftësim profesional, në kuadër të së cilit organizohen module të larmishme, hulumtime, projekte e prezantime.

Konkursi për praktikë aktualisht është i hapur për gjithë studentët e UBT-së, përderisa kandidatët e përzgjedhur do të fillojnë praktikën në muajin korrik, si dhe do të fitojnë bursa. Studentët që do të fitojnë mundësinë për praktikë, mund të kalojnë edhe në programin e punësimit.



## Akademitë verore në UBT

## SHKI e SI pasurojnë Akademinë Ndërkombëtare Verore me shumëllojshmëri aktivitete

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike e Inxhinierisë dhe Fakulteti i Sistemeve të Informacionit, në UBT, si fusha që aktualisht janë duke marrë vëmendjen e botës për shkak të ndryshimeve të shpejta teknologjike, kanë qenë pjesë e rëndësishme e Akademisë Ndërkombëtare Verore të UBT-së.

Përgjatë ditëve të ANV-së, SHKI e SI mblodhën dhjetëra ekspertë vendorë e ndërkombëtarë të fushës, të cilët trajtuan një mori temash dhe sollën një qasje inovative për zgjidhjen e problemeve të ndryshme, karshi çështjeve që janë prezente dhe të rëndësishme në epokën digjitale.

Gjatë ditëve të para, për studentët e këtyre fushave dhe jo vetëm, u ligjërua aspekti teorik i temave të ndryshme mbi teknologjinë, nga të dhënat bazike mbi teknologjinë e kohës moderne, e deri tek sulmet kibernetike, masat parandaluese dhe mënyrën e mbrojtjes nga to, kurse pjesa e dytë e ANV-së në këto drejtime, i është kushtuar tërësisht aspektit praktik.

Hapjes së ANV-së së SHKI-së, në Prishtinë, i parapriu mbajtja e saj në Tiranë, ku ligjëruan përfaqësuesit e kompanisë "Sentry" dhe hakeri i njohur, Philip Polstra, teksa i tërë organizimi u mbajt falë bashkëpunimit me partnerët "AKCESK", "MIAP" dhe "Sentry", nën përkujdesjen e UBT-CERT dhe SHKI-së.

Gjatë këtyre ditëve, përfaqësuesit e kompanisë "Sentry" ligjëruan mbi sigurinë e rrjeteve, ndërsa Polstra trajtoi temat: "Windows Forensics" dhe "Linux Forensics".

Hapjen e Akademisë Ndërkombëtare Verore, në Prishtinë, e bëri rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili pohoi se siguria e informacioneve në një epokë të zhvillimit të madh digjital, si kjo e tanishmja, është sa e rëndësishme aq edhe e rrezikuar.

Sipas tij, me qëllim të gjenerimit të kompetencave në këtë aspekt, institucioni të cilin ai e drejton, ka themeluar divizionin UBT-CERT dhe Qendrën për Siguri kibernetike dhe Privatësi, teksa shtoi se në Kosovë ka ende shumë hapësirë për përfshirje në këtë fushë.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësuesit e kompanive të njohura vendorë, përfshirë atë të kompanisë "Rrota", Ardian Velu, pastaj Arjeta Gashi nga KOSTT dhe Arianit Zabërgja nga kompania "Formon", të cilët u shprehën se janë të lumtur që për kompanitë e tyre punojnë ose e përfundojnë praktikën studentët dhe ish-studentët e UBT-së.

Vlerë shtesë e Akademisë Ndërkombëtare Verore që u mbajt në Prishtinë, ishte pjesëmarrja e hakerit Philip Polstra, i cili, për pjesëmarrësit ligjëroi në ditët e para të akademisë së SHKI-së, për çështje që lidheshin me sigurinë e të dhënave, me ç'rast konkretisht u fokusua tek tema: "Digital Forensics with Open Source Tools – Linux", pas të cilës mbajti edhe një punëtori për studentët pjesëmarrës, përmes ekzekutimit të komandave, krahasimeve e rezultateve.

Krahas ligjëratave për sigurinë kibernetike, Akademia Verore e UBT-së mblodhi edhe ekspertë e profesionistë nga industria, të cilët ligjëruan mbi trendët e fundit të zhvillimeve nga fusha e teknologjisë, sidomos duke u fokusuar në trendët më pak të zhvilluar në Kosovë, e që kanë nevojë për njerëz të rinj.



Për të treguar mbi rëndësinë e kësaj sfere të re, përfaqësuesit e kompanisë së njohur vendorë, "Zombie Soap", përkatësisht drejtori ekzekutiv, Agon Avdimetaj, drejtoresha për lojërë në këtë kompani, Agnesa Belegu dhe zhvilluesit e lojërave, Endrit Xhemali e Altin Maloku, ishin pjesë e Akademisë Ndërkombëtare Verore në Fakultetin e SHKI-së dhe SI-së, me ç'rast ligjëruan për interface-in e Unity 3D, si dhe për procesin e krijimit të lojërave në këtë softuer të dedikuar për zhvillimin e lojërave.

Në fund të ciklit të ligjëratave të tyre, pjesëtarët e kompanisë "Zombie Soap" mbajtën pjesën praktike për pjesëmarrësit, me ç'rast edhe i angazhuan në formë grupore për krijimin e lojërave që ata i kishin ideuar, si dhe për fund vizituan edhe ambientet e punës së kësaj kompanie dhe punën që është zhvilluar në kuadër të saj.

Cikli i ligjëratave që u mbajtën nga njerëz të inkuadruar drejtpërdrejt në industri, pasoi me temat e trajtuara nga përfaqësuesit e kompanisë "Sentry", Drinor Selmanaj dhe Kujtim Kryeziu, të cilët trajtuan temën: "Hacking and Digital Security", ku edhe kanë dhënë informacione të detajuara për praktikën më të mira botërore për siguri kibernetike, teksa aktiviteti intensiv vazhdoi me ligjëratën e Artan Salihut, mbi temën "Cloud Computing".

Në ligjëratën e tij, Salihu trajtoi fillimisht konceptin e Cloud Computing dhe arkitekturën e saj, pastaj ka vazhduar me SDN-në dhe NFV-në, si teknologji të cilat po promovojnë aplikimin komercial të Cloud Computing dhe po ndryshojnë botën e rrjeteve telekomunikuese, ndërsa në fund, janë përmendur edhe platformat ekzistuese, faktorët e përzgjedhjes dhe trendët më të fundit në këtë fushë.

Cikli i ligjëratave teorike për pjesëmarrësit e ANV-së së SHKI-së dhe SI-së, vazhdoi me ligjëratat e të angazhuarve

në UBT, Betim Gashi dhe Lavdim Menxhiqi, që ligjëruan për aspektet e zhvillimit të ueb faqeve, programimin e tyre në Server Side dhe përdorimi i CMS-ve tek palët që nuk janë njohës të programimit, përkatësisht u ligjërua për temën "Dynamic Web", gjatë të cilës shtjelloi në mënyrë të detajuar gjuhën programuese HTML, që shërben për strukturimin e të dhënave, pastaj CSS, që shfrytëzohet për stilizimin e të dhënave dhe Javascript, që shfrytëzohet për realizimin e animacioneve. Teksa, në fund, për studentët pjesëmarrës ligjëruan edhe përfaqësuesit e kompanisë Sentry – Cybersecurity, Robert Shala dhe Drin Raci, të cilët trajtuan çështjen e sulmeve më aktuale kibernetike në ueb aplikacione dhe masat mbrojtëse kundër tyre. Po ashtu, në kuadër të kësaj ligjërate, studentet pjesëmarrës patën rastin të praktikojnë pjesën ofensive dhe defansive, që aplikacionet e tyre të jenë më konkurrense dhe më atraktive në treg. Pas përfundimit të ligjëratave tematike, përkatësisht të pjesës praktike të ANV-së, studentët patën të rastin të shohin në praktikë gjithçka që e kishin trajtuar në teori, falë vizitave që realizuan nëpër kompanitë më të mëdha e më të njohura vendorë që operojnë në Kosovë, duke përfshirë kompaninë "Z Mobile", "Open Data Kosovo", "Girls Coding Kosova" dhe "Zombie Soap", nëpër të cilat u takuan me udhëheqësit e kompanive, që u dhanë studentëve informacione mbi punën që kryhet brenda kompanive, me ecurinë, si dhe me perspektivën që ato kanë.

Aktiviteti i Akademisë Ndërkombëtare Verore të SHKI-së dhe SI-së mbaroi me mbajtjen e kuizit përmbyllës, në të cilin u parashtruan pyetje të përgjithshme, që kishin për qëllim vlerësimin e njohurive të fituara nga lëndët që u ligjëruan gjatë akademisë.

Studentët u ndanë në grupe deri në katër persona dhe u përgjigjen online nëpërmjet platformës Kahoot, me anë të telefonave personalë apo laptopëve, teksa i tërë aktiviteti u zhvillua nën mentorimin e asistentit në UBT, Blerim Zylfiu. Në bazë të rezultateve të treguara në këtë kuiz, vendi i parë i takoi grupit "GIM", anëtarët e të cilit u shpërblyen me trajnim pa pagesë që ofrohet nga "UBT Executive Academy for Professional Development".

Fushat në të cilat u testuan studentët ishin: Hacking and Digital Security, Gaming, Dynamic Web dhe Digital Forensic. Pas një akademie intensive të këtyre dy fakulteteve, në ceremoni të ndara, u bë ndarja e certifikatave, e cila kurorëzoi punën dyjavore dhe plot gjallëri e aktivitete të llojllojshme të pjesëmarrësve të Akademisë së SHKI-së dhe SI-së.

Akademia Verore e sivjetme e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë dhe ajo e Fakultetit të Sistemeve të Informacionit, u vlerësuan si shumë të suksesshme jo vetëm nga pjesëmarrësit, por edhe nga përfaqësuesit e kompanive që patën rastin të ligjërojnë dhe të cilët u shprehën të mahnitur me punën dhe me interesimin e studentëve.

Fatbardhë Kiqina



## Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, kontribuon me shtjellimin e temave pak të njohura në Kosovë

Në kuadër të Akademisë Verore Ndërkombëtare në UBT, Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, mori vëmendjen e studentëve, industrisë së ushqimit dhe njohësve të kësaj fushe.

Aktiviteti i këtij fakulteti filloi me ligjëratën e përfaqësuesit të kompanisë “Herbalife”, And Abdullahu, i cili trajtoi temën: “Shkencat e Ushqimit dhe Nutricioni”, në kuadër të së cilës u diskutua për produktet e ndryshme ushqimore, për të ushqyerit, dietat, shmangien e ushqimeve të dëmshme, për mënyrën e qasjes karshi kontrollit të ushqimit nga kompanitë e ndryshme, për format e të ushqyerit sipas standardit herbal etj.

Përveç kësaj, në akademia e këtij fakulteti ka vazhduar me ciklin e ligjëratave, të cilat u prezantuan nga profesorët vendor e ndërkombëtar.

Hulumtuesi shkencor në Universitetin “BOKU”, në Austri, njëherësh edhe profesor vizitor në UBT, Imri Demelezi, ka trajtuar temën “Siguria dhe qëndrueshmëria e ushqimit – Konceptet, rrugët dhe faktorët përcaktues”. Në kuadër të temës së shtjelluar nga profesori Demelezi, është folur për politikat që praktikohen në sigurinë e ushqimit dhe qëndrueshmërinë në Kosovë, sistemi i sigurisë së ushqimit, sistemet bujqësore në Kosovë etj.

Ndërkaq, profesori Demelezi trajtoi edhe temën që ka të bëjnë me sigurinë dhe qëndrueshmërinë e ushqimit. Ai shtjelloi aspekte që lidhen me përhapjen e sigurisë ushqimore në Kosovë, në aspektin social, ekonomik dhe ambiental, pastaj mënyrat e ndryshme të përfshirjes dhe kontributit të njerëzve në këtë fushë, të gjitha këto të përcjella me shembuj nga përvoja personale e tij, mbi sigurinë dhe qëndrueshmërinë ushqimore në Evropë dhe botë.

Tutje, Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Teknologjisë, për studentët pjesëmarrës ka trajtuar temën për toksinat me prejardhje bimore, ku u diskutua rreth kontekstit të sigurisë shëndetësore të ushqimit dhe në të ushqyerit e njeriut dhe kafshëve shtëpiake. Me këtë rast, kanë ligjëruar profesori Gafurr Xhabiri dhe PhD. Cand. Hyrije Krasniqi.

Për temën “Inxhinieria e përpunimit të ushqimeve – Njësitë e procesit dhe analiza e gradëve të lirisë”, ka folur eksperti i kësaj lëmie profesori në Universitetin e Tiranës, dr. Ilirjan Malollari. Duke folur për menaxhimin e lëndëve të para dhe përpunimin e tyre në industrinë ushqimore, profesor Malollari, ka theksuar se cilësia e ushqimeve, vlerat ushqyese si dhe konsumimi i tyre përgjatë tërë vitit, kanë një ndikim të konsiderueshëm në shëndetin e njeriut.

Duke qenë kështu, me modulën e ligjëratave ka vazhduar profesoresha në Universitetin Bujqësor të Tiranës, dr. Magdalena Cana, e cila ka shtjelluar temën: “Bioteknologjia molekulare”. Gjatë ligjëratës, Cana u ka shpjeguar pjesëmarrësve se si aplikohet bioteknologjia, sipas të cilës, është shkencë që përfshin inxhinierinë gjenetike sikurse edhe teknologjitë e kulturave të indeve e qelizave.



Fakulteti i Shkencave të Ushqimit në UBT, ka përmblyllur suksesshëm punimet në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, ku përgjatë shumë ditëve janë shtjelluar shumë tema aktuale, e të cilat janë në interes për shoqërinë. Në fund, profesoresha në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit në UBT, Hyrie Koraqi, ka ndarë certifikata për pjesëmarrësit, si dhe për profesorët që ligjëruan për kontributin e dhënë në këtë akademi.

Vlen të theksohet se, aktualisht në UBT gjendet edhe specializimi “Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit”, në kuadër të Fakultetit të Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, si një fushë shumë e rëndësishme dhe në të njëjtën kohë, shumë pak e zhvilluar në Kosovë

Ndërsa, Fakulteti i Infermierisë në UBT, në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, ka zhvilluar ligjëratat dhe aktivitete të tjera ku përgjatë disa ditëve ligjëruan ekspertë të fushës përkatëse, si nga vendi ashtu edhe nga bota. Tema kyçe e këtij Fakulteti është: “Mjekësia dhe Shkencat e Shëndetësisë”.

Hapjen e këtij aktiviteti e ka bërë ekspertja e sistemit shëndetësor, Elizabeth Campestrini nga Austria, e cila për studentët pjesëmarrës ligjëroi për temat “E Drejta e Shëndetit” dhe “Cilësinë dhe sigurinë e pacientit në sistemin shëndetësor austriak”.

Me këtë rast, Campestrini shqyrtoi konceptet rreth të drejtave të shëndetit, liritë, shkeljet e të drejtave, qasje të bazuar në të drejtat e njeriut etj. Tutje, ajo ligjëroi edhe mbi aktet e cilësisë së kujdesit shëndetësor, strategjitë e cilësisë austriake,

strategjitë austriake për sigurinë e pacientëve, për sigurinë shëndetësore, për transparencë etj.

Aktiviteti vazhdoi me ligjërimin për “Aplikimi i kompjuterikes në shëndetësi: e-health dhe intelijenca artificiale”, me ç’rast ka ka ligjëruar profesori i UBT-së, prof. dr Zhibert Tafa. Tema përfshiu domenin e tele-care sistemeve dhe sistemet për menaxhimin e shënimeve elektronike shëndetësore.

Mbylljen e këtij aktiviteti e ka bërë po ashtu ekspertja Elizabeth Campestrini, e cila ligjëroi temën më titull: “Ndryshimi dhe menaxhimi i stresit si mjete kryesore për ndryshim në strukturën shëndetësore në Kosovë, bazuar në strukturën shëndetësore në Austri”. Campestrini për studentët pjesëmarrës shtjelloi edhe aspektin e përqendrimit në sigurinë shëndetësore, organizatat shëndetësore, mënyrat e sjelljes, strategjitë që duhet të përdoren etj.

Në fund, për studentët pjesëmarrësit u ndanë certifikata për kontributin e dhënë.

Infermiera në UBT ofrohet në bashkëpunim me Qendrën Klinike Universitare, tekta të diplomuarit pajisen me diplomë të dyfishtë, që e marrin nga UBT dhe nga University of Somelceiss, në Hungari. Po ashtu, vlen të theksohet se programi është i harmonizuar me rregullat e Bashkimit Evropian dhe ofron mundësi transferi dhe studime jashtë vendit përmes programit të shkëmbimit, “Erasmus Mundus”, të BE-së, si dhe njohje të diplomës në Evropë.

**Anisa Rada**



Akademitë verore në UBT

# Konkretizohen projektet urbanistike të studentëve të Arkitekturës



Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor ka mbajtur aktivitetin në Akademinë Ndërkombëtare Verore, në kuadër të së cilës janë zhvilluar shumë ligjërata e projekte inovative. Aktiviteti ka zhvilluar punimet në kampuset inovative të UBT-së, derisa morën pjesë mbi 100 pjesëmarrës. Studentët pjesëmarrës në këtë akademi patën mundësinë e përgjdhjes së modulit në të cilin ndoqën ligjëratat dhe realizuan projektet e tyre, teksa në module u përfshinë: Qyteti dhe komuniteti, Menaxhimi urban, Dizajnimi pa barriera, Arkitektura digjitale dhe Aplikimi i drurit në arkitekturë.

Me këtë rast, dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, prof. dr Lulzim Beqiri ka thënë se akademia e fakultetit të cilin ai e drejton, është përcjellë me një dinamikë të madhe të punës, gjë që sipas tij, ka rezultuar me punime profesionale dhe projekte që lehtësisht mund të përdoren për zgjidhjen e problemeve aktuale në fushën e arkitekturës.

Studentët pjesëmarrës në Akademinë Ndërkombëtare Verore, të organizuar nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, konkretizuan idetë e tyre, përfshirë edhe aspektin e menaxhimit, planifikimit dhe dizajnit të një lokacioni real, që në këtë rast është rruga "Rexhep Krasniqi", në lagjen Kalabria të Prishtinës.

Për të realizuar detyrën e tyre, studentët morën instruksione dhe këshilla nga profesori në UBT, dr. sc Binak Beqaj dhe asistentja Vlora Aliu, teksa puna e tyre kaloi nëpër disa faza, duke përfshirë, analizimin e lokacionit të zgjedhur, përcaktimin e objektivave zhvillimore të zonës, rregullimin e strukturave menaxhuese, përgatitjen e planit dinamik, si dhe planifikimin e dizajnit.

Përmes këtij projekti, parashihet që studentët të ofrojnë zgjidhje reale të problemeve që dalin nga mosfunksionimi i kësaj rruge që është marrë si rast studimi, me ç'rast do të ofrohen ide konkrete për përmirësimin e cilësisë së rrugës, rregullimin e hapësirave të gjelbëruara, parkingjeve dhe ndriçimit përreth këtij lokacioni, si dhe krijimin e funksioneve tjera plotësuese, që do të shërbejnë për lehtësimin e punës së studentëve në procesin akademik.

Studentët, pasi prezantuan projektet e tyre në varësi të moduleve në të cilat u ndoqën ligjëratat, morën certifikatat për kontributin dhe aktivitetin e tyre në Akademinë Ndërkombëtare Verore, e mbajtur në UBT.

Projektet finale u prezantuan në ditën përmbyllëse të kësaj akademie, teksa pas shqyrtimit brenda UBT-së, ato janë prezantuar Komunës së Prishtinës, si dhe tashmë është duke u shqyrtuar mundësia e implementimit të tyre, në mënyrë që përfitimet e komunitetit të jenë të shumanshme.

Aktiviteti të Fakultetit për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, i kanë kontribuar ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, studentë nga shtetet fqinje etj

Vlen të theksohet se gjatë kësaj akademie, studentët patën rastin të dëgjojnë ligjëratë nga profesoresha e Universitetit të Bolonjës, Adriana Gaviani, e cila trajtoi aspektin e qëndrueshmërisë në qytet, me fokus tek kontributi individual në ngritjen e sasisë së gjelbërimit.

Ndërkohë, studentët janë shprehur shumë të kënaqur dhe entuziastë për aktivitetet e zhvilluara gjatë akademisë.

Në aktivitetin e Akademisë Ndërkombëtare Verore, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor kon-

tributin e tyre dhanë, përfshirë ligjëruesit, MSc. Zekë Islamaj, MSc. Rineta Jashari, Dr.Cand. Arbër Sadiki, MSc. Artan Behluli, MSc. Faton Spahiu, MSc. Gëzim Radoniqi, Dr. Lulzim Beqiri, Dr.Cand. Mimoza Sylejmani, Dr.Cand. Besian Sinani, MSc. Zana Prelvukaj, Dr. Binak Beqaj, Dr. Cand. Vlora Aliu, Dr.Cand. Petrit Ahmeti, MSc. Ilir Dalipi, MSc. Merita Dalipi, MSc. Zejnulla Rexhepi.

## Në ANV-në e Planifikimit të Qëndrueshëm të Turizmit marrin pjesë studentët e profesorë nga Zvicra

Janë zhvilluar suksesshëm aktivitetet në Planifikimin e Qëndrueshëm të Turizmit, pjesë e Akademisë Ndërkombëtare Verore, që është mbajtur në kuadër të Qendrës së Ekspertizës për Mikpritje dhe Turizëm (CoE H & T) të UBT-së.

Në këtë organizim dhanë kontributin e tyre profesorë vendorë e ndërkombëtarë, si dhe njohës të këtij sektori.

Në këtë aktivitet ka ligjëruar edhe profesori Marsel Furer nga Akademia Zvicerane e Turizmit dhe profesori Chantal Beck nga Shkolla e Lartë e Turizmit HFT, në Luzern të Zvicrës.

Pjesë e kësaj akademie ishin edhe grupi i studentëve nga Shkolla e Lartë e Turizmit, në Zvicër, të cilët me javë kanë punuar në hulumtime në sektorin e turizmit dhe hotelierisë në Kosovë.

Gjithashtu, UBT, në kuadër të kësaj akademie ka organizuar edhe vizita në sektorin privat, si dhe prezantime nga kompanitë dhe organizatat aktive në sektorin e turizmit.

**Edona Jerliu**



Në kuadër të ANV-së së MBE-së

## Ekspertë vendorë e ndërkombëtarë trajtojnë temat e rëndësishme ekonomike

Fakultet Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, ka zhvilluar ligjerata dhe aktivitete në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore. Shumë studentë të universiteteve publike dhe kolegjeve private po marrin pjesë në Akademinë Ndërkombëtare Verore, respektivisht në aktivitetet e fakultetit në fjalë.

Hapjen e këtij aktiviteti e bëri prof.dr Grigoris Zarotiadis nga Greqia. Për studentët e MBE-së, Zarotiadis trajtoi temën: "Perspektivat makro dhe mikro perspektivat e inovacionit dhe ndryshimeve teknologjike në sektorin financiar".

Punimet e ditës së parë u përcollën me interesim të madh nga pjesëmarrësit, kryesisht studentët të UBT-së dhe universiteteve e kolegjeve tjera në Kosovë.

Në pjesën e dytë, u mbajt një ligjëratë nga kryeshefja ekzekutive e Bankës Ekonomike të Kosovës, Merita Gjyshinca-Peja, e cila i njoftoi pjesëmarrësit e akademisë me strategjinë e zhvillimit të bankës të cilën ajo e drejton, si dhe me përmirësimin e pozitës së kësaj banke në sektorin bankar.

Tema specifike e Merita Gjyshinca-Peja ishte "Menaxhimi i Riskut Operacional nga Banka Ekonomike".

ANV-ja e Fakultetit për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi u përcjell me interes të veçantë, kjo si rezultat i ligjëratave tematike që po shtellohen si dhe sjellja e ekspertëve nga e gjithë bota, të cilët po ndajnë përvojat e tyre.

Për gjithë pjesëmarrësit, ka ligjëruar edhe zëvendëshefi i UNICEF-it për Kosovë, Dr. James Mugaju.

Ai ka folur rreth rëndësisë së inovacionit dhe ndërmarrësisë, ndërkohë ka trajtuar edhe çështjen e rritjes ekonomike në këtë drejtim. Sipas tij, inovacionet kanë rol pozitiv, teksa qëllimi i tyre është përmirësimi i kushteve të komuniteteve.

Derisa për performancën dhe rolin e inovacionit në firma ose kompani ka folur edhe profesori nga Austria, Engelbert Selenko, i cili ka paraqitur shembuj praktikë në këtë fushë. Ai tha se krijimi i një koncepti të ri dhe arritja e suksesit komercial konsiderohet si inovacion.

Punimet Akademia Verore në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, respektivisht dega Banka, Financa dhe Sigurime, që organizohet në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, i ka vazhduar punimet me ligjëratën e mbajtur nga menaxheri i riskut në Bankën për Biznes (BPB), Selajdin Ujkani, i cili ka thënë se menaxhimi i riskut është një komponent shumë i rëndësishëm në menaxhimin financiar.

Tutje, ai tha se menaxhimi i riskut siguron që masat parandaluese dhe ato të kontrollit të parandalojnë, të zvogëlojnë ose të eliminojnë rreziqet për biznesin, që janë të lidhura në rezultatet e vlerësimit të riskut.



Ndërkohë, në vazhden e aktiviteteve ka ligjëruar po ashtu drejtoresha e departamentit të licencimit dhe standardizimit në Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Albulena Xhelili, e cila ka trajtuar temën "Kuatridheqor i sektorit bankar".

Për më tepër ajo tha se aktivitetet bankare, si aktivitetet tjera ekonomike, mbështeten në baza të përcaktuara ligjore.

Aktiviteti ka përmbyllur punimet me vizitat studimore që janë organizuar në Bankën Raiffaisen dhe Bankën për Biznes.

Përmbyllja e kësaj akademie është bërë më shpërndarjen e certifikatave për të gjithë pjesëmarrësit.

Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi i UBT-së, është fakulteti që udhëheq në vend e rajon tash e më shumë se 16 vite, kjo falë programeve specifike që i ofron nga fushat e Menaxhmentit, të Biznesit dhe të Ekonomisë, kështu duke u shndërruar në zgjedhjen ideale për studentët aktualë dhe ata të ardhshëm të këtij drejtimi.

Përkundër ekzistimit të programeve të ndryshme paralele në region, MBE ishte dhe vazhdon të jetë lider akademik dhe profesional, duke iu përgjigjur nevojave themelore dhe atyre

strategjike të sektorëve publikë e privatë në Kosovë dhe regjion.

MBE ka dizajnuar programe specifike duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut nga trendet vendorë, regjionale dhe ata botërorë të zhvillimeve, duke shikuar paralel edhe kërkesat e tregut të punës, andaj në bazë të kësaj, ky program është hartuar duke u bazuar në faktorët më të rëndësishëm dhe nga treguesit e matshëm të nevojave për zhvillim ekonomik dhe të mundësive të reja të vendeve të punës në tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Pos mundësive të mëdha për punësim, ky program ofron edhe mundësi për vazhdim të studimeve jashtë vendit, përmes burave të shumta që ndahen për studentët, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit të UBT-së me universitetet më prestigjioze në Evropë dhe SHBA, si dhe falë bashkëpunimit me programin Erasmus +.

Anisa Rada

## Qendra e Karrierës informoi dhe përgatiti studentët për sfidat në procesin e punësimit



Njëra ndër qendrat më të rëndësishme dhe më funksionale në UBT, në ofrimin e këshillimit dhe orientimit profesional për studentët, Qendra e Karrierës, ka zhvilluar një aktivitet të pasur përgjatë ditëve të Akademisë Ndërkombëtare Verore, që ngjalli interesim të madh edhe në mesin e studentëve pjesëmarrës.

Hapja e akademisë së kësaj qendre është bërë me ligjëratën e ekspertit të njohur nga Maqedonia, Visar Ademi, i cili u ka shpjeguar pjesëmarrësve për mënyrat më efektive dhe për rëndësinë e zhvillimit të karrierës, ligjëratë kjo që u përcoll me mbajtjen e punëtorisë mbi format e shkrimit të CV-ve

dhe letrave të motivimit, të cilat janë të domosdoshme për aplikim në punë dhe njëkohësisht, për rëndësinë e tyre në fazën e intervistimit.

Aktiviteti i larmishëm i ANV-së së Qendrës së Karrierës ka vazhduar me ciklin e ligjëratave që u mbajtën nga ligjëruesja në UBT, Gjylbehare Llapi, që për pjesëmarrësit trajtoi elemente që lidhen me shkrimin akademik, duke u fokusuar tek format e shkrimit të eseve, llojet e paragrafëve dhe tek lista kontrolluese e eseve.

Akademia e Qendrës së Karrierës pasoi me ligjëratat e mbajtura nga ekspertë nga industria, të cilët i konsiderojnë

studentët e UBT-së si shumë të përgatitur dhe profesionalë në punët që bëjnë. Ndër ta, pjesëmarrës ishte drejtori i kompanisë "JusPost", Haxhi Rugova, i cili dha informacione mbi mënyrat se si arrihet me lehtësi deri tek punësimi, teksa shpërfaqti edhe detaje mbi kërkesat aktuale të tregut vendor e ndërkombëtar të punës.

Qendra e Karrierës e UBT-së, mbylli punimet e akademisë së vet me organizimin e Panairit Virtual të Karrierës, në të cilin morën pjesë shumë kompani, të cilat operojnë në Kosovë.

Deloitte, Aztech, Asseco, Bitfox dhe ProCredit Bank, janë kompanitë pjesëmarrëse në këtë panair, gjatë të cilit, përfaqësuesit e tyre i njoftuan studentët me mundësitë e punësimit dhe përfundimit të punës praktike nëpër këto institucione.

Panairi kishte për qëllim që studentët të kenë mundësi të marrin informacione të drejtpërdrejta nga kompanitë, sa i përket pozitave të punësimit dhe praktikës profesionale.

Krahas kësaj, në këtë panair u demonstruan edhe aftësitë e studentëve, të fituara gjatë ndjekjes së ligjëratave në ANV-në e Qendrës së Karrierës, sa i përket mënyrës së përgatitjes sa më të mirë të CV-së, letrës motivuese, përgatitjes për intervistat e punës etj.

Në fund të këtij organizimi, për studentët pjesëmarrës u ndanë certifikata, për përkushtimin dhe pjesëmarrjen e tyre të rregullt në ANV.

Fatbardhë Kiqina

Aktivitetet e Fakultetit Media dhe Komunikim në Akademinë Ndërkombëtare Verore

# Media moderne, sfidë për profesionistët e rinj



Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, Fakulteti Media dhe Komunikim ka mbajtur aktivitet të ndryshme me ç'rast janë trajtuar tema: "Ndikimi i mediave sociale në sigurinë rajonale dhe botërore", si dhe nëntema të tjera, përfshirë fazën e zhvillimit të mediave në epokën e digjitalizimit, ndikimi i rrjeteve sociale në gazetarinë e shtypur, Marrëdhëniet me Publikun në epokën digjitale, standardet profesionale dhe etika etj.

Ligjëratat janë mbajtur nga gazetarë, profesorë të gazetarisë, ekspertë të rrjeteve sociale, teksa në ditën parë, ka ligjëruar dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, prof. dr Ferid Selimi, ku ka trajtuar temën më titull: "Ndikimi i gazetarisë së verifikimit në sigurisë rajonale dhe botërore", në kuadër të secilës janë trajtuar probleme të ndryshme të mediave në rrafshin e sigurisë nacionale, rajonale e botërore.

Në hapjen këtij aktiviteti, për gazetarët e ardhshëm ligjëroi zv. drejtori i përgjithshëm i RTK-së, njëherësh edhe ligjërues në UBT, PhD. Cand, Safet Zejnullahu, i cili trajtoi temën më titull: "Lajmet e rreme në epokën digjitale", duke u fokusuar në ndryshimet që ka bërë zhvillimi dhe përhapja e internetit, në mënyrën e të ushtruarit të këtij profesioni dhe mbi të gjitha, në përhapjen me shpejtësi të informacioneve, të cilat shpesh janë të paverifikuara e të rreme dhe si të tilla i servohen edhe qytetarëve.

Në kuadër të ANV-së, për studentët e Medias dhe Komunikimit ligjëruan profesori i UBT-së, Sadri Ramabaja, i cili trajtoi temën: "Federata Shqiptare versus Jugosllavisë së re", pastaj ligjëroi profesoresha e Corvinus University, në Hungari, dr Elisabeth Kardos Kaponyi, me ç'rast foli për temën "Përgjegjësia për mbrojtjen dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut", gjatë secilës shpërfaqti informacione mbi klasifikimin e të drejtave të njeriut, për dokumentet e amandamentuara nga shtetet e ndryshme mbi të drejtat e njeriut etj., teksa politologu dhe ligjëruesi në UBT, prof. dr Belul Beqaj prezantoi dhe shtjelloi temën më titull: "Roli i liderit politik në politikën e mediave".

Gjatë aktivitetit të ANV-së, Fakulteti i Medias dhe Komunikimit në UBT, për studentët pjesëmarrës ka prezantuar temat në të cilat u shtjellua çështja e etikës në gazetari, e pasuar nga raste konkrete, që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nëpër vende dhe periudha të ndryshme kohore.

Gjatë këtij cikli ligjëratarsh, ligjëroi gazetari dhe ligjëruesi në UBT, Musa Sabedini, i cili trajtoi temën: "Mediat sociale dhe platformat e tyre".

Duke folur rreth funksionimit të mediave sociale, Sabedini tha se këto media aktualisht po përdoren si burim informacioni. Sipas tij, rritja e qasjes së mediave sociale është e shoqëruar me një përdorim gjithnjë e më të madh të tyre nga aktorët e ndryshëm të shoqërisë, përfshirë këtu edhe ata të politikës, biznesit, marketingut dhe medias.

Tutje, ai theksoi se rrjetet sociale kanë përparësitë dhe

mangësitë e tyre dhe si të tilla, konsiderohen se ndikojnë në jetën e përditshme ngaqë, sipas tij, respektimi i etikës në këto media është çështje që duhet diskutuar. Në ligjëratën e saj për studentët pjesëmarrës, profesoresha e Corvinus University, në Hungari, dr. Elisabeth Kardos Kaponyi trajtoi temën më titull: "Raste konkrete të shkeljes së të drejtave të njeriut", gjatë së cilës fillimisht shpalosi informacione rreth klasifikimit të drejtave të njeriut ku përfshihen, e drejta e grave, e drejta e fëmijëve, e drejta e njerëzve të moshuar e refugjatëve, si dhe ndër to, theksoi të drejtën e lirisë së shprehjes, e cila është e garantuar për secilin individ. Kaponyi, ndër tjerash prezantoi edhe pasojat që janë shfaqur për shkak të kufizimit dhe mosrespektimit të drejtave të njeriut dhe të lirisë së shprehjes nëpër vende të ndryshme të botës, duke u fokusuar në rastin e shkeljes së të drejtave të punëtorëve në Kinë, si dhe ato të qytetarëve sirianë gjatë luftës së fundit, që po zhvillohet në Siri.

Fakulteti i Medias dhe Komunikimit në UBT, në ditën e katërt të Akademisë Ndërkombëtare Verore, krahas ligjëratave tematike ka mbajtur punëtorinë për kamerë dhe fotografi për të gjithë studentët pjesëmarrës, të cilët kanë qenë entuziastë për këtë fushë.

Gjatë trajnimit të organizuar, tutorja në Fakultetin Media dhe Komunikim, Anisa Rada, në pjesën teorike të punëtorisë, tha se fotografia është art, që aplikohet për krijimin e imazheve të ndryshme.

Qëllimi i kësaj punëtorie, sipas saj, ka qenë trajnimi i studentëve pjesëmarrës, për ngjalljen dhe zhvillimin e kreativitetit brenda tyre, ku me anë të një fotografie ata do të shprehin shumë fjalë si dhe të aftësohen në këtë drejtim.

Akademia në Fakultetin e Medias dhe Komunikim-

it ka vazhduar aktivitetin me ligjëratën e profesorit të historisë në Universitetin Kentucky të SHBA-së, njëherësh edhe profesor vizitor në UBT, David Olster. Gjatë ligjëratës së tij, Olster ka trajtuar temën: "Revolucioni i medias në Amerikë: Nga gazetaria e shkruar deri tek postimet në rrjetet sociale", në kuadër të së cilës ai ka trajtuar përkufizimet që u bëhen mediave, pastaj me historikun e zhvillimit të teknologjisë së mediave në Amerikë, me ç'rast përmendi edhe disa nga rastet kur mediat kanë bërë ndryshime drastike, në të cilat u pasqyruan skandalet e ndryshme, krimet, raportimi për luftërat etj.

Tutje, ai ka trajtuar edhe ndikimin e madh të mediave në ditët e sotme, duke marrë si rast konkret zgjedhjen e Donald Trump, për president të SHBA-së.

Akademia e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit, në ditët e ardhshme do të karakterizohet me shumë ngjarje, përfshirë edhe ato artistike.

Fakulteti i Medias dhe Komunikimit në UBT, ka përmbyllur suksesshëm punimet në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, me ç'rast ligjëruan dhe ndanë përvojat e tyre profesorë vendorë e ndërkombëtarë.

Në ditën përmbyllëse të akademisë, ka ligjëruar gazetarja e njohur, njëherësh edhe profesoreshë në Fakultetin e Medias në UBT, PhD. Gjylie Rexha, e cila trajtoi temën: "Roli i mediave sociale në aktivizmin qytetar – Pranvera Arabe", ku ka shtjelluar përdorimin e teknologjisë në përfshirjen qytetare, kryesisht në çështje me interes nacional.

Rexha ka përmendur rastet si "Pranvera Arabe", që është karakterizuar me protesta në vende, si: Tunizia, Egjipti, Jemeni etj., kundër pushtetarëve totalitarë. Sipas saj, si rezultat i rrjeteve sociale, konsiderohet që me sukses janë komunikuar dhe bartur mesazhet për reagim qytetar.

Akademia ka vazhduar aktivitetin me ligjëratën e profesorit të Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT, prof. dr Ferid Selimi.

Ai ka trajtuar temën: "Ndikimi i gazetarisë së verifikimit në sigurinë rajonale dhe botërore", në kuadër të së cilës ka ligjërroi mbi emërtimet gazetareske, vërtetësinë në gazetari, si dhe shpejtësinë e përhapjes së informacionit.

Në fund të këtij aktiviteti, studentët që morën pjesë në këtë akademi, në mënyrë të organizuar, bënë fotografi dhe i shfaqën ato në një ekspozitë.

Ekspozita ishte produkt e detyrës së dhënë pas punëtorisë që është zhvilluar paraprakisht për kamerë dhe fotografi, në kuadër të ANV-së.

Në përmbylljen e aktivitetit në fjalë, për kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre në punimet e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në ANV, u ndanë certifikata për pjesëmarrësit.

**Jehona Kapllani**



Në ANV-në e Shkencave Politike

## Gjeneralët e NATO-s ligjërojnë në UBT

Fakulteti i Shkencave Politike në UBT, këtë vit në Akademinë Ndërkombëtare Verore, ka trajtuar çështjet e sigurisë globale dhe intervenimet në vendet që janë përballur dhe po përballen me kriza në aspektin e sigurisë.

Me këtë rast, UBT ka mbledhur figura vendore e ndërkombëtare, ushtarakë, politikanë dhe njohës të çështjeve të sigurisë, të cilët në ditën e parë të kësaj akademie trajtuan temën me titull: “Ndikimi ndërkombëtar në zonat e krizës: Zgjidhja e konflikteve”, e trajtuar nga përfaqësuesit e Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s dhe nga njohës tjerë të çështjes së sigurisë nga Kosova dhe më gjerë.

Duke qenë kështu, në hapje të këtij aktiviteti, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka thënë se hapja e kësaj akademie ishte një veprim i rëndësishëm për rritjen e njohurive të studentëve dhe për njohjen me situatat reale të sigurisë.

Në kuadër të ANV-së, përfaqësuesit e NATO-s mbajtën ligjëratat për studentët e UBT-së, të cilat kishin të bënin me shtrirjen e aktivitetit të NATO-s nëpër zona lufte, si dhe me



raste konkrete të konflikteve nëpër shtete të ndryshme, që më pas u përcollën me simulime të kryera nga studentët dhe të dirigjuara nga gjeneralët e NATO-s, me qëllim të zgjidhjes së këtyre konflikteve.

Gjenerali i NATO-s, njëherësh edhe përfaqësues i Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s, Giorgio Battisti prezantoi disa nga modellet e ndërhyrjeve ndërkombëtare nëpër zona të konflikteve në botë, duke vënë në pah edhe rolin dhe detyrat e ushtarëve të NATO-s nëpër zonat e prekura.

“Ushtarët e shteteve pjesëmarrëse, që janë pjesë e NATO-s dhe që ndërhyjnë nëpër zonat ku ka konflikte duhet të jenë të përkushtuar gjatë kryerjes së detyrave, por mbi të gjitha, duhet të respektojnë të drejtat e njerëzve që janë të prekur nga lufta”, ka thënë Battisti.

Përfaqësuesja e Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, Maria Grazia Romano paraqiti rastin e konfliktit në shtetin e Libisë, historikun e zhvillimit të këtij shteti dhe trazirat e krijuara, sidomos pas zbulimit të pasurive të naftës në këtë shtet, me ç'rast tha se Libia është shtet i madh dhe si i tillë, edhe ndërhyrja ishte proces më i vështirë.

Gjatë këtij aktiviteti, studentët, të përcjellë nga gjeneralët dhe përfaqësuesit e Kolegjit të Mbrojtjes i NATO-s, kanë simuluar edhe një situatë fiktive për zgjidhjen e konfliktit të Libisë.

Tutje, studentët e Shkencave Politike, të ndarë në dy grupe, prezantuan rezultatet e hulumtimeve të tyre të kryera gjatë simulimit të situatave fiktive në kuadër të ANV-së, që kishin të bënin me përballimin dhe stabilizimin e gjendjes politike në shtetin e Libisë, përmes ofrimit të zgjidhjeve konkrete.

Gjatë prezantimit të tij, përfaqësuesi i grupit të parë të studentëve, Dastid Morina kishte thënë se pjesëmarrja në këtë



akademi ishte një sfidë dhe ndihmë e madhe për të ardhmen e tij, falë përballimit me ngjarjet dhe problemet reale në botë, duke u fokusuar në konfliktin e Libisë.

“Kur u takuam patëm debate të gjata dhe pas shumë bisedimeve dhe ndarjes së ideve tona, erdhëm në përfundim se, sipas zgjidhjes sonë, duhet të bëhen hapa të menjëhershëm për ta ndihmuar shtetin e Libisë dhe për ta përmirësuar gjendjen”, pohoi Morina.

Përfaqësuesja e grupit të dytë të studentëve, Albana Fona vlerësoi se pjesëmarrja në ANV, veçanërisht gjatë fazës së simulimit, për të do të mbetet një pikë reference për zgjidhjen e të gjitha problemeve politike gjatë karrierës së saj.

Në përmbyllje të aktivitetit, për penalistët dhe studentët pjesëmarrës, u ndanë certifikata pjesëmarrjeje, për kontributin e tyre të dhënë gjatë ditëve sa zgjati aktiviteti i Fakultetit të Shkencave Politike, në kuadër të ANV-së.

Në ANV-në e Juridikut ligjërojnë profesorë vendorë e ndërkombëtarë

## Ligji dhe ndikimi i digjitalizimit



Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, Fakulteti Juridik i UBT-së, ka mbajtur ciklin e ligjëratave tematike, të cilat janë mbajtur nga profesorë, juristë dhe njohës të çështjes së sigurisë, teksa tema bosht e akademisë së sivjetme ishte: “Ligji dhe ndikimi i digjitalizimit”, ku ndër tjerash, është trajtuar çështja e krimeve dhe sigurisë kibernetike, pastaj e forenzikës digjitale etj.

Për juristët e ardhshëm fillimisht ligjëroi hakeri dhe profesori i University of Bloomsburg, prof. dr Philip Polstra, i cili trajtoi temën me titull: “Teknologjia e forenzikës digjitale”, gjatë secilës u trajtuan detaje elementare të forenzikës dhe përfshirjes së digjitalizimit në të, si temë dhe proces relativisht pak i zhvilluar në Kosovë.

Krahas ligjëruesve tjerë, Polstra ka vazhduar me ciklin e ligjëratave, gjatë së cilave ka trajtuar edhe më tutje çështjen e forenzikës, duke u fokusuar tek proceset, analizat dhe aplikimin e forenzikës digjitale nëpër proceset juridike.

Për studentët pjesëmarrës ka ligjëruar profesoresha e Universitetit të Tiranës, prof.dr. Kozeta Sevrani, e cila prezantoi temën: “Tregtia elektronike dhe ligjet”.

Fokusi kryesor i kësaj teme ishte në aspektet dhe sfidat me të cilat ndeshet tregtia elektronike, ku ndër të tjerash u diskutua edhe rreth IP-ve në një faqe të internetit, kontraktimin

nëpërmjet internetit, shitjen e mallrave dhe shërbimeve, pastaj u diskutua edhe përmbajtja e krijuar nga përdoruesit dhe përgjegjësia, të dhënat, privatësia dhe marketingu, reklamat, vjedhjet online etj.

Në ANV-në e Juridikut është ligjëruar edhe për “Privatësinë, Konfidencialitetin dhe Sigurinë e të dhënave”.

Duke trajtuar këtë temë, ligjëruesja në Fakultetin Juridik të UBT-së, Jonida Xhafaj ka paraqitur shumë koncepte me të cilat ekspertët e përkufizojnë privatësinë, por sipas saj, privatësia është e drejtë themelore e njeriut, që nënkupton përfshirjen e të dhënave personale, materiale, intelektuale etj.

Tutje, Xhafaj ka thënë se sot privatësia ka marrë kuptim tjetër, më të gjerë, dhe është më vështirë të mbrohet. Sipas saj, edhe përparimet digjitale janë faktorë që ndikojnë në cenim të privatësisë.

Tutje, në këtë aktivitet ka ligjëruar edhe profesori në Fakultetin Juridik të UBT-së, Shpend Nura i cili ka trajtuar temën: “Sistemi bankar në Kosovë dhe Hyrje në Transaksionet Elektronike”.

Nura ka thënë se forma më moderne e të bërit biznes është ajo e E-Commerce, me anë të së cilës blihen, shiten produkte ose shërbime në formë elektronike duke shfrytëzuar internetin. Forma të tilla sipas tij, përmirësojnë procesin e shit-blerjes, si dhe kjo formë përdoret pothuajse në të gjitha bizneset.

Ndërkohë ai ka thënë se është shumë e rëndësishme edhe siguria e pagesave që bëhet, sepse sipas tij, këto procese shpesh herë përfshihen edhe nga krimet kibernetike.

Po ashtu, duke trajtuar temën për sigurinë dhe krimet kibernetike, menaxheri i UBT CERT, Atdhe Buja ka prezantuar krimet kibernetike që shfaqen më së shpeshti. Gjithashtu, ka folur edhe për metodat e operimit të tyre, ndërkohë ka theksuar nevojën për bashkëpunim e koordinim vendor dhe ndërkombëtar më gjitha institucionet relevante për mbrojtjen nga sulmet e tilla.

Në kuadër të kësaj ligjërate është prezantuar edhe puna që bën divizioni CERT në UBT, me ç'rast Buja ka përmendur edhe aktivitetet përgjatë 15 muajve që ka realizuar UBT-CERT.

Aktiviteti i ka vazhduar punimet me ligjëratën e profesorit në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike në UBT, dr.Zhil-

bert Tafa, i cili ka ligjëruar temën: “Krimet e rrjetit dhe telekomunikacionit”, duke paraqitur rastet më të shpeshta të mashtrimeve telekomunikuese.

Ndërkohë studentët janë njoftuar edhe me ligjet përkatëse në vend dhe më gjerë, që aplikohen për këtë fushë.

Për shumë pjesëmarrës nga të gjitha universitetet dhe kolegjet private, ka ligjëruar profesori në UBT njëherësh zëvendësministri në Ministrinë e Mbrojtjes në Maqedoni, Bekim Maksuti, i cili ka trajtuar temën: “Krimet Kibernetike, E-Terrorizmi dhe Hakimi”.

Maksuti ka folur për sigurinë e të dhënave, sfidat dhe zgjidhjet e problemeve të sigurisë kibernetike, për reduktimin e akteve terroriste përmes përgjimeve të ligjshme, për ndërgjegjësimin mbi sigurinë, për privatësinë dhe të drejtat e mediave etj.

Gjatë aktiviteteve të kësaj akademie ka ligjëruar profesoresha në Fakultetin Juridik të UBT-së, Jorida Xhafaj, ku ka trajtuar temën: “Krimet kompjuterike: Dilema e privatësisë dhe siguria e sigurisë”.

Ligjëratat ka filluar me një film të shkurtër mbi garantimin e sigurisë së informacionit dhe se si kjo nevojë cenon jetën private të shoqërisë digjitale.

Profesoresha Xhafaj, ka paraqitur faktorët që ndikojnë në rritjen e kontrollit shtetëror në këtë fushë, sipas të cilës, në këtë drejtim rol të rëndësishëm luan Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Akademia Ndërkombëtare Verore në Fakultetin Juridik të UBT-së, në kuadër të së cilës morën pjesë shumë ligjërues nga vendi dhe më gjerë, e të cilët trajtuan tema nga fusha të ndryshme, mbylli suksesshëm punimet, teka në fund studentët vizituan edhe Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për të parë nga afër mbarëvajtjen e punëve në këtë institucion.

Aty janë pritur nga kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala, i cili ka informuar studentët se kjo gjykatë vepron në shkallën e dytë, që do të thotë se i gjykon lëndët e pranuar pas ankesës nga ndonjëra prej shtatë gjykatave themelore. Në përmbylljen e aktivitetit në fjalë, për kontributin dhe pjesëmarrjen e tyre në punimet e Fakultetit Juridik në ANV, u ndanë certifikata për pjesëmarrësit.

Edona Jerliu

UBT bashkëpunon me festivalet DokuFest dhe Autostrada Biennale

## UBT partner i ngushtë i festivaleve të artit “DokuFest” dhe “Autostrada Biennale”, ku studentët e UBT-së janë të përfshirë në këto organizime në cilësinë e stafit dhe të vullnetarëve

Gjatë muajit të verës, UBT ka mbështetur Festivalin Ndërkombëtar të Dokumentarit dhe Filmit të Shkurtër, “DokuFest” dhe Festivalin e Artit Bashkëkohor “Autostrada Biennale”, teksa që nga fillimi, dhjetëra studentë të UBT-së janë të përfshirë në këto organizime në cilësinë e stafit dhe të vullnetarëve.

Biennialja Ndërkombëtare e Artit Bashkëkohor “Autostrada Biennale”, në edicionin e parë, e trajtoi temën “E ardhmja e kufijve”, e cila u hap më 19 gusht, në Prizren, dhe ka zgjatur deri më 23 shtator. Studentët kanë funksionuar në mënyrë të organizuar dhe kanë dhënë kontribut nëpër departamente të ndryshme, duke i kryer punët dhe angazhimet në cilësinë e stafit ose vullnetarëve.

Ata kanë ndihmuar në punët organizative, në menaxhimin e hapësirave, në punët e produksionit, në koordinimin dhe mbulueshmërinë e anës mediale, si dhe në përgatitjen e skenave dhe ndërtimin e robotëve, për realizimin e veprave të tyre artistike.

Bashkëpunimi i UBT-së me Autostradën Biennale, komunitetit i sjell inovacione teknologjike dhe artistike.

Studentët e Fakultetit të Mekanikës në UBT, Kenan Alija dhe Kushtrim Ajazaj, si dhe nxënësi Nart Gashi, të udhëhequr nga profesori i UBT-së, prof. dr Valmir Hoxha, kanë realizuar njërin ndër inovacionet më të mëdha të edicionit të parë të Autostradës Biennale, robotin lypsar, projekt ky i artistit të njohur sloven, Sašo Sedlaček.

Roboti është ndërtuar për më pak se një javë, teksa realizimi i tij është bërë pa asnjë kosto financiare, nga hardueri kompjuterik tashmë i pashfrytëzuar.

Qëllimi kryesor për të cilin është ndërtuar ky robot është mbledhja e parave, me ç’rast funksionon si një agjenci zëvendësuese e krijuar për një botë, në të cilën të marginalizuarit, si individët dhe familjet e varfra, refugjatët dhe azilkërkuarit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe ata të fshehtit nga sytë e publikut, kurrë nuk do të dalin në rrugë për të kërkuar lëmshë, me përjashtim të rrethave të caktuara.

I lumtur me punën dhe ndihmën që kanë ofruar studentët në këtë aktivitet, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se qëllimi i institucionit të cilin ai e udhëheq është që studentët t’i përfshijë në sa më shumë punë praktike, duke gjeneruar rezultate dhe kompetenca me njohuritë dhe aftësitë që i kanë.

“Ndërtimi i robotit është rezultat i dijes që gjendet brenda stafit dhe studentëve të UBT-së dhe ne jemi të lumtur që e kemi mundësinë t’i bashkojmë forcat tona me festivale e ngjarje të ndryshme, në mënyrë që të sjellim diçka kreative dhe inovative në shërbim të shoqërisë”, theksoi Hajrizi.

Artisti sloven, i cili e projektoi robotin lypsar, Sašo Sedlaček u shpreh i impresionuar me punën e bërë nga studentët e UBT-së, veçanërisht me profesionalizimin me të cilin kanë punuar ata.

“Studentët e UBT-së nga Prishtina, të udhëhequr nga pro-



fesori Valmir Hoxha, kanë bërë njërin ndër robotët më të avancuar deri më tani, madje edhe më të avancuar se një që e kam bërë në Japoni dhe jam plotësisht i kënaqur me rezultatin”, vlerësoi Sedlaček.

Me të njëjtën krenari, për studentët flet edhe mentori i tyre gjatë realizimit të kësaj pune, prof. dr Valmir Hoxha, i cili tha se ata kanë punuar me një përkushtim dhe precizitet të madh.

“Studentët e UBT-së dhe nxënësi kanë arritur që për një kohë rekord të zhvillojnë një robot të kompletuar dhe funksional”, tregoi Hoxha.

Roboti lypsar është i pari i këtij lloji i ndërtuar ndonjëherë në Kosovë dhe momentalisht është duke qëndruar në hapësirën e Stacionit të Autobusëve të Prizrenit.

Ndërtimi i këtij roboti, ndër tjerash, do të luajë edhe një rol shumë të rëndësishëm humanitar, teksa pas përfundimit të Autostradës Biennale, ai do të vendoset në laboratorin e mekanikës në UBT, dhe do të vazhdojë të shfrytëzohet për raste të ndryshme humanitare.

Vlen të theksohet se rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi mori pjesë në cilësinë e panelistit në konferencën treditore të organizuar nga Autostrada Biennale, në Prizren, festival ky që në edicionin e vet të parë po trajton temën: “E ardhmja e kufijve”.

Hajrizi shtjelloi rolin dhe rëndësinë e arsimit të lartë në eliminimin e kufijve dhe barrierave, që vijnë për arsye të ndryshme, kryesisht politike.

Me këtë rast, ai tha se me zhvillimin e hovshëm teknologjik, roli i universiteteve dhe institucioneve tjera arsimore ka ndryshuar, duke u rritur edhe përgjegjësitë e tyre.

“Roli dhe përgjegjësia e institucioneve arsimore nuk është

më ajo që ka qenë më parë, kjo sepse tani përveç se duhet edukuar njerëz dhe duhet gjeneruar njohuri të reja, në ditët e sotme duhet të jesh edhe pjesë aktive e zhvillimit dhe organizimit të aktiviteteve që ndikojnë në vënien në lëvizje të gjërave”, theksoi Hajrizi, teksa shtoi se “një institucion i vetëm nuk mund të jetë një aktor i vetëm ndikues, andaj duhet bashkëpunuar për të dhënë kontribut në ofrimin e zgjidhjeve”.

Përveç kësaj, studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim në UBT kanë marrë pjesë në festivalin ndërkombëtar të dokumentarëve dhe filmave të shkurtër “DokuFest”, festival i cili organizohet tash e gjashtëmbëdhjetë vite, në Prizren. Çdo vit, festivali i sjell kinematë dhe vendet e improvizuara të shfaqjes në qendër të qytetit historik të Prizrenit, një përzgjedhje prej më shumë se 200 filma të zgjedhur me dorë nga e gjithë bota.

UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me drejtuesit e festivalit, sipas së cilës është hartuar një projekt i përbashkët, në kuadër të të cilit studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim janë angazhuar në përcjelljen e ngjarjeve me shkrime dhe videomateriale.

Qëllimi i bashkëpunimit mes UBT-së dhe DokuFest-it është që studentët të përfitojnë përvoja profesionale si dhe të aftësohen për profesionin e tyre.

Përmes këtyre projekteve synohet që, në kuadër të bashkëpunimit, studentët të kenë mundësi të ushtrojnë profesionin në aspektin praktik, të punojnë dhe njëkohësisht të fitojnë disiplinë në punë si dhe atyre u krijohet mundësia që të punojnë me staf profesional.

**Anisa Rada**



## University of Warsaw



**Bachelor and Master Degree in International Relations**

**Apply for Scholarship!**

### Teaching and Research Areas

- International Politics
- International Political Economy
- Culture and Multiculturalism
- Diplomacy and Foreign Policy
- International Law and Institutions
- Security and Strategic Studies
- European Integration
- International Relations Theory
- Emerging Markets
- International Business



### University of Warsaw (UW)

Is known as one of the leading academic and research center in Poland. The high level of scientific research, its connection with the education of students and the diversity and attractiveness of our teaching determines the position of the University in the country and worldwide.

### UW Highlights:

- Founded in 1816
- In the top 4% World-Class Universities
- Ranked no.1 in Poland
- Ranked by QS Topuniversities, The times THEWUR,
- Top 500 in Shanghai Group
- One of the most modern library in Central Europe

### Institute of International Relations:

- Established in 1976
- Worldwide research cooperation
- Visiting Professors from all over the World
- Active in national and international research
- Bachelor, Master level and PhD degrees in English
- Worldwide student exchange programme

### Fees & Financing:

Bachelor: 1300 € / Year

Master: 2000 € / Year

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

**Come to UBT and get European degree**

**TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS**



Email: warsaw@ubt-uni.net  
Email: ismn@uw.edu.pl  
Institute of Warsaw  
www.ism.uw.edu.p

## Danube University Krems



**Master of Business Administration-MBA**

### Specializations with MBA Program

- Aviation
- Business Performance Management
- Corporate Responsibility & Business Ethics
- E-Mobility Management
- Energy & Carbon Management
- Finance
- International Business
- Marketing & Sales
- Strategic Management & Organizational Change
- Enterprise Project Management

**Apply for Scholarship!**

### Fees & Financing

Tuition fee: Euro 21,900

Please note our **Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 10,950

The Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

### Danube University



Danube University Krems has specialized in postgraduate academic studies and offers exclusive courses in the fields of health and medicine, communication and globalization, business and law, education and media as well as of arts, culture and building. Being a European model project, Danube University Krems combines high quality in education, research and consulting with excellent customer orientation and service. More than 5,000 students from 80 countries are enrolled in over 150 academic courses.

### Department for Management and Business

We believe strongly in a long life learning that prepares and enables you to become a responsible business leader in a fast changing world. We place strong emphasis on learning-by-doing approach, and strive for creating an innovative environment that enables you to have a high caliber education and training. As we are well located in Central Europe, you will enjoy a multicultural and international faculty and student body. The Danube Business School provides an environment where East meets West with strong links to the business community and relationships with partners from both Eastern as well as Western European countries.

### Top 10 Reasons to Join a Danube MBA

- An integrative and applied approach to learning
- Long expertise in postgraduate education
- Customized high standard programs
- High calibre and international faculty
- Flexibility for both full-time and part-time students
- Campus located in the picturesque Wachau region
- International student body
- International study trips
- Individualized quality service
- More than 2000 alumni

**Top University Education for Top Students!**

**TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS**



Email: dukmba@ubt-uni.net  
Email: michaela.moser@donau-uni.ac.at  
Tel: +43 (0)2732 893 2126  
Web: www.donau-uni.ac.at

## Vienna University of Technology



CONTINUING EDUCATION CENTER



## Msc Engineering Management

**Your key to the top engineering league**



### CONTENTS

Business • Engineering Informatics • Production • Master's Thesis

### MODALITIES

3 semesters, part-time, 14 weekend tracks, in English,

### FEES & FINANCING

Tuition fee: Euro 22,000

Please note our **KAMM Scholarships** with a subsidized tuition fee: Euro 13,000

The KAMM Scholarship is only for applicants with Kosovan, Albanian, Macedonian, or Montenegrin citizenship & main residence in one of these countries.

### HIGHLIGHTS

- 17 years experience
- Master of Science Degree of Vienna University of Technology
- Executive program
- International Faculty - Universities and Industry
- International Participants - Worldwide
- Top international faculty from Europe and USA
- Part time - 14 weekend modules (Thursday to Sunday)
- According to the Bologna Convention
- Contents modernized continuously
- Evening lectures of distinguished guest speakers
- Company visits
- Sustainable Learning Environment – with your tablet at the university (included in the price)
- Alumni Club related to IEEE
- Regularly Club meetings for Networking
- From our graduates approximately 2/3 are in (high) management positions, 1/3 founded a company



**Top University Education for Top Students!**

Our mission is "technology for people". Through our research we "develop scientific excellence", through our teaching we "enhance comprehensive competence".

Vienna University of Technology  
Continuing Education Center  
Operngasse 11 A-10 Vienna  
T+43(0)1/58801-41701 engineering@tuwien.ac.at  
Email:engineering@ubt-uni.net  
http://engineering.tuwien.ac.at







- 16 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i çertifikuar për ekselencë (EFQM)
- I çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfitues për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfitues i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

Zgjedh më të mirin ...  
... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and Go International...

## PROGRAMET E AKREDITUARA

### SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Intelejente
- Informatikë Biomjeksore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim
- Inxhinieri e Komunikimit
- Shkenca e të Dhënave Statistikore
- Informatikë Mjeksore

### MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistika dhe Menaxhim i Prokurimit

### MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT

- Menaxhim i Mekatronikes
- Automatizimi Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Robotikë dhe Sisteme Intelejente
- Inxhinieri Biomjeksore
- Inxhinieri e Telekomunikacionit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieria e Aeronautikes
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Inxhinieri e Proceseve të Prodhimit

### SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT

- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistikat, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komercit Elektronik (E-Komercit)

### ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR

- Arkitekturë e Qendrueshme
- Menaxhim Urban
- Restaurim Arkitekturor
- Dizajn i Interierit

### INXHINIERI NDËRTIMOR (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË

- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhimi i Ndërtimtarisë dhe Teknologji
- Infrastruktura Rrugore
- Inxhinieri e Ujerave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikës
- Inxhinieri e Materialeve

### SHKENCA POLITIKE

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritet Evropian
- Administratë Publike

### JURIDIK

- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

### E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

### MEDIA DHE KOMUNIKIM

- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhëniet me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

### POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM

- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

### INXHINIERI E ENERJISË

- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Eklektikë Elektronike
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

### INXHINIERI E ENERJISË EFIÇENTE

- Burimet e Energjisë
- Konzervimi i Energjisë
- Eficiencia e Energjisë
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieri Elektrike
- Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes
- Energjia Gjeotermike

### INFERMIERI

### FARMACI

### STOMATOLOGJ

### DIZAJN I INTEGRUAR

- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstil
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

### SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI

- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

### SHKOLLAT PROFESIONALE

- Gjuhë Angleze
- Zhvillimi i aplikacioneve
- Asistent Administrativ
- Teknologji e Informacionit dhe e Komunikimit
- Administrator i Sistemit dhe i Rrjetit Kompjuterik

## REGJISTRIMI

### Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e pikëve të maturës, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi

### Gjuha e studimeve:

Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera

### Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjëratat të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë. Për të punësuarit ofrohen ligjëratat pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

### Që suksesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sistem online
- Liçensa falas për software
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet me prestigjioz e vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajnime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.
- Çertifikime për kontabilist në bashkëpunim me SCAAK

### Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Baçelor është **1200 €**, për nivelin Master është **1500 €** me mundësi pagese deri në **12 këste**.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron përkrahje financiare

### UBT ofron zbritje deri në 50% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik
- Studentët e punësuar në Policinë e Kosovës
- Studentët me sukses të shkëlqyeshëm
- Studentët të cilit kanë arritur 200% në testin kombëtarë dhe kanë të gjitha 5 në shkollimin paraprakë
- Studentët e Luginës së Preshevës, Malit të Zi
- Studentët që marrin pjesë në programin parapregaditor

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel: **038 541400** Mob:**044 541400**, Email: [info@ubt-uni.net](mailto:info@ubt-uni.net) Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës **09:00** deri në **17:30**

Apliko online: [www.ubt-uni.net/apliko](http://www.ubt-uni.net/apliko) ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në **Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Pejë**